

UNIVERSITETI I PRISHTINËS • FAKULTETI I FILOLOGJISË

SEMINARI NDËRKOMBËTAR
PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE



PRISHTINË 2003

21/2

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË

dhe

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË-FILOLOGJISË

SEMINARI NDËRKOMBËTAR
PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE
KULTURËN SHQIPTARE

Materialet e punimeve të Seminarit XXI Ndërkombëtar për Gjuhën,
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare
Prishtinë, gusht 2002

Prishtinë, 2003

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE

KULTURËN SHQIPTARE

Këshilli drejtues në Prishtinë: Rexhep Ismajli, prof. dr. Shetfi Sejdiu, doc.
Dr. Nuh Rexhepi, doc. Dr. Shykrane Gërmizaj, prof. dr. Isak Shema, mr.
Sala Ahmetaj, mr. Ilaz Rexha
Këshilli drejtues në Tiranë: prof. dr. Ethem Likaj, prof. dr. Floresha Dado,
prof. dr. Shezai Rrokaj, prof. dr. Assoc. Ymer Çiraku

Drejtor nderi: akademik Idriz Ajei

Drejtor: akademik Rexhep Ismajli

Bashkëdrejtor: prof. dr. Ethem Likaj

Sekretar: prof. dr. Isak Shema

Bashkësekretar: prof. assoc. Dr. Ymer Çiraku

Sekretarë profesionalë: mr. Osman Gashi dhe Bardh Rugova dhe Kastriot Gjika

Redaksia: akademik Rexhep Ismajli, kryeredaktor

Prof. dr. Isak Shema

Dr. Shykrane Gërmizaj

Mr. Osman Gashi

Lektor: prof. dr. Fadil Raka

BOTUES: FAKULTETI I FILOLOGJISË, PRISHTINË

Sponsorë:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Qeverisë së Kosovës
Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe e Çështjeve Jorezidente e
Qeverisë së Kosovës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
Rektori i Universitetit të Prishtinës

WUS-Austria

Banja e Kllokotit

Shënpia Botuese Dukagjini

Nekra

FJALA E HAPJES E SEMINARIT 21

Të nderuar pjesëmarrës të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare,
Mysafirë dhe të ftuar,
Zonja dhe Zotërinj,
Mirë se keni ardhur në Seminarin 21!

Më lejoni që me këtë rast të përshëndes:
Ministrit e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, z. mr. Rexhep Osmani,
Ministrit e Kulturës, të Rinisë, të Sporteve dhe të Çështjeve Jorezidenciale, z. mr. Bexhet Brajsheori,
Përfaqësuesit e zyrave diplomatike në Prishtinë,
Përfaqësuesit e institucioneve të shkencës dhe të kulturës të Kosovës,
Të gjithë të ftuarit, që, me pranimë e tyre, e madhërojnë këtë hapje solemne të punimeve të Seminarit 21.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, i themeluar më 1974, tashmë është shndërruar në institucion me qëllim të veçantë për zhvillimet dhe komunikimet në fushën e shkencave të albanologjisë, të dijes dhe të kulturës shqiptare. Ky Seminar u bë institucion i këmbimit të ideve dhe të dijeve, i paraqitjes dhe i diskutimit të rezultateve, i nxitjes dhe i ndërmjetësimit të rëndësishëm për këmbimin e dijeve dhe për integrimet në këto fusha përtej ndarjeve të natyrave të tjera.

Organizuesit e këtij Seminarit ndjehen krenarë që kanë pasur mundësinë të luajnë një rol kështu me qëllim të komunikimit të dijeve dhe të integritetit, gofite në aspektin e rrafshimit të standardeve, pra të krijimit të pikënisjeve më të larta shkencore për të gjithë, gofite në aspektin e integritetit brenda segmentit të botës së studimeve shqiptare. E gmojnë posaçërisht pranimë e studuesve dhe të studentëve nga vendet e ndryshme të botës. Me punën e tyre shkencore e kulturore, me paraqitjet e vlerave të kulturës shqip-tare, me përkthimet dhe

veprimtarisë e tjera, ata kanë ndihmuar në mënyrë thelbësore që e vërteta për botën shqiptare, vlerat e kulturës së këtij populli, synimet dhe angazhimet konkrete të tij të njihen më mirë në vendet e tyre. Duke përmbyshur një funksion thelbësish shkencor e kulturor, ata, e bashkë me ta dhe Seminari, kanë arritur të krijojnë dhe të zgjerojnë hapësirat për lidhje midis njerëzve e kulturave, midis popujve e vendeve të ndryshme dhe botës shqiptare, të krijojnë linja për transmetimin e mesazheve në drejtime të ndërsjella. Bilanci, që mund të bëhet gjithë tash, mund të tregojë se rendimentet e tij kanë qenë pëtej të gjitha parashikimeve.

Na gëzon fakti që në këtë Seminar kontaktit me botën arbëreshe iu dha një shtysë e veçantë. Gëzohemi që sivjet pjesëmarrja e arbëreshëve ka nisur sërisht të rritet, gëzohemi sidomos për faktin që ata tash vijnë nga shumë qendra ku mund të studiohet gjuha dhe kultura e tyre, nga më shumë universitete dhe me rezultatit e rëndësishëm që është mundësia e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat fillore sipas Konventës Evropiane për Gjuhët dhe Kulturat e Minoriteteve. Krahina e Sicilisë pritu me zbatimin praktik dhe tash po vazhdojnë dhe të tjerat. Do të dëshironim që një mundësi e tillë t'u jepej dhe arbërorëve të Greqisë.

Duke qenë një nga gjuhët më të lashta të Ballkanit, shqipja është bërë një nga gjuhët për studimet ballkanike dhe të Evropës Juglindore në tërësi. Roli që ka luajtur dhe vazhdon të luajë në këtë aspekt Seminari ynë nuk mund të harrohet asesi.

Seminari i sivjemë shtrun para vetes detyra të shumtështa:

1. mësimin intensiv të gjuhës shqipe në tri nivele me nga 4 orë në ditë,
2. kursët e gjuhësisë dhe të letërsisë,
3. ligjëratat e përgjithshme,
4. referimet shkencore,
5. diskutimet e veçanta me synime problematizimi për Faik Konicën dhe për mësimin e gjuhës dhe të letërsisë në shkolla,
6. sesionin shkencor për letërsinë e arbëreshëve, ku do të kemi mbi 45 kumtesa dhe
7. sesionin shkencor për foljet në gjuhën shqipe me mbi 40 kumtesa.

Arbëreshët e Italisë i kanë dhënë kulturës shqiptare vlera të rëndësishme kulturore dhe letrare gjithë nga libri i parë i botuar më 1592 e deri në ditët tona. Komunikimet me këto vlera në kulturën shqiptare kanë qenë të ndryshme, ashtu si dhe vlerësimet. Shpresojmë që në sesionin shkencor të këtij seminari

do të hidhet dritë mbi shumë aspekte të kësaj letërsie dhe do të sillen ndihmesa me vlerë për kulturën në përgjithësi.

Në strukturën e shqipes sistemi i foljeve, si nga aspekti morfologjik ashtu dhe nga aspekti funksional, paraqet llojllojshmëri dhe begati. Më gjithë studimet jo të pakta deri sot, si në aspektin e funksionimit aktual, ashtu dhe në aspektin e zhvillimeve diakronike, ka shumëçka për t'u hulumtuar dhe ndriçuar në këtë fushë. Ndërdihen këtu problematika ballkanistike dhe aspektet e tjera. Në mbi 40 kumtesat e paraqitura në këtë sesion, ashtu si dhe në diskutimet që do të zhvillohen me atë rast, do të sillen vështrime me interes për të ndriçuar aspekte të ndryshme dhe komplekse të kësaj fushe.

Do të kemi dhe programe të veçanta kulturore, artistike, vizita dhe kontakte me institucione, me krijues të fushave të ndryshme dhe me qytetarë.

Në vitet '90 të shekullit të kaluar Seminari iu bë e pamundur ta zhvillonte veprimtarinë e vet në Prishtinë. Më 1995, pas një pushimi 4-vjeçar, në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Seminari ia doli ta rikthente veprimtarinë e vet, këtë herë në Tiranë, ku u mbajt për 2 vjet tradhazi. Çrregullimet e vitit 1997 në Shqipëri dhe Lufta e viteve 1998-99 në Kosovë e bënë të pamundur veprimtarinë e Seminarit. Ai u kthye sërisht në Prishtinë në vitin 2000 dhe sërisht në bashkëpunim me IGLJ të ASHSH. Nga ky vend dua t'u shpreh falënderimet tona për bashkëpunimin e frytshëm dhe ndihmesën e madhe që dhanë kolegët e Institutit për mbarëvajtjen e këtij Seminari. Sivjet, duke ndjekur linjën e kompatibilitetit institucional dhe me pro-pozimin e vet ISHL Seminarin e organizojmë bashkë me Fakultetin e Historisë-Filologjisë të UT-së. Qysh tash janë të prekshme rezultatet e këtij bashkëpunimi të ri dhe ne shpresojmë se ato do të rriten edhe më.

Kur u themelua, Seminari ishte institucion që mbështetej financiarisht nga ministritë e atëhershme të Kosovës për arsim, shkencë e kulturë. Kjo traditë vijoi edhe më vonë, kur Seminari e gëzoi përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës në ekzistencë dhe ndërkohë edhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Në vitet 2000-2001 Seminari që i shtrënguar të mbështetjes në radhë të parë tek donatorët. Sivjet Seminari sërisht e gëzon mbështetjen substanciale të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe të Ministrisë së Kulturës, rinisë e Sporteve, ndërsa për një pjesë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Rektori i UP-së ka qenë vazhdimisht mbështetës i veprimtarisë së Seminarit dhe vazhdon të jetë edhe tash, ashtu si dhe donatorë të tjerë kryesisht me shërbime të veçanta, si Shoqata Ho-teliere Kosova, Banja e Klokotit, Shtëpia Botuese Dukagjini. Aspektet e formësimit grafik të

dokumentacionit Seminari ia detyron artsisit Nextat Krasniqi-Nekra.

Drejtorja e Seminarit e ndjen të nevojshme t'u shprehë falënderimet për ndihmesën e tyre shumë të rëndësishme të gjithëve. Njëherësh i shprehim falënderime Fakultetit të Filologjisë që na vuri në dispozicion poten-cialin teknik dhe ijetëzoz, pa të cilat ky Seminar do të kishte veshuresi.

Dua të shpreh falënderime të posaçme për mjetet e informimit, që, me interesimin e tyre, e ndihmuan afirmimin e punës së Seminarit.

Prof. dr. Ethem LIKAJ, Tiranë, Bashkëdrejtor i Seminarit
FJALA E PËRSHËNDETJES

Të nderuar pjesëmarrës,

Sot kam nderin të përshëndes për herë të parë si bashkëdrejtor i këtij seminari fillimet e punimeve të tij. Gëzohem veçanërisht se këtë herë Universiteti i Tiranës gjendet përkrah Universitetit të Prishtinës si bashk-organizator. Por jemi edhe të ndërgjegjshëm se nuk fillojmë, por vazhdojmë një punë të madhe dhe me qëllime fisnike, sepse që nga fillimet e tij kemi qenë gjithmonë pjesëmarrës aktivë dhe entusiastë.

Seminari i gjuhës, letërsisë dhe i kulturës shqiptare, organizuar së pari nga Universiteti i Prishtinës 21 vjet më parë dhe vazhdimisht, qysh në fillimet e tij i hodhi hapat e parë ndofta me drojtje, por me shumë dinqitë. Sot ai, duke ngjitur shkallaren 21-vjeçare, është shndërruar jo me hap, por me vrap nga shkollimi e njohja e gjuhës, e letërsisë dhe e kulturës shqiptare në shkencën e gjuhës dhe të letërsisë. Shqiptarë dhe të huaj me dashur humane për të njohur frymën e popullit shqiptar të mishëruar në këtë fusha, për mbi 20 vjet, të futur thuajse në çdo skutë, vazhdimisht kanë hetuar e zbuluar të panjohura dhe vlera të çmuara.

Seminari, që nisi me pak njerëz, por mendjetelë e mendjekthjellët, tani po rrëmben fillestare dhe pari nivelesh intelektuale nga bota shqiptare dhe mbarë bota.

Bota e letërsisë, e gjuhës dhe e kulturës shqiptare po mësohet dhe po studiohet nga rrethe dhe në reth më të gjerë jo si kureshtje, as e veçuar, por si pjesë e kulturës dhe e civilizimit evropian, jo për të thirrur që të pranohet, por për të thënë me forcë se këtu jam.

Të nderuar pjesëmarrës,

Duke përfunduar përshëndet dhe kujtoj, në mënyrë të veçantë pishtarët nismëtarë, shumë prej të cilëve janë në këtë sallë dhe të tjerë, uroj që

punimet e këtij sesi të rrijedhin si është më së miri, ndërsa suksesi, jam i bundir, nuk do të mungojë.

Mr. Rexhep OSMANI, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
FJALA PËRSHËNDETËSE

Zonja dhe zotërinj,
Kolegë të ndëruar,
Miq të çmuar,

Sot kam kënaqësinë e veçantë që në emër të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe në emrin tim personal t'ju shpreh urimet më të mira për fillimin e punës së Seminarit të 21-të Ndër kombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

Po ashtu jam i privilegjuar që në emër të Qeverisë së Kosovës t'ju dëshiroj mirëseardhje në Kosovë duke ju dëshiruar qëndrim të këndshëm dyjavor në Prishtinë.

Zonja dhe Zotërinj,

Seminari i 21-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, që do t'i zhvillojë punimet në këto dy javët e ardhshme do të shënojë edhe njëherë ngjarje të rëndësishme në jetën arsimore, kulturore dhe shkencore të Kosovës.

Seminari i sivjemë po mbahet në rrethana të reja për Kosovën. Në ndajinë vetëm disa muaj kur Kosova krijoi institucionet e saja: Parlamentin Presidencën dhe Qeverinë për të cilat i zgjodhi përfaqësuesit e vet. U zhvillua një hap i nadh historik për Kosovën. Qeveria e Kosovës i propozoi Parlamentit një program të cilin e miratoi.

MASHT është në proces të formimit të strukturave administrative, profesionale dhe marrjes së përgjegjësisë dhe kompetencave nga stafi i UNMIK-ut.

Jemi duke u angazhuar për një shkollë të demokratizuar të vendosur në tabanin kombëtar, pa ndonjë ideologji të veçantë, gjithnjë në përpjekje për respektimin e kulturave dhe qytetërimit e të tjerëve brenda një sistemi

unik të arsimi në Kosovë, me standarde dhe vlera që mundësojnë integritimin e dijes kosovare me të tjerë në Evropë dhe më gjërë.

Në Universitetin e Prishtinës ka filluar një proces reformash që sigurojnë një pavarësi, liri akademike, por që lypset bërë disa korrigjime në frymën e Ligjit të ri mbi arsimin e lartë.

Kolegë të nderuar,

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare tani është bërë një institucion i konsoliduar, i fuqishëm, i cili do të shpërpara njohjet e ndërsjella për gjuhën, letërsinë, traditën, historinë, përgjithësisht studimet albanologjike të cilat tani kanë siguruar shtratin e vlerave shkencore.

Miq të çmuar,

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare bëri një rrugë të gjatë, të vështirë, të mundimshme, varësisht nga konteksti politik, shoqëror, ekonomik dhe kulturor nëpër të cilin kaloi Kosova.

Tani, nuk do të ishim këtu ku jemi po mos të ishte kontributi i çmuar i seminaristëve të huaj, të cilët erdhën nga vendet e ndryshme e të cilët u mishëruan me gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare dhe ecën së bashku me ne shqiptarët si ambasadorë të vërtetë të Kosovës, andaj do t'u jemi mirënjohës gjithmonë.

MASHT u është mirënjohës nismëtarëve të këtij seminari dhe të gjithë atyre të cilët e fuqizuan këtë institucion të rëndësishëm ndërkombëtar të kulturës të zhvillojë rritjen e vet edhe në rrethana shumë të vështira.

MASHT edhe në të ardhmen do ta mbështes fuqishëm Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

Ju falënderiti!

Prof. dr. Enver MEHMETI, Dekan i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës

FJALA E PËRSHËNDETTJES

Të nderuar miq dhe kolegë,
Zonja dhe zotërinj të nderuar,

Kam kënaqësinë që më jepet mundësia t'ju përshëndes në emër të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, duke ju dëshiruar qëndrim të këndshëm në Prishtinë dhe në Kosovë si dhe suksese në punimet e Seminarit të sivjemë. Seminari tradicional i gushtit që e organizon Fakulteti i Filologjisë i Prishtinës së bashku me Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të universitetit të Tiranës është ndër manifestimet më të rëndësishme vjetore albanologjike në Kosovë. Ky institucion albanologjik për të njëzet e njëten herë radhazi grish anë e kënd botës nga qerthujt albanologjikë studiuesit e gjuhës shqipe të letërsisë shqipe dhe të kulturës shqiptare. Nga themelimi e gjer më sot Seminarin tonë e kanë frekuentuar, kanë marrë pjesë në të dhe kanë dhënë kontributin e vet emra të afirmuar studiuesish të brendshëm dhe të botës së jashtme. Në sesionet shkencore të organizuara, në ligjerata dhe në format e tjera të punës së Seminarit janë trajtuar, diskutuar, ndriçuar me sukses çështje të rëndësishme, çështje problemore të gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. D.m.th., Seminari krahas kurseve të gjuhës shqipe, në të cilat marrin pjesë fillestarët, të huajt që duan ta mësojnë shqipen dhe që më vonë një numër i tyre do të hyjë në botën e studimeve albanologjike, ka trajtuar me kompetencë shkencore çështje fundamentale të shqipes dhe të kulturës së shqiptarëve. Edhe në Seminarin e sivjemë shpresojmë se nuk do të mungojnë rezultatet në këtë drejtim.

Na gëzon fakti se kohëve të fundit interesimi për Seminarin vazhdimisht po shtohet me seminaristë të rinj nga shumë vende të botës. D. m. th., po bëhet natyrishtëm përtitja e gjeneratave pjesëmarrëse të Seminarit që është një garanci për ardhmëinë e tij.

kultura të ndryshme, e bënë atë të qëndrueshëm dhe të aftë t'i përballonte edhe krizat e mëdha që kaloi shoqëria shqiptare në përgjithësi, në Kosovë sidomos, në vitet '90 të shekullit të kaluar. Megjithë përndjekjet dhe ndalesat, Seminari ia doli ta mbante veprimtarinë e vet, të funksiononte si institucion dhe në këtë qëndresë të gjente dhe rrugë zgjerimi të bashkëpunimit në vitet 1995-96 në Tiranë me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, për të vazhduar me këtë bashkëpunim dhe në Prishtinë menjëherë pas Luftës në vitet 2000-2001, ndërsa tash me Fakultetin e Historisë-Filologjisë të UT-së.

Vëshirësitë e mëdha që kishin kultura dhe dijet shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit 20, arriti t'i kapërcente dhe kështu të krijojte vlera të qëndrueshme njëzëre jo vetëm me qëndresën, vullnetin e madh dhe veprimtarinë e ushtruar përtej të gjitha rreziqeve, po edhe me ndihmën e pakusyer të studuesve, veprimtarëve të kulturës, të përkthyesve dhe të përhapësve të gjuhës, të kulturës dhe vlerave shqiptare gjithandej nëpër botë, që në fillim ishin më të pakta dhe me kohë erdhën dhe po shtohen gjithnjë e më shumë. Pjesëmarrësit e Seminarit tonë, tani më mund të themi me krenari gati të gjithë albanologët e kohës, shumë përthapës të kulturës shqiptare, përkthyes të shkëlqyer, veprimtarë të tjerë në fushë të shkencës dhe të kulturës, humanistë, kanë dhënë një ndihmesë të paqumeshme në këtë drejtim. Duke i kujtuar të gjithë ata, sidomos ata që nuk janë më midis nesh, por vepra e të cilëve vazhdon të na japë impulse krijuese, u shprehim falënderimet tona të gjithëve për angazhimin në një veprimtari kështu të rëndësishme dhe me dimensione të gjera kulturore, prandaj njëzëre.

Në të njëjtën kohë, të nderuar pjesëmarrës, dua të shpreh kënaqësinë tonë të madhe që sivjet interesimi i të rinjve për të marrë pjesë në punimet e Seminarit ishte shumë më i madh dhe nga vende të ndryshme të botës. Ky interesim i shtuar për një pjesë të mirë është edhe rezultat i punës së palodhshme të pjesëmarrësve të mëparshëm të Seminarit.

- Seminari i sivjemë i zhvilloi punimet në disa binarë paralelisht:
- mësimi intensiv i gjuhës shqipe për mbi 60 pjesëmarrës u zhvillua në 4 nivele me 5 grupe me nga 4 orë në ditë;
 - pjesën mësimore e begatoi sivjet posaçërisht cikli i leksioneve për letërsinë shqiptare, për gjuhësinë dhe për kulturën (10 sish);
 - u realizuan 6 ligjërata me tema të përgjithshme, mbi 20 referime shkencore me shumë debate;

- në tryezën shkencore për veprën e Faik Konicës u lexuan 7 kumtesa ndërsa në tryezën për mësimin e gjuhës dhe të letërsisë në shkolla kumtesa; të gjitha u shoqëruan me debate dhe diskutime të frytshme u bënë vizita në Bibliotekën Kombëtare-Universitare, në Galerit Kombëtare të Artëve, në Institutin Albanologjik, në Rektoratin e Prishtinës, në kompleksin memorial 'Adem Jashari' në Prekaz; në Pejë - qyteti dhe Çarshia e Gatë, në Gjakovë - Çarshia e vjetër, qyteti dhe prijë e drektë me Kryetarin e Kuvendit të Gjakovës; në Prizren - Ldhja e Prizrenit, Hamami, Tegeja dhe qyteti; në Shpellën e Gadime në Bibliotekën 'Fan Noli' në Gjiçan, në qytetin e Gjiçanit dhe prijë drektë me Nënkyetarin e Gjiçanit, për të parë pasqaj një sfaqje Teatrit Profesionalist të qytetit; u përctuan 2 vepra të pjesëmarrësve Seminarit, u mbajt një takim me shkrimtarët dhe Seminaristët i prij dhe Kryetari i Kosovës.

Duke e vlerësuar lart interesimin për kurset e mësimi të gjuhës shqipe, sidomos nga të rinjtë, ne do të vazhdojmë ta kultivojmë dhe ta begojmë këtë segment të rëndësishëm të veprimtarisë sonë dhe për të a dhmen. Rendimentet evidente të leksioneve të kuadër të kurseve të gjuhësisë dhe të letërsisë na bëjnë të mendojmë që në vitet e ardhme të pëprijemi të sigurojmë forma shumëfishimi të këtyre leksioneve. Refrimet shkencore sivjet shtruan shumë gëshije me vlerë për studim albanologjike nga aspekte të ndryshme. Duket se kjo është një një format e përshtatshme për komunikim idesh, që do të vazhdojë dhe në ardhmen.

Tryeza për veprën e Faik Konicës riaktualizoi shumë nga njohjet e kishim për këtë autor me rëndësi në letrat shqipe, ndërsa tryeza për mësimin e gjuhës dhe të letërsisë në shkolla shtroi një problem mprehtë për shkollat shqipe. Aty u rrahën shumë gëshije, u aktualizue problemet dhe ngecjet, mospërputhjet programore me intencat e zhvillimit, por mbeti shumëëka për t'u diskutuar në institucionet e specializuara. E konsiderojmë sukses nëse kemi arritur ta nxisim shqyrtimi më serioz të këtij problemi.

Seminari i sivjemë në pjesën e tij të fundit të punës u përgëmmdu në dy tema bosht: Letërsia e arbëreshëve dhe Foljet në gjuhën shqipe. Interesimi i pjesëmarrësve ishte shumë i madh, kështuqë u desh i punonim në sesione paralele me nga tri seanca.

Njohjet tona për letërsinë arbëreshe, megjithë informacionin që kemi, ende nuk janë në shkallën që do të dëshironim, sepse ende ka autori

dhe vepra nga e kaluara të pabotuara ose mungojnë versionet e stabilizuara. Nga ana tjetër, ka dhe probleme të natyrës gjuhësore, që poashtu e vështirësojnë komunikimin me lexuesit, sakohë qëu nuk ka botimer me shënime. Kuptohet që për studiuesit e letërsisë të parme kanëu genë qëshfjet e interpretimit dhe të vlerësimit, të cilat tani munda të bëhen pa shtrëngesat e natyrës jashtëletrare dhe me një sens normal kritik. Sesonit shtrai shumë qëshfje, aktualizoi ide, vepra dhe autorë. U diskutua sidomos për traditën nga shekulli 19 e kënde, ndërsa vëmendjen e shumëve e tërhuqti letërsia e sotme.

Sesonit për fojet në gjuhën shqipe kishte poashtu shumë të interesuar. Një pjesë e mirë e diskutimeve dhe shqyrtimeve u përqëndrua në qëshfjet e ndërimit dhe të funksionimit të foljeve në gjuhën e sotme. Vështirimi i këtyr segmentit me rëndësi themelore të strukturës gramatiko-kore të shqipes nga aspekti i analizës kontrastive me gjuhët e tjera që poashtu i pranishëm. Një numër kumesash me peshtë u mor me aspektet e zhvillimit diakronik të foljeve. Diskutimet e gjera i shuan edhe më shumë vlerat e këtyr debati.

Në letërsi në format e ndryshme të punës të këtyr Seminarit sivjet morën pjesë mbi 90 studiues dhe të interesuar nga vende të ndryshme të botës dhe mbi 70 vendorë. Përveç shumë të interesuarve nga vendet evropiane, si Gjermania, Polonia, Hungaria, Franca, Bullgaria, Greqia, Britania e Madhe, Irlanda, nga SHBA, Kanadaja e Japonia, nga vendet arabë, nga Vendet fqinje, sivjet na gëzoi pjesëmarrja më e madhe e arbëreshëve të Italisë. Presim që në vilet e ardashme prania e arbëreshëve të shtohet edhe më shumë, ashtu siç presim që në Seminar të kemi më shumë arbërorë nga Greqia. Na gëzoi shumë dhe prania e shqiptarëve të Sirisë dhe të vendeve arabe.

Në punën e Seminarit sivjet kishim dhe pjesëmarrë nga Magedonia – nga Shkupi, Tetova dhe Struga, ndërsa nga Republika e Shqipërisë na gëzoi pjesëmarrja e studiuesve nga të gjitha gendrat universitare.

Falënderoj bashkëdrejtorin e Seminarit, profesor dr. Ethem Likajn, dekan I fakultetit të Historisë-Filologjisë të UT-së bashkë me stafin e tij për ndihmën që kanë dhënë për mbarrëvajtjen e punimeve të këtyr Seminarit.

Dua të falënderoj posaçërisht Dekanatin e Fakultetit të Filologjisë të UT-së, i cili jo vetëm se na vuri në dispozicion mjediset për punë normale, por edhe vetë u angazhua për mbarrëvajtjen e punës.

Dua të falënderoj këtu para jush sekretarin e Seminarit profesor dr. Isak Shemën, bashkësektretarin prof. dr. Ymer Çirakun, sekretarët profesionalë mr. Osman Gashi, Bardh Rugova dhe Kastriot Gjika, ashtu s dhe të gjithë arsimtarët e Degës së Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë që gjatë gjithë kësaj kohe kanë genë këtu me.

Seminari ynë sivjet nuk mund t'i zhvillonte punimet dhe t'i realizonte detyrat e tij pa ndihmën dhe përkrahjen themelore financiare të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë të Qeverisë së Kosovës, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Qëshfjeve Jc rezidenciale të Qeverisë së Kosovës, të Ministrisë së Edukimit dhe të Shkencës të Republikës së Shqipërisë; Seminarin e sivjemë e kanë mbështetur materialisht Rektorati i UT-së, WUS-Austria, Banja e Klokoti Shtëpia botuese Dukagjini, Kompania Hoteliere 'Kosova', Ndërmarrja verëtare nga Rahoveci dhe Nekra.

I falënderojmë të gjithë.

Dua të falënderoj po ashtu mjetet e informimit, elektronike dhe të shkruara, që me zell dhe dashamirësi të madhe i ndoqën punimet Seminarit, duke pasqyruar gjerësisht veprimtarinë e tij dhe duke e afrue kështu Seminarin edhe më shumë me qytetarët e Prishtinës dhe të Kosovës.

Mirupafshim në Seminarin 22!

Prishtinë, 1 shtator 2002

LIGJËRATA

**PËRKATËSIA DIALEKTORE E GJUHËS SË “MESHARIT” TË
GJON BUZUKUT DHE NGA Ç’VEPËR U PËRKTHYE KY LIBËR?**

Pyetja e parë mund të marrë një farë përgjigje pasi të jetë bërë regjistrimi i inventarit të disa gloseve karakteristike fonetike, morfologjike e leksikore në dy dialektet që gjejmë bashkëtakime e bashkëpërpulthje me të gjuhës së “Mesharit”. Numri më i madh i vegorive të dialektit veri-perëndimor gjën përkime me të “Mesharit” e të këtij me të verilindorit.

“Meshari” i Gjon Buzukut – vepra e parë e plotë shqip që dimë deri më sot, ruan një vlerë të dorës së parë për historinë e shkrimit të kulturës shqiptare, sidomos për kulturën tonë.

Edhe “Meshari” i Buzukut – sikundër veprat e rangut të tij me vlerë të pallogaritshme në kulturat nacionale të popujve, të kombeve, pati risikun që edhe pasi ishte zbuluar nga arqipeshkvi shqiptar Gjon Nikollë Kazazi – ra në haresë për një kohë më se treqindvjeçare dhe u përshtua nëpër peripeji të shumënduarshme. Vepërës së parë të filologjisë shqiptare vetëm në kohën tonë i gëzoi fati të bëhet prona e botës shkencore – thotë Çabej në hyrjen e botimit kritik të “Mesharit”.

Po të përjashtohen disa skica e punime me vlerë të pakontestueshme nga autorë të ndryshëm shqiptarë e të huaj, me autorin e librit e Buzukut, janë marrë në mënyrë më të thelluar tre lingvistë shqiptarë: Çabej, Resuli dhe Canaj. Dy të parëve ua dimë për nder t’i kenë hyrë punës e të kenë bërë transliterimin dhe transkriptimin e mbarë tekstit të “Mesharit”. Martin Canaj “Mesharit” të Buzukut i ishte sjellë dy herë, herën e parë te Godish-njaku I i Instituti Ballkanologjik të Sarajevës (1957), herën tjetër si tezë doktorate; në Institutin e Studimeve Shqiptare të Universitetit të Romës mbrojtë punimin e disertacionit: “Il messale di Gjon Buzuku – Contributi linguistici allo studio della genesi”.

Vellimit të parë të “Mesharit” i printe një hyrje njëqind faqesh të formatit të madh duke ngritur një varg gëshqesh të karakterit të ndryshëm, nga dora e mjeshtri Çabej.

Bashkorganizimi i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare nga viti 1995 me institucionet homologe nga Tirana, filimisht me Institutin e Gjuhësise dhe të Letërsisë, kurse nga siviçet me Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë e ka shuar peshën e Seminarit, thellësinë, cilësinë dhe përgjithësisht nivelin e punimeve të tij. Me këtë rast nuk mund të mos shprehim gëzimin tonë të madh që dy qendrat e njohura albanologjike Tirana dhe Prishtina, në rrethanat e reja që u krijuan pas luftës çlirimtare, punojnë të papenguar nga askush në avancimin e studimeve albanologjike dhe afirmimin e tyre në botë.

Duke i hapur punimet e Seminarit të 21-të, edhe një herë ju dëshiroj suksese në punën tuaj, me shpresë që njohuritë tuaja për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare do t'i zgjeroni e t'i thelloni më tej dhe ta njihni Prishtinën, Kosovën dhe njerezit e saj sa më mirë.

Falemnderit

Akademik Rexhep ISMAILI

FJALA E MBYLLJES SË PUNIMEVE TË SEMINARIT XXI

Të nderuar pjesëmarrës të Seminarit XXI për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare,

Me përfundimin e punimeve të dy sesioneve shkencore po merr fun pjesa e punës e Seminarit të sivjemë.

Gjatë këtyre dy javëve të shogërrimit tonë intensiv u zhvillua një veprimtari shumë e ngjeshur mësimore, kulturore dhe shkencore, u këmbye ide, përvoja, u realizua një program shumë i begatshëm dhe me rezultate, përmbushën synimet që ia kishim shtruar vetes.

Veprimtarinë e vet në Fillim Qendra e Kulturës Shqiptare për 1 Huajt e Fakultetit të Filozofisë/Filologjisë të UP-së, më vonë Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, në vitin 1974 kishte nisur me një synim të parmit që të jepte ndihmë për mësimin e gjuhës shqipe për studentët dhe studiuesit e huaj që merreshim me gjuhën dhe kulturën shqiptare. Në 20 ditët e Seminarit të parë që organizoi kjo qendër një qëllim i tillë realizua me përkushim. U mbajtën mësimet intensive të gjuhës, u përgatit teksti për atë rast, por njëherësh u mbajtën dhe ligjëratat dhe veprimtari të tjera shkencore e kulturore, të cilat në të njëjtën kohë rënë në mundshme të hetonim më mirë cilat ishin kërkesat dhe nevojat e t fuarve, cilat ishin mundësitë tona dhe njëherësh të shihnim se edhe r kishim nevojë për këtë organizim, në mënyrë që të kapërcenim ndajet dhe izolimet në studimet albanologjike që na kishin imponuar ndajet politike shtetërore. Kështu fare natyrisht Seminarit mori mbi vete role dhe detyra c shkonin shumë përtej synimeve të parme, erdhi e u shndërrua në n institucion të mësimdhënies, por njëherësh të prezantimit, të nxitjes dhe zhvillimit të interesimeve, të dijeve dhe të njohjeve në fushën albanologjisë dhe të ballkanologjisë. Për mendimin tim ai u bë kështu n universitet veror për studimet albanologjike në kuptimin e vërtetë të fjalës Vlerat e rëndësishme që kultivoi ai me ngulm, si komunikimi i ideve dhe dijeve, kontaktet dhe këmbimet me studiues dhe vende të ndryshme, r

Titulli i temës sonë na detyron të merremi me çështjen e gjuhës së “Mesharit” e aty të konstatojmë edhe ne cilit dialekt të gjuhës sonë i takon gjuha e tij. Mendimet e studiuesve për gjuhën e Buzukut në veprën e tij, janë të ndara.

Çabej, i cili me këtë problem ishte marrë më shumë se të tjerët, thotë se gjuha e Buzukut nuk duhet të këqyret nga pikëpamja e raportit dialekt-dialekt, por gjuhë-dialekt. Ai gjuhën e Buzukut e shikon si një gjuhë mbilindja e Buzukut, gjykuar mbi bazën e gjuhës së veprës së tij - “Mesharit”, duhet të jetë krahina e Shestaniit dhe dialekti veriperëndimor:

Duhet t’i japim rrugë çështjes që shtrohet në vështirimin tonë të shkurtër, a mbajnë peshtë gegizmat verilindorë, jo të paktë në “Mesharin” e Buzukut që autori i përkthimit të tij, prifti shqiptar, të pandehet me prej-ardhje nga viset e Kosovës në shtegime individësh apo grupeesh të popull-sisë nga Kosova në Krahinën e Shestaniit (Briisk, Larje).

Karakteristikat gjuhësore:

“Meshari”: dftongu *uo*, e ka edhe Shestani, mandej Budi; përdorimi i përmrit vektor *u* (Buzuku), Shestani dhe Arbëneshi *un*, fsharat e Medvegjës *u*;

Buz. *Sod*, Briisku. shestani *sot*; Arbëneshi *sol*

Budi – *sot* – horë mbë horë e *sod* mbë nesërë;

Bogdani – *sod*

Da Lecce – *sod*, Matranga – *sot*.

Imperfekti asigmatik te të dyja palët:

Disa forma “toske” – *një* në vend *njā*;

Briisku e Shestani edhe bānj – bēnj

Ulqini *isht* (është).

Buzuku – *i verdhë* (i blertë) Arbëneshi *verdh* “žut”, Kruno Krsitić, fjalori; Kosova *i verdhë* “i blertë”, që ka ngjyrën e barit dhe të gjetheve të njoma, i gjelbër.

Nga morfologjia:

Imperfektet e vetës III të njëjësit me *ke*, formimi i kohëve të përbëra me foljen “jam” në vend të foljes “kam”: *jam datë, ish ardhunë, ishne votë*; indikativ për koniuktivin në disa rase si të – *të ban, të del, të jeshon*, edhe Budi RR, Bogdani = aj që të pushton.

Nga leksiku: *vëliz*: Arbëneshi *vliz*, mos rri si guri, vilizu (Kruno Krsitić Rječnik govora Arbanasa kod Zadra. Hapja e *u*-së së theksuar: *u>o*: Lëkundunë – lëkundun.

Kosova: jo “duket”, po “doker”!

Buzuku: *kune, kon; ordhënit e urdhënit*.

Njëri ndër problemet e vështira në grafinë buzukiane paraget, pa-dyshim, përdorimi një të ashtuquajturit tingull “tracona” *h* fundor të shumë fjalëve që mbaronin me zanore *e*, nganjëherë edhe në fillim fjale që gjithnjë miste me zanore.

Justin Rrota, siç thotë Camaj, (Vep. e tij 13) paramendon që *h*-ja Buzukut i hynte në punë për t’i ndarë fjalët njëtrën nga tjetra, një mendim që tani së fundi e gjen të drejtë edhe Ressuli, Il Messale di Giovanni Buzuku, Citta del Vaticano, 1958 Biblioteca Apostolica Atticana, 1958, Rrota, në të njëjtën kohë, mbështet mendimin sipas të cilit *h*-ja mund të jetë refleks i një grafie të gjuhëve sllave. “Një hipotezë e tillë është absurde, thotë – Camaj, sepse ajo (*h*-ja) gjendet rregullisht në fillim të fjalëve dhe të një kapitulli apo cope, pjesë të shqëputur, cope, fragmenti të ungjillit. Nuk mund të pohohet, gjithashu (nuk mund të pranohet) që *h*-ja të jetë refleks i ndonjë farë grafie sllave meqenëse ajo është karakteristikë e të gjitha grafive cilinike në të cilat çdo shenjë i përgjigjet një tingulli të caktuar, ndërsa këtu, në rastin tonë të “Mesharit” *h*-ja nuk përfaqëson farë tingulli specifik të vetin.

Sipas nesh, thotë Camaj (Vep. 13), *h*-ja paraget një shenjë grafie që ruan funksionin e një vlerë që ka një vokal në fund fjale, e që ka kuptim përforcimi të atij vokali.

Nga historia e alfabeit latin në përgjithësi dimë se *h*-ja, duke humbur vlerën fonetike të saj në gjuhët neolatine shkrimtarët dhe tipografët e përdorin atë për të ndryshuar ndonjë prej konsonanteve siç ka ndodhur në italishten me *ch* (chiesa) *gh* (ghirlanda)... prandaj është afërmeq mendimi i G. Weigandit që *h*-ja ka shërbyer për të shënuar një shqiptim më të gjatë të zanores fundore.

Këto lëkundje tregojnë se, edhe në ka shënuar *h*-ja një shqiptim të caktuar në këto rase, ky shqiptim nuk ka qenë i rregullt. Pra shkrimi i kësaj *h*-je duhet të jetë shpeshherë konvencional, fq. 56-57 Çabej, “Meshari”.

Çabej dhe Camaj, ndër shqiptarë, janë pa farë dyshimi studiuesi më seriozë që kanë hyrë në analizën e gjithanshme të “Mesharit” të Buzukut e që është vepra e parë e llojit të vet në historinë e letërsisë shqiptare; ajo është, njëkohësisht vepër – përkthim nga tekstet gjegjëse latinisht dhe versionet përkatëse italisht.

E kishim theksuar edhe në fillimet e këtij vështrimi të shkurtër se, vëç prof. Çabejt në studimin e shkrimtarit të parë të kulturës shqiptare shquhet

prof. Martin Camaj. Rrallëherë ndodh që dy njohës – rreth së njëjtës problematikë të kenë vendime identike; mos të ishte kështu progresi kulturor e shkencor do të ecte me hapa shumë më të ngadalshëm. Këtu, konkreisht është fjala për priftin shqiptar Gjon Buzukun, formimin e shkollimitin e tij, pastaj për punën e tij rreth përkthimit të librit të parë, me sa dihet, në letërsinë shqiptare, meqë Buzuku ishte një prift katolik, materiali mbi të cilin punoi në përkthimin e “Mesharit” të vet, do të ketë qenë, padyshim, kryesisht në latinisht, natyrisht nuk mund të përjashtohet edhe mundësia të jenë shfrytëzuar edhe shkrimet përkatëse kishare edhe në gjuhë të tjera, italisht, sllavisht (serbokroatisht).

Familia ku shërbente prifti shqiptar i takonte dioqezës së Tivarit, jo aq larg nga Dubrovniku.

Në Dubrovnik shqiptarë ka pasur qysh nga mesjeta e vonë bukur shumë: tregtarë, zejtarë, e sidomos murgj e priftërinj, të ardhur prej viseve të Shqipërisë Veriore, në kohë të gjallërimit dhe lulëzimit të lundrimit nëpër dete e oqeanë, e studimet teologjike edhe për vetë raguzanët kishin bjerrë interesimin, tluhaja krejt – thotë historiani çek Konstantin Jireček, Zbornik II, fq. 51 (Arbanasa je pri kraju srednjega veka bilo u Dubrovniku vrlo mnogo...).

Gjithë puna që ka të bëjë në lidhje me këtë libër si përkthim po sillët rreth problemit të vetëm e kryesor, e ky është të dihet siç kërkonte edhe prof. Çabej, se nga ç’vepër u përkthye ky libër.

Vepra e parë e kulturës shqiptare u mor gjithanshëm nga dijetarët tanë për t’i rënë në fije jo vetëm veprës kryesore origjinale latinisht nga e cila, në pjesën më të madhe u bë përkthimi i “Mesharit”, por gjurmuesit e përkthimit gjetën edhe tekste të tjera prej të cilave eventualisht prifti shqiptar jo vetëm i kishte konsultuar, por nga diçka edhe marrë si material përkthimi.

“Buria e fjalëve latine – romane e mungesa e termave sllavë në gjuhën fetare tregojnë se në kohën e dyndjeve sllave në Shqipëri ka pasur qytete me organizim kishar e me jurisdikcion përkatës të formuar dhe me një liturgji e terminologji fetare në pjesën më të madhe të burimit latin – roman – vazhdon prof. Çabej. Natyrisht, tekstet sllave të cilat edhe nuk i mungonin famulltarit shqiptar, nuk e kanë autoritetin e origjinalit latin, porse ato atij i shërbenin si objekt konsultimi në punën e vështirë të përkthimit dhe të përshatjes” përfundon Çabej.

Në hyrjen e “Mesharit” – një studim jo edhe i vogël, por i gjith-anshëm, prof. Çabej bie një fragment të shkurtër nga një vështrim për Gjon Buzukun – duke i hapur, qysh e quajti linguishti shqiptar “kështu dijes një rrugë që

Buzuku ka punuar nën një frymëzim françeskan, mbase përmbi një model françeskan analog me një horolog sllavisht (libër officesh e uratash) të Bosnjes, të vitit 1512, i cili nga përmbajtja afrohet shumë me veprën tonë” (Çabej, “Meshari” i Gjon Buzikut, Tiranë, 1968, fq. 26).

Në mungesë të këtyre shkrimeve, Çabej “Mesharin” e kishte krahasuar me këto tekste: Për pjesën përpara “Mesharit” krahasimin e kishte bërë me të copëve përkatëse që gjenden nëpër brevjarë, libra officesh, kate-kizma e rituale, ndërsa përfaqjen e kishte bërë me mesharët latinë dhe atë të Venedikut të vitit 1598, duke shtuar edhe mesharët modernë me përkthimin italisht.

Që autori për këtë pjesë të veprës së tij ka pasur përpara për model mesharë shihet dhe nga kjo që pjesët biblike të kësaj paraqitjen në formën që ndeshet zakonisht nëpër mesharë. Kjo nganjëherë ndryshon nga forma biblike e rëndomta, sidomos në fillim a në mbarim të copës a të artikullit. (Këtu gjejmë *Ná atë mot*, pas tekstit të “Mesharit” “In illo tempore”, në Bibël “Et post dies sex”).

Në “Mesharin” Çabej shihet shpesh një largim nga teksti latin e njëkohësisht një pajtim me versionin italisht, si një lufje e urarë, si në copët biblike. Këtu ndërkaq, vërente një tjetër gjë e që bie në sy. Në pjesët e Biblës teksti shqip disa herë largohet nga teksti latin e italian, duke shkruar, për pjesët e Dhjatës së vjetër, jo me Vulgatën po me Septuagintën. Edhe në copët e Dhjatës së Re teksti atje disa herë piget jo me tekstin grek të Korinësë, po me ungjillin e traditës bizantine të greqishtes së re. Në këtë mënyrë ky tekst katolik përkton me ungjillin e Korfustit (Grigorit, 1827) e të Kristoforidit (1872) botime shqip që i përkasin kishës greke – ortodokse. Si do shpieguar – pyet Çabej, një fakt i tillë?

Maria nga buimet e greqishtes në çdo rasë nuk mund të ketë qenë ndryshe vegëse me një rrugë indirekte – vijon linguishti shqiptar Çabej. Në këto rrethana gëshiha gjen shpiegimin e saj të natyrishtin po të mendohet – sgaron dijetari shqiptar, që burimi i pandërmjetëm ka qenë ndonjëtri nga shkrimet sllave jugore të Bonjës, Dalmacisë e Kroacisë. Këto edhe pse ishin të rrit latin, vijonin traditën bizantine të sllavishtes së vjetër kishare – qartëson prof. Çabej.

Në vijim të këtyre mendimeve Çabej vlerëson se libri i lufjeve përmban një officium beatae Mariae Virginis (Oficje blažene djeve Marije) të mbarimit të shekullit XIV ose të fillimit XV, që përputhet kështu në përmbajtje me pjesën e parë të librit shqip dhe mund të jetë model ose një nga librat fetarë sllavë që ka pasur për model autori shqiptar në hartim të

veprës së tij; në rrjedhje të gjykimin të tij, Çabej është i palëkundur në mendimin e tij se prifti shqiptar kishte punuar mbi një tekst model në tri gjuhë ose mbi tri modele të ndryshme: latinisht, italisht e serbokroatisht.

Pasi parashtrua gjykimin e studiuës kryesor të monumentit të parë të literaturës dhe të kulturës shqiptare prof. Çabej me shpjegimet që ai jepc se cili ishte teksti model mbi të cilin punoi përkthyesi shqiptar Buzuku, në vijim duam të shohim mbi cilin tekst kryesor a librin model, sipas mendimit të studiuës dhe njohësit tjetër prof. Martin Camaj, punoi prifti shqiptar Gjon Buzuku.

Kur është fjala për punën e këtyre dy njohësve të Buzukut dhe të veprës së tij, një gjuhë që në këtë mes do të theksohet, është kjo që të dy këta studiuës të priftit shqiptar dhe të “Mesharit” të tij janë mbështetur, pothuaj në të njëjtën literaturë, e në këto tri gjuhë të huaja: latinisht, italisht e sllavisht (serbokroatisht) nga të cilat është bërë përkthimi në shqipen.

Në mbështetje të këtyre njoftimeve historike mund të nxirret si përfundim se priftërinjtë shqiptarë që janë marrë me përkthime tekstesh fetare në gjuhën shqipe duhet të kenë qenë me siguri përfshirë në lidhje të ngushtë me traditat letrare liturgjike në gjuhën kroate, sidomos me të ashtuquajturit “lekcionarë”. Porse do të duhej të saktësohet njëherë e mirë që në fillim që ndikimi i lekcionarëve (librave fetarë) kroatë mbi veprën buzukiane të dëshmohej, sidomos, në refleksin e leksikut e herë-herë në mënyrë që t’i përçojë idetë ungjillore në gjuhën e popullit – (M. Camaj, Messale, fq. 59).

Në vazhdim të këtyre gjykimëve në vijim e lidhje është edhe studimi i prof. F. Francevit, i cili thotë se Letërsia glagolike tërheq origjinën e saj nga literatura liturgjike e kishës moravo-panonike të shenjtorëve Kiril e Metodi, por që në vazhdimësi pësoi ndikim të fortë nga liturgjia e Vulgatës latine, sidomos pas shekullit XIII, II Messale, 56.

E historia e literaturës glagolike humbet në errësirën e kohës, por dihet me saktësi, duke u nisur nga shekulli X e këtej, se kjo literaturë ishte në kundërshtim me literaturën liturgjike latine, e cila dalngadalë u imponua, pothuaj, mbi të gjitha kishat katolike të Kroacisë, duke shkaktuar shmangie të ndryshme të teksteve glagolike. Priftërinjtë katolikë që kryenin një ceremoni të rriti fetar në gjuhën sllave quheshin “glagolashtë” për t’u dalluar nga kleri që në kryejën e sakramentit përdorte latinishten, II Messale, 56.

I bindur, gjithashtu, se në Shqipëri ekzistonte qysh para Buzukut një traditë shkrimore në gjuhën shqipe, në një masë, natyrisht, më të vogël se ç’ishte në sllavishten fetare dhe me një paraqitje të veçantë përsa i përket përdorimit dhe qëllimit, kam krahasuar “Mesharin” tonë në shumë pika të tij

sesa largohet ai nga Vulgata latine dhe sa afrohet me ndonjë meshar komplet glagolik, për të parë nëse ka ndonjë lidhje. Jo vetëm që nuk gjene kurrfarë lidhjeje sintaktike, por as ka gjurmë më të vogël ndikimesh leksikore, ashtu që përfashtohej çdo përkthim shqip nga tekste të tilla. Porse nuk mund të përfashtohet familiariteti i priftërinjëve dhe i fetarëve, sidomos i françeskanëve me gjuhën popullore sllave, përkundrazi, duke pasur ata nevojë të ushtronin profesionin e tyre në trevat e sipërpërmendura, njohja e kroatishtes a serbishtes ishte e domosdoshme. Një gjë që dëshmohej me faktin që temat sllavë të përdorur te Buzuku ruajnë karakterin e gjuhës popullore: formën jekave, ndërkaq nuk mungojnë gjithashtu trajtat ikave, II Messale, 57-58.

Studiuës tanë të “Mesharit” dhe të autorit të tij, Çabej dhe Camaj, kishin konstatuar se përkthyesi i librit të parë në letërsinë shqiptare, Gjon Buzuku, njihje jo aq mirë latinishten dhe sllavishten, po mjaft mirë italishten. Mendimi i dalë nga përkthimi latinisht shpesh nuk kishte kuptim, kurse në vende të tjera po ajo fjali, thujja mbaronte pa kurrfarë të meje. Nganjëherë në tekste biblike ndeshim forma toske në mbështetje të të cilave studiuës i “Mesharit” Camaj i kishte ngritur në fenomen gjuhësor, të vësh-tirë për ta kuptuar dhe për ta mbështetur gjuhësisht, bie fjala në tekstin bib-lik shqip përkthyesit Buzuku ndër fjalitë e perëndave i përvihen trajta toske, një gjë që në ato kohë e në ato rrethana historike e raportesh kulturore ndërshtqiptare ishte e pamundur: ...a munde dalale cun *gje* të mireh en nazaret? (Buz. 191-21), “Mendoj se kjo është drejtpërdrejt një huazim toskë, por, ndoshta ndjek rrudhjen sipas dialektit gegë: në rastin tonë do të jetë forma *gje*”, Camaj, II “Messale” di Gjon Buzuku, Shejzat, Roma, 1960.

Prandaj pas një shqyrtimi të vëmendshëm të “Mesharit” nuk më bind aspak pohimi i Çabejt se i gjithë libri të jetë veprë individuale e një shkri-mari të vetëm, II “Messale” di Gjon Buzuku, fq. 33, Shejzat, Roma 1960.

Studiuës tanë të “Mesharit” dhe të autorit të tij nuk lënë pa vënë re edhe disa trajta gramatikore që të “kujtojnë” toskërishten në veprën e Buzukut.

Çabej: *ë* për *ā* = *është*, në kush *ë* e *s’ë* këtu që del sot në Shëstan – në vargun: Kush *ë* djal e i pamartuo,

Të mos fterë, të shpëblerë mag(j)ëritë, kun *gje* të mirë dhe Çabej gëshfjen nuk e nget më tej: “Fjalët e këtij grupi përbëjnë një problem në vetë” – përfundon prof. Çabej “Mesharit” i Gjon Buzukut, fq. 16.

Ka shumë të ngjarë – thekson prof. Çabej që pas reformimit të lib-ravet liturgjike që vendosi Koncili tridentin në Kuvendin e trejtë (e sidomos pas redaktimit të ri të breviarit që kreu papa Pius V më 1568 e atij të mesharit e

të katekizmit që bëri ai më 1570), e pas botimit zyrtar të Vulgatës që u bë nën Sikstin V më 1590, e që mori formë të përcaktuar më 1598, ky libër të ketë pësuar atë fat që patën shumica e librave liturgjike botuar para Koncilit: si një manual i vjetëruar mbeti jashtë përdorimit; me gjithëse, nga mungesa e librave të tjerë në ndonjë famull do të ketë vijuar të përdorej dhe disa kohë, siç dëshmojnë dhe anëshkrimet e "Mesharit". Kjo mund të jetë dhe një nga arsyet pse ky libër gjendet sot në një të vetëm ekzemplar. Sidoqotë, në këtë mënyrë më në fund kjo përpjekje sporadike për të shturë në liturgji gjuhën e vendit. Pas mendimit tonë – shton Çabej kjo është e para përpjekje në këtë drejtim, sepse në një kohë më të parë as që ishin pjekur rrethanat për një punë të tillë.

Në këtë punim me titull "Përkatsia dialektore e gjuhës së "Mesharit" të Gjon Buzikut dhe nga ç'vepër u përkthye ky libër", dy janë gëshije kardinale që vihen për shqyrtim:

A. Baza dialektore e gjuhës së "Mesharit" dhe

B. Nga ç'vepër u përkthye libri (Meshari);

Këtyre u bashkohen gëshije të dorës së dytë: ç'ingull (a fonemë) paraqet grafema *h*;

-Si duan kuptuar a shpjeguar disa gegizma verilindorë në Mesharin e Gjon Buzikut;

-Si shpjegohen paksa toskizma në gjuhën e Mesharit;

-Një tok vegorish fonetike, morfologjike, një grumbull glosash interesante.

Duhet t'i japim rrugë gëshjes që shtrihet në vështirimin tonë, a mbajnë peshë gegizmat verilindorë jo të pakë në "Mesharin" e Buzikut për çka autori i përkthimit të tij prifti shqiptar të pandehet me prejardhje nga viset e Kosovës në shtegime individësh apo grupesh të popullsisë nga Ko-sova në Krahinën e Sheshanit (Brisk e Ljare).

Çabej: Për grafemën *h*: Disa lëkundje tregojnë se, edhe në ka shënuar *h*-ja një shqiptim të caktuar në rasta të tilla, ky shqiptim nuk ka qenë i rregullt. Për, shkrimi i kësaj *h*-je – thotë Çabej duhet të jetë shpeshherë konvencional, Meshari, fq. 56-57.

Camaj: Sipas nesh – thotë Camaj (vep. 13) *h*-ja paraqet një shenjë grafike që ruan funksionin e një vlerë që ka një vokal në fund fjale, e që ka kuptim përforcimi të atij vokali.

Studuesit tanë të "Mesharit" dhe të autorit të tij nuk lënë pa vënë re edhe disa trajta gramatikore që të "kujtojnë" toskërishten në veprën e Buzikut:

-ë për *ā* = është

-kush *ē* e *s'ē*

-kush *ē* djal e i pamartuo (Sheshani)
-të mos fletë, të shpërblerë
-mag(j)ëritë; prof. Çabej gëshijen nuk e nget më tej: "Fjalët e këtij grup përbëjnë një problem në vete", përfundon prof. Çabej te "Meshari" i Gjon Buzikut, fq. 16.

Nga njëherë në tekste biblike ndeshim, siç po shihet forma toske, n mbështetje të të cilave studiuesi i "Mesharit" Camaj i kishin ngritur në feno men gjuhësor, të vështirë për ta kuptuar dhe për ta mbështetur gjunjësish bie fjala në tekstin biblik shqip përkthyesit Buzikut ndër fjalitë e periudhës i përvindhen trajta toske, një gjë që në ato kohë e ndër ato rrethana historike raportesh kulturore ndërshtypare ishte e pamundur:

-a munde dalle cun gjë të mire en nazareit? (Buzuku, 191, 21), e Camaj "mendoj se kjo është drejtpërdrejt një huazim toskë, por, ndoshta ndje rrudhjen sipas dialektit gegë: në rastin do të jetë formë gjë<gja, Ca-maj, 1 Messale di Gjon Buzuku, Shëjzat, Roma, 1960: - jo, "ndoshta", me siguri është rrudhja e *ā*-së hundore në *ē*-në hundore, pra, proces i brendshëm fonetik i gegërishtes.

Për ne problem përbën vetëm grupi i dytë i fjalëve që të "kujtojnë" toskërishten ato të rotacizuara – fletë, shpërblerë, pra vetëm këto krijojm problem të mirëfilltë.

Gjithë puna që ka mbetur e që po silllet është problemi i vetëm e kryeso të dihet se nga ç'vepër u përkthye "Meshari" i Buzikut.

Çabej e Camaj janë ndër shqiptarë pa farë dyshimi studiuesit më serioz që kanë hyrë në analizën e gjithanshme të "Mesharit" të Buzikut, e që është vepra e parë e llojit të vet në historinë e letërsisë shqiptare.

Vepra e parë e kulturës shqiptare u mor nga dijetarët tanë për t'i rënë n gjurmë jo vetëm veprës kryesore origjinale nga e cila në pjesën më të madh u bë përkthimi i "Mesharit", por gjurmuesit e përkthimit gjetën edhe tekst të tjera prej të cilave, eventualisht, shqipërimi shqiptar jo vetëm i kishte konsultuar, por nga diçka edhe marrë si material përkthimi.

Në "Mesharin" Çabej shihet shpesh një largim nga teksti latin. Në pjesë e Biblës teksti shqip disa herë largohet, sikundër u tha, nga teksti latin dhe italian, duke shkruar për pjesët e Dhjatës së vjetër jo me Vulgatën, po me Septuagintën. Në këtë mënyrë ky tekst katolik përkton me ungjillin e Kor fustit (Gligorit, 1827) e të Kristoforidhit (1872), botime shqip që i përkasin kishës greke-ortodokse. Si do shpjeguar – pyet Çabej, një fakt i tillë?

Marija nga burimet e greqishtes në çdo rasë (shpjegon linguisti shqiptar) nuk mund të ketë genë ndryshe veçse me një rrugë indirekte – vijon linguisti shqiptar Çabej. Në këto rrethana gëshija gjen shpjegimin e saj të natyrshmin duke menduar – shpjegon dijetari shqiptar, që burimi i pa-ndërmjëmë ka genë ndonjëri nga shkrimet sllave jugore të Bosnjes, Dal-macisë e të Kroacisë.

Ndërkaq studiuesi Martin Camaj duke krahasuar “Mesharin” tonë sesa largohet ai nga Vulgata latine dhe sa afrohet me ndonjë meshar komplet gjegjollik, pohon se nuk kishte gjetur kurrfarë lidhje as gjurmë ndikimesh leksikore, dhe përyashtonte çdo përkthim shqip nga tekste të tilla, në një anë, dhe, në anë tjetër po me aq bindje shprehej se nuk mund të përyashtonte, gjithashtu, familjaritetin e priftërinjve dhe fetarëve, sidomos të frangeskaneve me gjuhën popullore sllave.

Zeqirja BALLATA, Prishtinë

ECJEL/NGECJET DHE SYNNIMET NË KULTURËN TONË MUZIKORE

Punimi ka për qëllim të pasqyrojë rrjedhat e jetës e të kulturës muzikore bashkë me institucione/asociacionet gjatë viteve '50-80, por edhe të viteve '90, kur ato rrjedha u ndërpre në si me thikë. Që ndërprerë për këtë popull edhe puna e të gjitha institucioneve vitale, pra edhe e këtyre muzikore, e manifestimeve/festivaleve, si dhe arsimit shqip përgjithësisht.

Ecjet...

Pas Luftës së Dytë Botërore, në të cilën këta morën pjesë, i kontribuan fillimisht jetës muzikore shogjeritë kultuale-artistike, që vepruan në qendra kosovare është dalluar sidomos SHKA “Agimi” e Prizrenit, e themeluar në fund të vitit 1944, pranë së cilës vepruan ansambli i këngëve e i valleve dhe kori. Këtë të fundit e ka udhëhequr pedagogu, dirigjenti dhe melogafi ynë i njohur *Lorenc Antoni* (1909-1991), i cili ka botuar shtatë blenjë me këngë popullore shqipe nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi dhe punime nga lëmi i folklorit muzikor, si dhe ka përpunuar (*Kore shqiptare, Tri këngë nga Opoja*, suite *Në shendin ulqinak*) e kompozuar këngë korale (përmbledhja *Një gaforre defatore, Trumcakët e Kosovës*), pjesë orkestrale (*Tri rapsodi shqiptare, Na ka dalë nusja mirë, Në Prizrenin e bukur*) e vokale-instrumentale (*Valle e këngë dasme*) me ngjyrim popullor¹. Më pas këtë kor e kanë udhëhequr, veç Engjëll Berishës, edhe *Mark Kaciniari* (1935-85), pedagog në Shkollën e mesme të muzikës në Prizren, në SHLP dhe në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, drejtues i Ansambliit “Collegium cantorum” dhe kompozitor këngësh për pionierë (*Manë o nanë, Drindofillja*

¹ Më gjerësisht për këtë krijues shih Zeqirja Ballata, Mbi disa këngë korale të Lorenc Antonit, Rilindja, 1987. Prishtinë dhe po nga i njëjti autor Këngët për pionierë dhe për korë pionierësh të Lorenc Antonit, Rilindja, dhjetor 1989.

e vogël, *Vendlindja ime*), të përpunuara e origjinale korale për të rritur (*Zogu i Ohrit, Bijtë e Shqipërisë*, Suita korale *Shanikuqja, Prishtinës heroike, Kënga jonë, Serenata*), këngë solo (*Buzë lumit ke shtëpinë, Para pasqyrës*), si dhe për piano (*Duart e vogla, Loja e barit, Elegjia, Suita litere*).

Pas luftës u lejua dhe asininimi, pra edhe ky muzikor, ndonëse jo gjithnjë në gjyhen antare. U themelua, më 1948, në Prizren e para *shkollë e ulët e muzikës* me nisjativë të përmendur L. Antoni. Një vit pas, po në Prizren, me lejinin e Ministrisë së Arsimit dhe Përkrahjen e Këshillatëve J. Slavenski e A. Obradović² u themelua *shkolla e mesme e muzikës*, fillimisht me pak seksione muzikore, por më pas iu shtuan të tjerat; u angazhuan dhe ansamblë nga vise të tjera. Të diplomuarit u shkolluan në akademi muzikore në Beograd, Zagreb, Sarajevë, Lubjanë, Shkup, për t'u kthyer, pas diplomimit, në Kosovë³. Orkestra me korin e shkollës e solistët, i kontribuan jetës muzikore në qytet, ndërsa kori i shkollës ka marrë pjesë në takimet dhe garat republikane e federative, si dhe është shpërblyer në Festivalin e koreve në Celje të Sllovenisë.

Aktivitetet e solistëve dhe të grupeve vokale i kanë orientuar herëherës në Radio-Prishtinë *Rexho Mulliqi* (1923-1982), pedagog në Shkollën e mesme të muzikës në Prizren, redaktor muzikor e udhëheqës kori pranë Radio-Prishtinës, si dhe kompozitor përpunimesh (*Lulëzoi fusha, Nji lule, Suita e vogël, Barështa*), këngësh revolucionare (27 marsi '41, *Demonstrata, Marshi im divizionit VI Shqiptar, Kënga e republikës, Mbjajmë flamurin e lirisë, Vendi im*) e të tjera korale (*Vjeshta*), solistike (*Elegjia, Legjenda*), veprave vokalo-instrumentale (*Poema për ata, Vdekja e herotit*), i ayre orkestrale (*Fantazia, Simfonia nr. 1, Pastorajla dhe vallja, Akuarelet e Prizrenit, Freska e meditime, Simfonia nr. 2 "Kosovare"*), muzikore-skenike (ballet *Legjenda mbi ngadhënjimin, Nita*) dhe për teatro (*Erveheja, Halili e Hajria...*), TV (*Kokë për kokë, Ari i Kosovës, Tubeliu, 117...*) e film (*Kapiten Lleshi, Qërim hesapesh, Uka i Beshkëve të Nemuna, Era dhe Lisi*),

² Josip Slavenski (1896-1955), një nga figurat qendrore muzikore jugosllave mes dy luftërave dhe më pas, që ka krijuar mbi parime të reja estetike, autor veprash solistike, të dhomës, vokalo-instrumentale e orkestrale, të mbështetura, në të shumtën, në folklorin burimor. Aleksandar Obradović (1924), kompozitor seb e pedagog. Në veprat e tij simfonike, vokalo-instrumentale dhe të dhomës i ka sistemuar mjetet muzikore tradicionale me ato bashkëkohore brenda struktura stabile të formës, si dhe ka përdorur, veç elementeve dodekatonike, edhe asosh aleatorike dhe muzikë elektronike.

³ Mbi veprimtarinë e disa kompozitorëve kosovarë, shih Zeqija Ballata, Gjurmëve të muzës, OPGBG, "Rilindja", Prishtinë, 1987, fq. 69-77, 117-124, 190-207.

të frymëzuara nga folklori muzikor shqiptar⁴. Me këto grupe vokale, që më vonë janë ngritur në kor (1956), ka punuar edhe L. Antoni. Ndërkaq, që më parë, ka qenë e themeluar *Orkestra (e vogël) simfonike* (1951), e udhëhequr fillimisht nga B. Vojinoviç, më vonë nga O. Ristiç.

Në vitet '60 dhe më pas themelohen edhe institucione kulturo-arsimore e shkencor-artistike⁵, pra edhe kësosh muzikore. U themelua *Shkolla e ulët dhe ajo e mesme e muzikës* (1962) në Prishtinë, më vonë ajo e ulët e muzikës në Mitrovicë (1954). Më 1961, pranë Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë, u hap *Grupi i edukatës muzikore*, në të cilin studiuin, përveç studentëve kosovarë, edhe nga Serbia Jugore (Kosova lindore), Magedonia Perëndimore e Mali i Zi. Një nga festivalet më të hershëm të popullarizuar të kësaj periudhe qenë *Akordet e Kosovës*, themeluar më 1961. Në të, për afro tri dekada me rradhë kanë marrë pjesë kompozitorë, solistë e aranzherë nga Kosova e Jugosllavia. Muzikantë tanë të këtij zhanri (K. Lekaj, S. Gjinali, R. Randobrava, I. Muçolli, Gj. Kaçinari, P. Badivuku, T. Berisha, N. Kaba, M. Piperku, Xh. Gashi, N. Krasniqi etj.) kanë marrë pjesë në festivale të tjera të muzikës së lehtë në Serbi (Beograd), Kroaci (Opai), Magedoni (Shkup), Slloveni (Rogoska slatina, Radenci). Më pas, sidomos këto kohët e fundit, kanë vazhduar të veprjnë edhe grupe vokalo-instrumentale me këngë baladeske e protestuese, si dhe kanë qenë në rritje me xhez-, pop- e rap-muzikën dhe me rymat e tjera të kohës. Më 1968 u themelua *Ansambl i këngëve e i valleve të Kosovës "Shota"*, të cilën e kanë drejtuar muzikantë e koreografë nga Kosova, Shqipëria, Magedonia. Ky ka marrë pjesë në manifestime republikane, federative e ndërkombëtare (Lojërat verore të Dubrovnikut, Festivali veror i Lubjanës, Vera e Ohrit, në Turqi, SHBA, Tunis). Më 1969 fillon së vepruari *Ansambl i vokal "Collegium cantorum"*, nismëtar dhe drejtues i të cilit ishte deri në vdekjen e hershme M. Kaçinari. Ndër pjesëmarrjet e këtij ansambli në manifestime në Jugosllavi (Solemnitetet korale në Nish, Diët e Mokranjcit në Negotin, Diët e kulturës në Zagreb) dhe jashtë (Shqipëri, Turqi...) veçohet suksesi në Langolen të Anglisë, më 1972, ku është lauruar me shpërbtimin e dytë.

⁴ Më gjerësisht mbi këtë kompozitor shih Zeqija Ballata, Krijues që la gjurmë të thella në muzikën tonë, Rilindja, shkurt 1982; Krijues që me opusin muzikor ia ngjiti vetes përmendoren, Rilindja, prill 1982; Fryma revolucionare në krijimtarinë e Rexho Mulliqit, Bota e re, maj 1982; Rexho Mulliqi si nxënës e student, Bota e re, mars 1983, si dhe sublimimi i këtyre punimeve në një të përbashkët në Gjurmëve të muzës, OPGBG "Rilindja", 1987, fq. 190-208.

⁵ Radiotelevizioni Prishtina (1969), Universiteti i Prishtinës (1970), Instituti Albanologjik, Shogata për shkencë e art (1974), e ngjitur më pas në Akademi të Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Akademia e arteve figurative (1973).

Gjatë viteve '70 e pjesërisht '80, sado me pengesa të regjimit, arrihen rezultate të mëtejshme relevante në arsimin dhe në gjinitë e mëdha krijuese muzikore. Hapen në Gjakovë (1970), Pejë (1978) e Gjiçan (1982) shkollat e ulëta të muzikës dhe arrihet që në lëmin e arsimit superior muzikor, pas përgatitjes së Elabrorit⁶ dhe emërimit të Komisionit amë prej pedagogëve eminentë muzikorë të vendit⁷, të themelohet *Fakulteti i arteve* më 1975, dega e artit figurativ e të cilit pat filluar të veprojë dy vjet më parë. Fillimisht në Degën e muzikës të këtij Fakulteti vepronin drejtimi pedagogjik, i solokëndimit, i pianos, pjesërisht i harqeve e i frymoreve, ndërkohë që in bashkangjiten drejtime të reja në vjet '80, siç genë drejtimi i kompozimit dhe i dirigjimit⁸, ndërsa në fund të atij dhjetëvjetëshi edhe drejtimi për aktim e regji. Pranë Fakultetit të Arteve kanë vepruar *Kori e Orkestra kamertale me solistë* arsimtarë e studentë, të cilët kanë marrë pjesë në koncerte / festivale dhe në Takimet e akademive muzikore të vendit. Nga ky fakultet, ku kanë studiuar dhe më pas janë zgjedhur asistentë e pedagogë ose inkuadruar në shkolla të muzikës a në Radiotelevizionin Prishtina, është *Mendi Mengjiqi* (1958), i cili pas dy vite studimi në Drejtimin për kompozim ka vazhduar e kryer studimet në Krakovë të Polonisë (Bujarski, Penderecki) gjatë viteve '90 dhe vepruar suksesshëm, për t'u kthyer më 2001 në Kosovë e pranuar pedagog pranë këtij Fakulteti. Ka këngë solo e korale (Dam-rana-dam, Gjëma), solistiko-kamertale (Sonata interrota, Folk-sonata, Valle), vokalo-instrumentale (Homagium Matri Teresiae) e orkestrale (Tillagunad Gannel o Tage Svensson, Pashko Berisha, Donum musicum). Nga ky fakultet ka dalë edhe kompozitori *Valton Begiri* (1966), i cili ka këngë solo (Lantunirë) e korale (Poema e heshjes), pjesë për piano (Varacione) dhe solistiko-kamertale (Pjesë Kuartet). I këtij brezi është edhe *Ilir Bajri* (1969), i diplomuar në drejtimin pedagogjik të Fakultetit të Artit në Prishtinë i cili është i orientuar suksesshëm nga xhez-muzika, nga

⁶ Elabrorin për themelimin e Akademisë muzikore në Prishtinë e kanë bërë historiani muzikor Engjell Berisha dhe kompozitori Zeqirja Ballata.

⁷ Anëtarët e Komisionit amë ishin Bruno Brun (1910-1978), klarinetist e pedagog i Akademisë muzikore-Beograd; akademik Rudolf Bruci (1917), kompozitor e pedagog i Akademisë muzikore-Novj Sad; Stanko Horvat (1930), kompozitor e pedagog i Akademisë muzikore – Zagreb; dr. Toma Prosev (1931-1997), kompozitor e pedagog i pedagog i Akademisë muzikore – Shkup; dr. Gazmend Zajmi (1936-1995), jurist, politolog, pedagog, prorektor i atëherëshëm Universitetit, në cilësi të anëtarëve konsultativë ishin kompozitorët Vinçenc Gjini e Zeqirja Ballata dhe historiani muzikor Engjell Berisha.

⁸ Klasën e kompozimit e ka udhëhequr (në vjet 1982-91) autori i këtij punimi, ndërsa atë të dirigjimit Bahri Qela, i diplomuar në Beograd e i specializuar në (ish) Bashkimin Sovjetik.

muzika për teatër e film, duke aplikuar në kompozime edhe kompjuterit përkatësisht elementet elektroakustike (Vijëzimi, Pertej, I-urn-U). Deri në vjet '80, pra, përmes gjashtë shkollave të ulëta e dy të mesmet e muzikës, si dhe të Degës së muzikës së Fakultetit të arteve u kontribua në përtatitjer suksesive të *kuadro muzikor në shkollimin dhe u specializua në tej si dhe u inkuadrua në jetën muzikore*⁹.

Në fillim të viteve '70 ka filluar së vepruari *Kori i burrave të Gjakovës*, me nisjaivën dhe në udhëheqjen të kompozitorit, akademik *Raj Dhomi* (1945), i diplomuar e i magjistruar për kompozim në Sarajevë (M. Shpil'er), pedagog i Fakultetit të Arteve, autor i përpunimeve (*U çu Rushtja*, *Ç'është ajo që zbrer nga mali*, *Ro-ko-ko*, *Nga mali i dashurisë*), këngëve solo (*Pa lantunirë...*), korale (*Poradeci*, *Mesha*, *Allëlluja*), veprave solistiko-kamertale (*Sonata*, *Kujtime*, *Rondo*, *Elegjia*, *Pranvera*, *Kuartet*), vokalo-instrumentale (*Vatra e diutisë*, *Uratë vajzave*), orkestrale (*Uvertura*, *Skervo*, *Epopeja*) dhe i atyre muziko-skenike (opera *Goca e Kaçanikut*, *Dasma arbërshes*, baleti *E bukura More*), si dhe i muzikës për teatër, film e TV. Me këtë Kor ka marrë pjesë në koncerte e manifestime në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Turqi, Mal të Zi e gjetiu (shem.).

Me sukses ka vepruar, gjatë viteve '70 e '80 *Sektori etnomuzikologjik* i Institutit Albanologjik të Prishtinës, i drejtuar nga etnomuzikologët dr. Rexhep Munishi e Bahri Sheholli.¹⁰ Gjatë atyre dekadave ky Sektor ka organizuar simpoziume dhe ekspedita kërkimore-shkencore në Kosovë, Maqedoni Perëndimore, Mal të Zi, Kosovë Lindore e Shqipëri, duke mbledhur e mbarështuar thesarin tonë folklorik: këngë, melodi instrumentale, valle, vegla muzikore. Ka botuar studime të ndryshme etnomuzikologjike dhe ka bashkëpunuar me institucione simotra në vend, Shqipëri e gjetkë.

Në fillim të veprimtarisë së Universitetit të Prishtinës (1970) është themeluar SHKA akademike "R. Sadiku", e cila ka marrë pjesë me këngë e valle në manifestime republikane, federative e ndërkombëtare. E kanë udhëhequr muzikantë e koreografë, sidomos kompozitori i diplomuar në akademinë e muzikës në Beograd (E. Josif) Fahri Begiri (1936), pedagogu i Fa-

⁹ Mbi arsimin muzikor të Kosovës, shih Zeqirja Ballata, *Gjurmëve të muzës...*, fq. 215-219, 225-232, 239-244.

¹⁰ Bahri Sheholli (1941) i diplomuar në drejtimin pedagogjik dhe në atë etnomuzikologjik të Fakultetit të muzikës në Beograd, i specializuar në (ish) Bashkimin sovjetik; Rexhep Munishi (1945) i diplomuar në drejtimin pedagogjik të Fakultetit të Muzikës në Beograd, më pas ka studiuar edhe etnomuzikologjinë, i specializuar e i doktoruar në Paris; që të dy, duke vepruar në Sektorin etnomuzikologjik, kanë mbledhur, mbarështuar dhe botuar shumë studime e libra nga fushëveprimtaria e tyre.

kulleit të Arteve (në pension) dhe autor i këngëve solo (Mbërënja në Metohi), për fëmijë (Kënga e rinisë, Këngë për M. Bekteshin), të përpunuara e origjinale koralë (Moj e mira, Madrigali i Ibrit plak, Shkoj e vij, Erth mësiu, Kendej kaloi armiku), i veprave pianistike (Alla turca) e solistikokamertale (sonata, Piesë, Kuinlet), orkestrale (Poema Skenderbeut), si dhe udhëheqës ansamblesh (shem.). I brezit të këtij është **Esat Rizvanolli** (1936), i diplomuar për kompozim në Akademinë e muzikës në Beograd (J. Enriko) dhe i specializuar në Bashkimin Sovjetik, redaktor muzikor në Radio-Prishtinë, në decenien e fundit pedagog në Fakultetin e Arteve, autor i këngëve për fëmijë (Retë, Një ditë, Si u rrit Hekurani), solo (Peshkatari, Kënga pranverore, Abdyll shite pasurinë, Nëna Terezë bijë shqiptare) e koralë (Xehëtarëve, N' mjedis të ballit, Këngë për vrasjen e M. Pashës, Shitjet tona...), veprave për piano (Suita dasmore, Adagio e scherzo, Prelud...), kamertale (Kuarteti harkor), vokalo-instrumentale (Fjala e Skenderbeut, Rezistenca '43) e koncertante-simfonike (Musica sinfonica, Koncerti për piano e orkestër (shem.).

Pas një ndërprerjeje të gjatë, më 1975, riformohet Orkestra simfonike e RTV-Prishtina me nisjaivën e pedagogut dhe dirigjentit tonë të njohur *Bahri Qela*, kur tashmë i ishte bashkangjitur Radios dhe Televizioni Prishtina. Kjo orkester ka incizuar për prodhuesionin muzikor dhe ka koncertuar çdo vit në Ditën e Radiotelevizionit Prishtina, në Shqipëri, në Tribunalin muzikor të Opatisë, në Lojërat verore të Dubrovnikut. Atë e kanë drejtuar, përveç B. Qelës, edhe *Bajar Berisha*,¹¹ si dhe mysafirë nga Shqipëria, Serbia, Maqedonia, Sllovenia. Ka ekzekutuar vepra të krijuesve Shqiptarë e të huaj, si dhe ka incizuar disqe.

Pas aktivitetit disavjeçar (1969-72), Seksioni i kompozitorëve, me nis-mën e disa prej nesh kompozitorëve, ngritet, më 1972, në *Shogatë të kompozitorëve të Kosovës*. Deri në vitet '80 janë përfshirë në të afro 40 kompozitorë të muzikës serioze e të lehtë, si dhe shkrimtarë muzikorë a (etno) muzikologë. Shogata ka bashkëpunuar me të fjerat simotra në shkallë republikane dhe me Sektorin e muzikës të LSHA të Shogatës, ndërsa anëtarët e saj kanë qenë në juritë, këshillat e manifestimet, si Ditët e muzikës kosovare në Gjakovë, Ditët e muzikës të Serbisë, Tribunalin muzikore në Opat, festivalet koral "Nasha pesem" në Maribor të Sllovenisë, ditët e muzikës në Herceg Novi në Mal të Zi, Garat e koreve të pionierëve në Shabac, Solem-

nitetet koralë në Nish. Ka organizuar mbërënjet e kompozitorëve të republikave e të Vojvodinës në Kosovë e anasjelltas.

Shogata e pedagogëve muzikorë e Kosovës, e themeluar që më parë, i ka orientuar kuadrot muzikore dhe ka kontribuar në themelimin e seksioneve në shkollat e muzikës, në zgjedhjen e nxënësve dhe të studentëve për gara, si dhe në bashkorganizimin e garave federative të nxënësve / studentëve të muzikës.

Numri i anëtarëve i *Shogatës së artistëve muzikorë*, të ngritur më 1973, me nisjaivën e disa prej nesh kompozitorëve, në krye me Akil Kocin, është rritur dukshëm në vitet '80. Kjo ka organizuar recitale / koncerte të anëtarëve në Kosovë e republika të tjera dhe në Vojvodinë, Shqipëri, Gjermani. Anëtarët e Shogatës kanë marrë pjesë në *Garat e artistëve të rinj muzikorë* në Zagreb dhe në Ditët e kulturës kosovare atje, në festivalet e Opatisë, të Herceg Novit, Ohrit, Beogradit, Novi Sadit... Po më 1973 formohet *Ansambli i baletit*, pas shkollimit të diçka më pak se 20 vajzave / çjëmëve në Shkollën e mesme të baletit në Shkup, të cilët kthehen për të vepruar në Teatrin e Prishtinës. Ansambli e kanë udhëhequr koreografitë nga Kosova, Shqipëria dhe Jugosllavia. Ka marrë pjesë në festivalet verior të Lubjanës e në Shqipëri, si dhe ka realizuar kollazhe e shtafje baleti edhe të autorëve Shqiptarë (R. Muliqi, T. Daija, G. Zajmi, R. Dhomi, B. Shehu e Akil Koci).

Çdo vit është zhvilluar *Revista e koreve të pionierëve të Kosovës*. Kori me të mira kanë marrë pjesë në Garat e koreve në Beograd, Celje, Shabac e viset të tjera, ndërsa në cilësi të anëtarit të jurisë edhe kompozitorët e dirigjentët tanë. Çdo vit janë zhvilluar edhe *Garat e nxënësve të muzikës*. Në këto manifestime pjesëmarrësit më të mirë kanë fituar shpërblyme. *Rinia muzikore e Kosovës*, përmes aktivitetesh në gjysmën e parë të viteve '70 ka bërë jehonë me koncerte të komentuar e ligjërata, si dhe me pjesëmarrje të mysafirëve solistë e ansambleve nga vendet tjera.

Rol të rëndësishëm në pasurinën e jetës muzikore ka pasur festivali federativ e pjesërisht ndërkombëtar *Skena muzikore e Prishtinës*, e ngritur më 1973, me nisjaivën e kompozitorit A. Koci. Në këtë festival janë rradhitur gjatë viteve 1973-91 me dhjetëra solistë, ansamble vokale, të muzikës së dhomës, vokalo-instrumentale e orkestrale nga republikat e tjera, Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik.

Rritës së krijimtarisë i ka kontribuar posaçërisht festivali kombëtar *Ditët e muzikës kosovare* në Gjakovë, i sendërtuar ngulmësisht¹² më 1979.

¹¹ Bajar Berisha (1950) ka diplomuar dirigjimin në Beograd, studimet pasdiplomike në Sarajevë, është specializuar në Gjermani; ka drejtuar kori e Shkollës së mesme të muzikës, të Fakultetit të arteve dhe orkestrën e Radiotelevizionit Prishtina.

¹² Nga autori i këtij punimi, kryetar i atëhershëm i Shogatës së kompozitorëve.

Në të, deri më 1991, janë realizuar disa qindra vepra tona të muzikës për pionierë e të rritur korale, të lehtë, solistike, të dhomës, vokalo-instrumentale, orkestrale e muzikoro-skenike, të realizuara nga artistë kosovarë dhe republikash tjera. Ndërsa, në Tribunalat muzikologjike janë shoshtur *gëshije nga më qenësoret të krijimtarisë sonë muzikore.*

Më 1980 (ri)themelohet *Kori profesionale* pranë Radiotelevizionit Prishtina, që e kanë drejtuar (veç B. Berishës e D. Xërxës), me sukses kompozitorët *Rafet Rudi* (1949), i diplomuar për dirigjim (1973) e kompozim (1974) në Beograd (P. Millosheviq), i specializuar në Paris (C. Ballif) e i magjistruar në Sarajevë (V. Komadina), autor i këngëve korale për pionierë (Një tokë, një kokë, Pasporta e daci, Harabeli, Dhelpra dhe gjeli, Kur buzëqesh nëna, Këngë punëtore) e të rritur (Ishin dy kunata, Varri i pionierit, Këngë për G. Terbeshin), i muzikës solistike-kamertale (Meditime, Suite, Dy miniatura, Rondo, Sonata, Kuarteti harkor, Fantasia in Si, Dialogues perdu), orkestrale-koncertale (Dy blloqe simfonike, Rrojtja për kitarë e harqe, Metamorfoza për kitarë e orkester, vokalo-instrumentale (Zogu i diellit, Icare ubi es, Afresk arbëresh, Filjimi) dhe për teatër si dhe i punimeve të librit (shem.). Këtë kor e ka udhëhequr dhe *Baki Jashari* (1956), i diplomuar për kompozim në Lubjanë (D. Shkerl), i cili ka vepruar në vitet 1990-2000 në Slloveni si pedagog, kompozitor e dirigjent, ndërsa nga viti 2000 shërish në Kosovë, autor i këngëve solo (shem.) e korale (Një lule, Pakëz në ëndërr), solistiko-kamertale (Miniatura, Trio) e orkestrale (Pascaglia, Sinfonietta). Kori i RTV – Prishtina, në drejtimin e këtyre krijuesve, ka marrë pjesë me sukses në koncerte / festivale (Vera e Ohrit, Lojërat verore të Dubrovnikut, Ditët e muzikës kosovare, Tribuna muzikore e Opatisë...), si dhe ka incizuar vepra autorësh shqiptarë e të huaj (shem.).

Pasurimit të jetës muzikore i kanë kontribuar dhe e çdovjetshnja *Revistë e folklorit burimor* – Gillogoc/Drenas (1961), *Kosovarja këndon* – Ferizaj, *Talentët e rinj muzikorë* – Mitrovicë (e qendra të Kosovës), *Festivali i këngës qytetare* – Prizren, *Festivali i këngës për pionierë, popullorë e zbatues* – Gjakovë. Festivalet e asociacionet muzikore me institucionet arsimore-muzikore i kontribuan kështu jo vetëm të pasurimit të gjithë-mbarshëm të jetës, por dhe të krijimtarisë muzikore deri të gjinitë madhore në fillim të viteve '80, siç janë simfonia (R. Muliqi, V. Gjini, Z. Ballata, R. Rudi, Gj. Gjevelekaj), opera (R. Dhomi) e baletit (A. Koci, R. Dhomi, G. Zajmi, B. Shehu).

Ngecjet...

Mirëpo qysh gjatë viteve '80 filluan të zbatohen pengesa nga më pefidet ndaj zhvillimit shoqëro-ekonomik e kulturor të shqiptarëve për të intensifikuar ashpër deri në skajshmëri më 1989, kur u suprimuan arbitrist Kushtetuta e Kosovës (e vitit 1974) dhe e organeve të saj; bashkë me edhe e gjithë autonomia edhe ashtu e brishtë e Kosovës. Me vandalizmin në të egër ushtarako-polikor, më 1990 e më pas, u okupuan të gjitha punktet shoqëro-arsimore e shkencore. U dëbuan mbi 120.000 punonjës shqiptar nga vendet e punës; u hoq nga sistemi arsimit shqip i të gjitha niveleve bashkë me mbi 21.000 pedagogë shkencorë, krijues të letërsisë e të arteve; lanë në mëshirën e pasigurisë materiale, të rrojtjes në zgrip dhe pa të ardhur e sigurim social / pensional, ashtu sikur edhe e gjithë popullata dymit nëshë shqiptare; si të thuash u ekskomunikua i tërë një popull nga regjimi ekspansionist serbomadh¹³. Arritjet në krijimtarinë dhe kulturën muzikore përgjithësisht, të realizuara me aq mund, sakrificë të mëdha e përgjegjësi profesionale, që u ndërprejnë si me thikë, patën për pasojë shkallimin rritdhunë të punkteve kulturo-artistike, dëbimin ma-sovik nga vendet e punës edhe të veprimtarëve kulturo-shkencorë e arsimorë shqiptarë, të cilët u lanë në mëshirën e kotës e të ngulftatur tmerrësisht nga mungesat më themeloni mbi të drejtat e njeriut¹⁴. U shua, kështu, plotësisht edhe jeta e mirëfillti artistike, pra edhe e gjithë veprimtaria e dikurshme e Orkestrës simfonike RTV-Prishtina dhe e Kori profesionale; e Diteve të muzikës kosovare dhe Skenës muzikore të Prishtinës; e Akordeve të Kosovës dhe e Revistës folklorit burimor të Gillogocit; e Ansambllit të baletit të Teatrit popullor dhe e Garave të nxënësve / studentëve; e Rivistës së koreve të pionierëve të Kosovës dhe e një varg manifestimesh të tjera arsimor-muzikore e artistike. Në vend të këtyre aktiviteteve të përhershme tradicionale, që e mbanin gjall dhe i jepnin ushqim zhvillimit të arsimit muzikor, jetës, krijimtarisë dhe kulturës përgjithësisht muzikore, patën zënë të lulëzojnë dajrexhinj komercial katenezhë të dyshimita, të cilët, bashkë me padronët e tyre, po përfitonin ngmasa e mollisur që po privoheshin nga ndjenja për të bukurën e artit të mu

¹³ Shih Zegjirja Ballata, Restriksione të mëdha në komunikimin në shkallë gjithëkombëtare Rilindja, Prishtinë, prill 1990; dhe, Vite të ndrydhjeve në jetën dhe kulturën muzikore Victoria, Prishtinë, 1991.

¹⁴ Shih Album ëovekovih pravci/Svet Evrope, Ministarstvo za šolstvo in šport, Ljubljana 1993, ku ndër të tjera, në Protokolin nr. 1, nen 2 nga Të drejtat e njeriut, thuhet: 'S'guxon të mirret e drejtja për arsimin...', pavarësisht se kush jemi, cili komb a shtrës shoqërore i takojmë...

zave¹⁵. Patem ngecur, kështu, gjatë viteve '90, në të gjithë lëmenjtë e jetës shqetëro-ekonomike arsimoro-kulturore, pra edhe të kësaj muzikore për disa decenie mbropa dhe me pasoja të paparashikuara. Njëheri, gjatë asaj dekade përplot rrëtime, vrasje e debime, krahas qindranjësra shqiptarëve, edhe shumë intelektualë e profesionistë tanë, d.m.th. edhe nga rradhitë e muziketarëve, u detyruan, për shumë arsye, kush më parë e kush më pas, të mërgojnë në vende të ndryshme. Sado që në ndërkohë mjaft prej tyre u kthyen, megjithatë, ende shumë gjinden në Kroaci, Slloeni, vende evropiane, skandinave e tejoceanike. Ndër ta janë profesionistët këngëtarë Besa Berberi-soprane, Hanefi Simnica-bas, Agim Kasumaj-tenor, Lajda e Bernardina Mjeda-soprane, Xhemal Rexhepi-bariton, Xhela Bakraçi-tenor; instrumentistët Ehat Musa-kitarë (i shkruar shumë më parë), Teuta Pllanpianiste, Efrim Gashi-kontrabas e Naim Gashi-obo, Rina Kaçionari-violonçel, Arsim Leka-saksofon, Xhevdet Sahatçiu-kitarë, Shkelzen Doli-violinë, Anyta, Bajratar-violë; Gjemeni Berisha-vallëtar/koreograf; Arbër Dhomi e Ramadan Ramadani-dirigjentë, si dhe një varg kompozitorësh. Ndër këta është në Kroaci *Vingenc Gjini* (1935), i diplomuar e i magjistruar në Drejtimin pedagogjik në Beograd (L. Mariq), në atë të kompozimit në Shkup (T. Zografski), pedagog me përvojë të gjatë, sidomos të lëndës Harmonia dhe autor i librit po me këtë titull, sikundër dhe autor i këngëve për fëmijë (Blegëron delja, Pranvera, Një ditë, Rosa e pata), solo (cikli Letrat) e korale (O fyell këndo, thirrje për lojë), i veprave solistiko-kamertale (Loja kosovare, Variacione, Sonata), vokalo-instrumentale (kantata Zef Lush Marku, Kështu fillon kënga) e i atyre orkes-trale (Tregimet e nënës time, Preludium e fugë, Quasi sarabanda, tri simfoni, simfonieta, Një kujtim - shem. Po në Kroaci vepron *Bashkim Shehu* (1952), i diplomuar e i magjistruar në Sarajevë (M. Shpilert, J. Magadiq), si dhe i specializuar në Francë, autor i këngëve solo (Ngadhynjimi i madh), korale (Të lindet nderi, elegji për r. Mulliqin), veprave solistiko-kamertale (Sonata ed variazioni, Kuiniet frymor, Aproksinato, Arsa flat 1, 2, Sigma 1-3, Refleksionet 1,2), orkestrale (Concerto drammatico), muzikore-skenike (baleti Besa) dhe i muzikës filmike (Lepuri me pesë këmbë) shem. Në Angli është *Akili Koci* (1936), i diplomuar në drejtimin pedagogjik, i magjistruar në atë muzikologjik në Sarajevë (Z. Kucukaliq), një kohë i studiuar për kompozim në Shkup (T. Proshv) e në Shkup (M. Kelemen), punonjës në RTV-Prishtinë, në fund pedagog në Fakultetin e Arteve (në pension), autor këngësh solo (Unë biri yt, Elegji, Rekvjem, Nostalgiia, Nimfa, Trimja gjakovare) e korale (Ty që je liria jonë, Pa titull, Mes njerëzve, Kallërsirat, Kulla), pjesësh solistiko-kamertale

¹⁵ Shih, punimet e sublimuara mbi atë gjendje të dr. Rexhep Muminshi, Identiteti muzikor, Shitëpsht Kronja GME, Prishtinë, veçanërisht fq. 21-66.

(Miniatura, Arabeskat, Refleksionet, Klarineta fenomenale, Burleska, Invenzione, In memoriam B. Sakaq, trio kuartete, Kuiniete, cikli Filigranet, Flebile, Metamorphose I), orkestrale (Siluetat, Ab aeterno, Sirigomofonia, Marginale II, Koncert për vitë e ork), muzikore-skenike (baleti Sokoli e Minshja...), si dhe për teatër e TV (shem). Në SHBA gjindet *Bahri Mulliqi* (1959, me të shogën pianiste), i diplomuar në Drejtimin e kompozimit pranë Fakultetit të arteve në Prishtinë (Z. Ballata), autor i këngëve solo (Fishekzate mifësie) e korale (Humoreska, Insonia, O bylbyl i mjerrë, Motiv për dëshmorin, Gushë sharavell), veprave solistiko-kamertale (Nxihtë, Variacione, Trio, Kuartet), multimediale (Epi-raf, për oket vokale, shirit magneto-fonik e balerinë) e orkestrale (Dipitk sim-fonik) - shem. Që të gjithë këta kompozitorë dhe ndonjë tjetër, genë pedagogë të Fakultetit të Arteve në Prishtinë. Ndërkëq, në Francë vepron *Gjon Gjevelekaj* (1951), i diplomuar në Akademinë e muzikës në Sarajevë (J. Ma-gdiq), i magjistruar në Akademinë e Shkupit (T. Proshv) dhe i specializuar në Paris (J. Petit-Giard), ish-redaktor në produktivionin muzikor të RTV-Prishtina, autor i këngëve korale (Flamujt e paqës), solo (Luja e truallit tonë), solistiko-kamertale (Scherzo Albanese, Pays natal, Refleksions, kuarteti Besa, Imagjinata 11), orkestrale (Impresione, Imagjinata 12, Symphonie Albanaise, Koncert për p-no e ork.), muzikore-skenike e i muzikës filmike (Rojet e mjegullës) - shem.

Rigjenerimi dhe synimet

Pas Deklaratës së 2 korrikut '90, Kushtetutës së Kaçanikut të shqarorit '91 dhe Referendumit për Kosovën e pavarur dhe neutrale të vitit '92, është dashur të rrahin disa damarë të trupit tonë të molisur, d.m.th. të vazhdojë mëtej qëllimi i shpirtit kurrë të dorëzuar shqiptar. Zuri, kështu, ngadalë, por ngulmësisht të veprojë sërish, sado me sakrificë të mëdha, sidomos, sistemi arsimor shqip, pra edhe ky muzikor, dhe t'i përballojë rrebesht trynuese të regjimit glenocidal millosheviçian. Këtyre shpirtshijeve fizike e shpirtërore të genjes sonë kombëtare të të artit urave arsimoro-kulturore e shkencore, zu, pra, t'i ndryshohet krahja për të mirë. Mjaft bashkardhetarë filluan të kthehen në vatrën e tyre, sado që ende disa qindranjës veprojnë jashtë, edhe nga radhët e muziktarëve. Zunë të rigjenerohen jeta bashkë me energjitë tona krijuese, të rimëkëmben veprimtaria kulturo-shkencore dhe kulturo-artis-tike, pra edhe jeta e krijimtaria muzikore përgjithësisht, krahas synimeve tona historike mbi lirinë, demokracinë e pavarësinë të parapara me Deklaratën... Kushtetutën... e Referendumin... Këtë rigjenerimi i patën paraprirë një mori përpjekjesh, aksionesh, aktivitetesh nga më të llojllojshmet të rinisë stu-

dentore e masave të gjera të pedagogëve e intelektualëve të të gjitha profileve, pra edhe faktorë revitalizeues qysh gjatë viteve '80, por sidomos në fillim të viteve tmerishme '90 e mëtej, përveç tjerash edhe përmes vazhdimit me ngulm të asinimit në të gjitha shkallët nëpër lokale improvizuese mësimore, demonstrimeve e protestave studentore, si dhe të pedagogëve intelektualëve në Kosovë e diasporë. U imponua lufta gati dyvjeçare e udhëhequr nga UÇK, e përkratur nga organizmat mbrojtës të të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e të NATO-s për mposhtjen e forcave ekspansioniste ushtarako-police e paramilitare serbe, të cilat u shtrënguan të largohen nga Kosova me të hyrë të paqeruajtësve ndërkombëtarë në qershor 1999.

Pas asaj dekadë, Kosova hyri e shkatërruar gati të thuash tërësisht dhe me institucione arsimore-shkencore e kulturo-artistike krejtësisht të tjetërsuara e me veprimtarë e udhëheqës fare të shkapërdërdur. Është dashur, prandaj, që ato institucione / asociacione, bashkë me faktorin e ndërgjegjshëm veprimtar e krijues kombëtar sërish ta rimarin veten, të ripërtëriten e të ngrihen edhe të reja. Rezultat i këtyre iniciave në këto dy vitet e fundit, vëganërisht këtë vit, pas zgjedhjeve të përgjithshme kombëtare, është organizimi i një vargu manifestimesh kulturore-artistike, pra edhe kësosh muzikore jo vetëm të muzikës së lehtë e me karakter rinor, siç janë Shou-fest, Polyfest etj., por edhe kësaj të mirëfilltë artistike-serioze.

Rezultate të këtij regjenerimi janë:

- (Ri)fillimi i punës së Orkestrës dhe mbajtja me sukses e koncerteve, sado me instrumentistë të pak të vendorë e të huazuar, si dhe me solistë e dirigjentë vendorë e të huaj, orkestrë kjo e ngritur në *Filarmoni të Kosovës* që do të plotësohet suksesivisht me të gjithë instrumentistët e nevojshëm me qëllim të realizimit të koncerteve të rregullta dhe përmbytjes së nevojave të produktionit muzikor, pra edhe realizimit e incizimit të veprave tona koncertale e simfonike (që presin në sirtarë, sado që janë ekzekutuar në Kosovë e jashtë), si dhe përfaqësimit si i ka hije një kryeqendrije siç është Prishtina dhe një vendi me synim shtet siç gjakon Kosova; pastaj

- Themelimi i *Festivalit ndërkombëtar të muzikës kamertale* që tashmë dy vite e organizon Shogata e artistëve muzikorë të Kosovës, e cila do të parashikojë nga instrumentistë vendorë e mysafirë përfshirjen obligative të veprave të autorëve kosovarë, përkatësisht shqiptarë, praktikë kjo që e kemi sendërtuar në vitet '70 e '80 e që praktikohet gjithandej ndër festivale ndërkombëtare; gjithashtu.

- Formimi dhe paraqitjet e suksesshme në koncerte / festivale këto dy vitet e fundit e ansambli kamertal *Vivendi*, i cili do vazhduar më tej nismën e mbarë pa ndërprerje dhe në manifestime vendore e ndërkombëtare, duke pasur rregullisht në repertor vepra autorësh tanë (që janë luajtur me sukses nga ansamble në festivale të ndryshme) dhe të incizojë vepra të keyre autorëve, gjë të cilën e konsiderojnë ansamblet e njohura për obligim moral e mburje kombëtare; po kështu

- Fillimi (sivjet) i veprimit të festivalit *Skena e re muzikore e Prishtinës*, që është pjesërisht përtëritje e ish-Skenës muzikore të Prishtinës, por njëkohësisht edhe festival i ri me fizionomi e orientim bashkëkohor ndërkombëtar, i cili do të kontribuojë që krijimtaria bashkëkohore e përbotshme dhe kjo jona kombëtare, përmes instrumentistëve / ansambleve vendore e të huaja të jenë më të pranishme, dm.th. edhe t'i afrohen më shumë dëgjuetit tonë, në ç'mënyrë ky të njihet më për së afërmi e të jetë më në korrent me krijimtarinë bashkëkohore kosovare përkatësisht shqiptare dhe të përboishme; edhe

- Ripërtëritja e *Revistës së folklorit burimor* në Drenas, bën pjesë në këtë vazhde, e cila u realizua këtë verë me plot sukses nga organizuesit në krye me etnomuzikologun tonë Bahir Sheholli, duke u rradhitur tani ndër festivale tona të karakterit gjithëkombëtar. Këta dhe shembuj tjerë të (ri)gjenerimit të jetës e të kulturës muzikore pohojnë qartë për hapërtim të mbra revitalizeuese drejt ripërtëritjes së manifestimeve të dikurshme, të cilat gjelluan suksesshëm deçenjë me tradhtë, por edhe drejt themelimit të atyre të reja që do t'i japin krah zhvillimit të mëtejshëm kulturës muzikore kombëtare dhe asaj të përgjithshme në rrethana të reja demokratike. Kështu do të vazhdohet më tej, në mënyrë që, në një të ardhme të afërt, të kompenzohet për atë sa është e mundur, ngecjet katastrofike të viteve '90 përmes ripërtëritjes së manifestimeve muzikore që u heshtën pa të drejtë gjatë dekadës së kaluar, siç janë Ditet e muzikës kosovare, Akordet e Kosovës, Garat e nxënësve / studentëve të muzikës, Revista e koreve të pionierëve të Kosovës; përmes ripërtëritjes së asociacioneve, siç janë Shogata e kompozitorëve të Kosovës, Shogata e pedagogëve muzikorë të Kosovës; përmes ripërtëritjes së ansambleve interpretese, siç janë Kori profesional, Kori i pionierëve, Orkestra revyale-zbavitëse e Orkestra popullore që vepruan dikur me një traditë të mirë e të suksesshme pranë RTV-Prishtina. Do të vazhdohet edhe me themelimin e atyre institucioneve e ansambleve madhore interpretese muzikore të karakterit gjithëkombëtar përkatësisht shtetëror, siç është *Tanri i Operës e i Balletit* me Orkestrë, Ballet, Kor e solistë (vokale), bashkë me godinë përkatëse i cili është projektuar qysh në vitet '70 me *Projekti-*

EKONOMIA E KOSOVËS – DJE, SOT DHE NESËR

Dje – periudha deri në vitin 1999

Kosova është një rajon me rëndësi ekonomike dhe strategjike, me një sipërfaqe prej afro 11.000 km². Posedon potenciale të dukshme të resurseve natyrore dhe alyre njerëzore. Numri i popullsisë aktualisht arrijn në mbi 2,5 milionë (prognozë), kurse pjesëmarrja e shqiptarëve në këtë madhësi është rreth 90%.

Resurset natyrore të Kosovës janë të njohura që nga kohët e lashta dhe ato eksploatoheshin nga ilirët, si popull vendor, pastaj nga pushuesit siq ishin romakët, bizantinët, slllovakët, sasët, turqit e së fundi përsëri nga sllavët. Shkenca e mitëfilltë ka verifikuar fakte se pikërisht pasuritë natyrore dhe pozita e volitshme gjeostrategjike, Kosovës i sollën shumë fatkeqësi. Mbështetja e politikës dhe propagandës serbe, në gjoja trashigiminë e monumenteve kulturore e historike (kisha e manastire), më tepër është mit dhe legjendë se faktografi e vërtetë. Nostalgjia për Kosovën dhe këmbëngulja për të pasur atë, për bazë ka në interesat ekonomike dhe strategjike. Serbia një pjesë të zhvillimit ekonomi të saj e gëzoi nga shfrytëzimi i resurseve natyrore, prandaj vëshitëre hijte dorë nga kjo pasuri.

Resurset natyrore të Kosovës janë të njohura edhe sot dhe në këtë aspekt ajo mund të krahasohet me viset e pasura në botë. Sipas kërkimeve gjeologjike, të cilat nuk kanë përfunduar, Kosova është e pasur me: mine-rale, tokë të punueshme dhe të plleshme, pyje që përfshijnë afro 40% të sipërfaqes së tërësishme, klimë të volitshme, lidhje njoyre dhe mjaft strategjike të komunikacionit etj., kurse problem është uji, sidomos ai mb-tokësor.

Nga resurset e tërësishme, në veganti dallohen rezervat e lujtit, plumbit, zingut, nikelit, magnezitit, boksitit, kromit, kaolinit, bentonitit, kuarcit, mermerit, gëlqerës etj.

*propozimin e detajizuar me arsyezim*¹⁶ dhe i parapare në Planin afatmesëm 1975-80, kurse i përtshirë për realizim në atë 1980-85, por jo të realizuar për arsye pengesash e neglijencash të ndryshme. Pikërisht sendërtimi i Teatrit të Operës dhe i Baletit është ndër gjakimet tona imediate të periudhës së ardhshme përkatesisht si domosdoshmëri jona e krahmoishme drejt zhvillimit dhe pasurimit të mëtejshëm të jetës muzikore-skenike ndër ne. Për ndihmesë përshpejtese do të shërbejnë kthyerja në Kosovë e këngëtarëve, instrumentistëve, dirigjentëve e krijuesve të tjerë vepimtarë muzikorë dhe përgatitja mëtej permanente e këtyre kuadrave, aftësimi i siguriimi i libretistëve, skenografëve, kostumografëve, njështriti të dekorit, të makiazhit, të parukave, të maskave, probaqepësit, ndriqesit, rekuizitrit e suflerit, si dhe veprimi i drejtimit të baletit pranë të gjitha shkollave tona të ulëta e të mesme muzikore, të cilat hëpërhë do të angazhojnë pedagogë-koreografë baleti nga jashtë, me qëllim të aftësimit të kuadrit të këtij profilit krejtësisht të mangët ndër ne.

Filarmonia (e Kosovës) që tashmë ka filluar të marrë shtat dhe Teatri i Operës i cili në një të ardhme të afërme do të marrë rrugë themelimi nga organi më i lartë përkates i Kosovës, janë gjithandej dhe do të jenë edhe më tej postulate imperative për një kryeqytet, siq është Prishtina dhe për një vend me synim shteti të pavarur, siq është Kosova. Po kështu, përmes vepërimitarisë së ansambleve të këtilla masive muzikore, veg pasurimit të përgjithshëm të jetës artistike-muzikore, do të mund t'i kontribuhet dukshëm edhe nxitjes e krijimit të veprave të reja dhe, kësodore, pra, edhe begatimit të literaturës e të fondit të përgjithshëm krijues të kulturës muzikore kombëtare.

¹⁶ Mbi nevojën e themelimit të Operës e baletit, shih Zeqirja Ballata, Ndihet gjithnjë mungesa e instrumentistëve, Rilindja, dhjetor 1975; Çdo krijues duhet të ketë kuiturë të gjerë, Fjala, tetor 1975; Folklori muzikor kosovar – begati e pashtershme shpirtërore e këtij populli – bisedë me (n)krijues, Fjala, mars 1976, Prishtinë; Gjurmëve të muzës, NGBG "Rilindja", Prishtinë, fq. 225-232; Arritjet e deritashme në muzikë, Fjala, prill 1981, Prishtinë; në intervistat: Kuadri ekzistues bazë e mirë e përspektivës, Rilindja, 1985; Të pasurohet krijimtaria muzikore, Rilindja, nëntor 1989; veganërisht punimi Të themelohet Teatri i Operës e Baletit..., Rilindja, shtator 1988.

Në Kosovë rezervat e linjtit vlerësohen në afro 12 miliardë tonë dhe shfrytëzimi i tyre bëhet në minijet sipërfaqësore, pra jo në thellësi të mëdha dhe me prodhim masovik e ekonomik. Linjiti i prodhuar përdoret:

- në termocentrale me kapacitet prej afro 1.400 mgv dhe me prodhim vjetor prej 5 deri 6 miliardë kilovat-orë;
- në ngrohjet industriale;
- në gasifikim;
- në tercoret e tyre.

Nga energjia elektrike e prodhuar afro 60% shfrytëzohet në Kosovë, kurse pjesa tjetër prej 40% u dërgohet viseve të tjera të Jugosllavisë dhe eksportohet. Për shkak të ndodhjes së ambientit, nuk duhet përqëndruar aq shumë në prodhimin e energjisë elektrike, aq më parë kur merret parasysh fakti se nga përpunimi i linjtit mund të fitohen mbi 40 produkte të ndryshme të karbokimise, nga të cilat një pjesë e madhe mund të eksportohet.

Me këtë rast duhet përmendur një element shumë të rëndësishëm në burimin e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë dhe në Shqipëri. Në Kosovë burimi kryesor i energjisë elektrike janë termoelektratat (95%), kurse në Shqipëri hidro-elektratat (85-90%). Kombinimi i këtyre dy burimeve është shumë i rëndësishëm për bashkëpunimin e ardhshëm ekonomik midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Përveç linjtit, Kosova disponon me rezerva të mëdha të plumbit dhe të zingut. Këto rezerva vlerësohen në mbi 45 milionë tonë xehë dhe me këto rezerva Kosova në ish-Jugosllavi merret pjesë me 50%.

Nga kapacitetet e instaluar të metalurgjisë së plumbit në vitin 1988 janë prodhuar 45.000 tonë koncentratë të plumbit, 97.000 tonë plumbë të papërpunuar dhe 83.000 tonë plumbë të rafinuar. Nga plumbi prodhohet një numër i madh i gjysmëprodukteve dhe të produkteve finale që munden edhe të eksportohen. Këtu, në radhë të parë, mendohet në akumulatore, bateri industriale dhe bashkëdyzimet e plumbit, siç janë: oksidi i plumbit, stabilizatorë për prodhime të PVC-së etj. Përveç kësaj, të rëndësishme janë edhe gjysmëproduktet nga plumbi, llatinina nga plumbi, tubat dhe produkte të tjera.

Kapacitetet e instaluar të metalurgjisë së zingut janë: 75.000 tonë zing elektrolitik në vit dhe nga zingu prodhohet një numër i madh produktesh të rëndësishme.

Nga shfrytëzimi i plumbit dhe i zingut prodhohen edhe disa produkte njiat të rëndësishme, sidomos për eksport, siç janë argjendi, ari, kadmiumi, bizmumi, antimoni etj.

Sasia më e madhe e këtyre mineraleve eksportohet, nga se Jugosllavisë i nevojitet për përmirësimin e bilancit tregtar dhe atij të pagesave, kurse një sasi edhe finalizohet nëpër fabrika jashtë Kosovës.

Nikeli po ashtu është një mineral shumë i kërkuar, sidomos në tregun botëror. Duke u bazuar në rezerva prej afro 20 milionë tonë, viteve '80 të shekullit të kaluar në Drenas (Glogovac) u ndërtua metalurgjia e feronikelit me një kapacitet teknologjik të prodhimit të nikelit të pastër prej 12.000 tonë në vit. Gjatë aktivizimit të saj prej vitit 1983 deri në masat e dhunshme në vitet '90 të ardhurat devizore vjetore nga eksporti i nikelit ishin prej 60-80 milionë dollarë. Në Kosovë nga nikeli prodhohen edhe Ni-Cd bateri në fabrikën e Gjilanit, që janë dëshmuar në tregun botëror.

Magneziu, me rezerva prej 10 milionë tonë, është një mineral shumë i rëndësishëm dhe prodhohet në Golesh, Strezovc dhe Dubovc. Me finalizimin e magnezit mund të përfshihen shumë produkte të rëndësishme jo vetëm për nevojat e Kosovës, por edhe për tregun botëror.

Boksiti ka rezerva prej 7 milionë tonë dhe tërë sasia e prodhuar në minierën Vollujak (Klinë) eksportohet.

Nga kjo mund të thuhet se shumë produkte të bazuara në lëndët e para minerale të Kosovës janë potencial i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Natyrisht, për prodhimin dhe përpunimin e tyre duhet siguruar, në radhë të parë, teknologji moderne dhe kapital me të cilat Kosova fatkeqësisht nuk disponon. Mëpo, për shkak të investimeve joshëse në këtë fushë, investitorët e jashtëm janë të gatshëm të angazhohen në këtë trevë.

Në përgjithësi, zhvillimi ekonomik i Kosovës në këtë periudhë më saktësisht prej Luftës së Dytë Botërore deri në vitet '90, mund të ndahet në dy etapa kryesore: a) etapa e viteve 1947-1965 dhe b) etapa e viteve 1965-1990.

a) Etapa e parë përfshin fazën fillestare të zhvillimit ekonomik të Kosovës, që karakterizohet me shfrytëzimin ekstenziv të faktorëve të prodhimit. Bartës kryesorë të zhvillimit ekonomik të saj ishin bujqësia e prapambetur dhe industria ekstraktive. Në periudhën e viteve 1948-1956, ekonomia e gjithëmbarshme e Kosovës, u zhvillua me një normë shpirtimi të prodhimit shoqëror prej 3,0% në vit (Jugosllavia 4,0%). Kur kësaj i shohet baza e ulët krahasuese, atëherë është e qartë se sa e ngadalshme ishte dinamika e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Në krahasim me periudhën e

mëparshme, në periudhën e viteve 1957-1965, Kosova përjetoj një transformim të dukshëm ekonomik. Në këtë periudhë, filluan të ndërtohen objektet më të rëndësishme industriale dhe të ngritet infrastruktura ekonomike e saj. Kjo ndikoi që Kosova në këtë periudhë të ketë një dinamikë më të shpejtuar të zhvillimit ekonomik. Në këtë periudhë (1957-1965) zhvillimi ekonomik i Kosovës u realizua me normë shumë të prodhimit shoqëror prej 8,5% (Jugosllavia 8,9%).

b) Etapa e dytë e zhvillimit ekonomik të Kosovës karakterizohet me industrializimin e shpejtuar, sepse në këtë etapë janë ngritur shumë objekte të reja ekonomike dhe është bërë rikonstruktimi dhe zgjerimi i objekteve ekzistuese. Në këtë etapë (1966-1988), prodhimi shoqëror i ekonomisë së Kosovës u shtua me normë prej 4,4% në vit (Jugosllavia 3,9%).

Sa i përket strukturës ekonomike, në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë u formua një strukturë e rëndë dhe e pavolitshme ekonomike, që ishte rezultat i politikës së zbatuar ekonomike të Jugosllavisë. Me këtë politikë insistohet që Kosova të jetë kryesisht furnizuese e pjesëve të tjera të vendit me lëndë të parë dhe energji. Për këtë arsye, në ekonominë e Kosovës dominojnë degët bazike dhe energjetika, gjë që është karakteristikë e vendeve të pazhvilluara. Kjo mund të ilustruhet me faktin se vetëm energjëtika dhe metalurgjia me ngjyrë në prodhimin shoqëror të Kosovës merriin pjesë me afro 50%.

Sa u përket dy degëve kryesore të veprimtarisë ekonomike të Kosovës (industria dhe bujqësia), mund të thuhet se në periudhën e pasluftës, dukshëm ndryshoi pozita e tyre. Kështu, për shembull, derisa në vitin 1947 bujqësia mori pjesë me afro 60% në prodhimin shoqëror të ekonomisë së Kosovës, kjo pjesëmarrje në vitin 1988 u zvogëlua në afro 25%. Në industrinë e Kosovës ndodh e kundërta. Këtë pjesëmarrje, industria e rrit prej 16%, sa ishte në vitin 1947, në 45%, në vitin 1988. Megjithatë në këtë periudhë industria së bashku me bujqësinë në prodhimin shoqëror morën pjesë me afro 75%, pra me 3/4, ekonomia e Kosovës konsiderohet si ekonomi industrialo-agrar.

Për zhvillimin ekonomik të Kosovës u përdorën dy burime kryesore të mjeteve financiare: a) burimet e brendshme dhe b) burimet e jashtme.

a) Prej burimeve të brendshme duhet përmendur akumulimin e brendshëm dhe mjetet e Fondit të Federatës për kreditimin e viseve jo mjaft të zhvilluara të Jugosllavisë. Akumulimi i ekonomisë së Kosovës nuk pati ndonjë rëndësi të posaçme për zhvillimin ekonomik të saj, sepse në tërë financimin e këtij zhvillimi mori pjesë me afro 10%. Mjetet e Fondit të Fe-

deratës patën rëndësi mjaft të madhe, sepse, në zhvillimin ekonomik të Kosovës, ato morën pjesë me afro 65%.

b) Ndërkëq, pjesa tjetër, prej afro 25%, sigurohej nga burimet e jashtme. Deri në vitet '70, Kosova, për zhvillimin e vet ekonomik, s'ka importuar kapital fare. Arsyeja kryesore e mosshfrytëzimit të kapitalit të jashtëm deri në ato vite, ishte izolimi i Kosovës brenda kufijve të Serbisë, e cila nuk i lejonte asaj që, në mënyrë të pavarur, të zhvillonte bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar, por, këtë bashkëpunim, në emër të Kosovës, e bënte Serbia.

Me decentralizimin e sistemit politik dhe ekonomik të Jugosllavisë, pas viteve '70, Kosova filloi të ketë bashkëpunim të drejtpërdrejtë ekonomik ndërkombëtar, kështu që, filloi të importonte kapital nga jashtë.

Burimi kryesor i importimit të kapitalit të jashtëm për nevojat e zhvillimit ekonomik të Kosovës ishte Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe zhvillim, por edhe disa institucione të tjera financiare, siç janë: Eksport-Import Banka Amerikane, Eurofima etj., natyrisht me një sasi më të vogël. Kreditë e këtyre institucioneve në fillim u shfrytëzuan vetëm për infrastrukturë (ndërtimi i hidrosistemeve, ndërtimi i rrugëve, ndërtimi dhe modernizimi i hekurudhave etj.), kurse më vonë edhe për ndërtimin dhe modernizimin e objekteve industriale, sidomos të atyre bujqësore. Prej këtyre investimeve veçohet ndërtimi i hidrosistemeve, siç janë: "Ibër-Lepeenci" (faza e parë "Ibri"), "Batllava", "Radoniqi" dhe komunikacioni e lidhjet.

Burimi tjetër, po ashtu i rëndësishëm, i importimit të kapitalit të jashtëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, ishin kreditë komerciale nga bankat dhe firmat e ndryshme të botës. Këto kredi u shfrytëzuan kryesisht për ndërtimin dhe modernizimin e objekteve industriale ku dallohen: ndërtimi i TTE "Kosova B" me dy blloqe, me kapacitet prej mbi 650 mgv, pastaj ndërtimi dhe modernizimi i kapaciteteve të metalurgjisë së plumbit dhe të zinkut brenda "Trepçës", "Feronikeit" etj.

Mund të thuhet se kapitali i jashtëm ndihmoi shumë zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Sistemi i zhvillimit ekonomik i Jugosllavisë në këtë periudhë ishte mjaft i disfavorshëm për Kosovën. Nga ky sistem, posaçërisht duhet veçuar sistemin e çmimeve dhe sistemin e tregutisë së jashtme, ose të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar.

Sistemi i çmimeve në Jugosllavi përbëhej prej dy regjimeve kryesore: regjimi i formimit të lirë të çmimeve dhe regjimi i formimit të kontrolluar ose të dirigjuar të çmimeve.

Në regjimin e formimit të lirë të çmimeve gjendeshin kryesisht produktet finale, kurse në regjimin e formimit të kontrolluar të çmimeve gjendeshin produktet e papërpunuara, pra lënda e parë. Megjithatë Kosova prodhonte kryesisht produkte të papërpunuara dhe lëndën e parë, çmimet e tyre ishin të fiksuara dhe të kontrolluara, pra nuk mund të ndryshonin. Nga ana tjetër, konsumi i Kosovës përbëhej kryesisht nga produktet finale, çmimet e të cilave mund të ndryshonin (ritreshin) lirish. Në këtë mënyrë, pra, një pjesë e madhe e prodhimit shoqëror të Kosovës derdhej dhe shkonte në viset e zhvilluara të Jugosllavisë.

Regjimi i tregtisë së jashtme ishte po ashtu i disfavorshëm për ekonominë e Kosovës. Në regjimin e lirë të eksportit jugosllav gjendeshin kryesisht produktet finale, kurse në regjimin restriktiv produktet e papërpunuara. Në import situata ishte e kundërt: në regjimin e lirë të importit ishin produktet e papërpunuara, kurse në regjimin restriktiv produktet finale, duke marrë parasysh strukturën ekonomike të Kosovës, kjo praktikisht do të thotë se eksporti kosovar ishte restriktiv, kurse importi liberal.

Marrë në tërësi, pasi që Kosova ishte në kuadër të Jugosllavisë, ajo nuk pati sistemin e vet të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar. Prandaj, ekonomia e Kosovës ishte pjesë përbërëse e sistemit jugosllav. Mirëpo, me zhvillimin e sistemit të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar të Jugosllavisë, Kosova, si edhe republika e Jugosllavisë, vazhdimisht fitonin paravësi më të madhe në këtë sistem dhe vinte duke u rritur roli i tyre në hartimin dhe zbatimin e sistemit të Jugosllavisë. Në pika të shkurtra do ta prezantoj zhvillimin e sistemit të Jugosllavisë, vendin dhe rolin e Kosovës në të.

Sistemi i bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar i Jugosllavisë kaloi nëpër dy periudha kryesore:

1. Periudha administrative dhe

2. Periudha vetëqeverisëse.

1. Periudhën administrative e karakterizonte një sistem mjaft restriktiv, që kontrollohej nga shteti dhe i nënshtrohej planifikimit centralist. Bar-tëse e planifikimit dhe e kontrollit shtetëror në fushën e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar, sidomos në atë të tregtisë së jashtme, ishte Ministria e Tregtisë së Jashtme. Kjo Ministri ishte organ administrativ operativ dhe kujdesej për realizimin e planit të eksportit dhe të importit, si edhe për realizimin e marrëveshjeve tregtare dhe të pagesave të nënshtuara midis shteteve. Ministria e Tregtisë së Jashtme i udhëhiqte drejtpërdrejt punët e eksportit dhe të importit, madje nëpërmjet një numri të vogël ndërmarrjesh të specializuara për tregti të jashtme, që ishin të karakterit federativ. Pra, në

këtë periudhë, tregtia e jashtme e Kosovës, edhe pse me një shumë simbole, realizohej nëpërmjet këtyre ndërmarrjeve me seli jashtë Kosovës, kryesisht në Beograd. Pra, në këtë periudhë, Kosova nuk gëzoi kurrfarë të drejte dhe s'kishte kurrfarë roli në zhvillimin e tregtisë së jashtme dhe, në përgjithësi, në zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar.

2. Periudhën vetëqeverisëse e karakterizonte një sistem më liberal i bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar. Mirëpo, një kohë të gjatë, deri në vitet '70, sidomos deri në miratimin e Kushtetutës së Jugosllavisë dhe të kushtetutave të republikave dhe të krahinave autonome (1974), sistemi i bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar ende ishte në kompetencat e Federatës, që do të thotë se republika dhe krahina autonome s'kishin ndonjë rol të veçantë në hartimin e këtij sistemi, por roli i tyre ishte vetëm në zbatimin e sistemit unik jugosllav të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar.

Pas vieve '70, domethënë pas amandamenteve kushtetuese dhe pas miratimit të Kushtetutës së Jugosllavisë dhe të kushtetutave të republikave dhe të krahinave autonome në vitin 1974, roli i republikave dhe i krahinave autonome u rrit, jo vetëm në zbatimin, por edhe në hartimin e sistemit të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar. Republika dhe krahinat autonome, në bazë të kushtetutave të veta, themeluan kuvendet dhe këshillat e veta ekzistuese, kështu që, sistemin e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar, e hartonin organet përkatëse të Federatës, në bashkëpunim me ato të republikave dhe të krahinave autonome.

Në këtë periudhë, ndërmarrjet (si ato prodhuese, ashtu edhe ato të specializuara për tregti të jashtme) në mënyrë të pavarur, planifikonin dhe realizonin eksportin dhe importin e mallrave. Në këtë periudhë, deri në vitin 1973, kur u themelua e vetmja organizatë punuese e specializuar për tregti të jashtme – EXIMKOS, eksporti dhe importi i Kosovës ende bëheshin nëpërmjet organizatave të tregtisë së jashtme, me seli jashtë Kosovës. Për këta ndërmjetësues, pjesëmarrja e eksportit dhe e importit të produkteve kosovare nuk kapnin më shumë se 1-2% të qarkullimit të tyre kështu që, mund të thuhet se ky vëllim kaq i vogël i eksportit dhe i importit kosovar për ta s'kishte ndonjë rëndësi të posaçme. Madje, produktet kosovare, që duhej të eksportoheshin, shërbenin më tepër për plotësimin e asortimentit të tyre në tregjet e jashtme. Prandaj, tregtia e jashtme e Kosovës deri në këtë periudhë jo vetëm që ishte e vogël, por ajo as nuk përcillej fare, kështu që, mungonin edhe të dhënat statistikore për ecuritë e eksportit dhe të importit.

Kjo ndodhi kështu, për arsye se, jo vetëm subjektet ekonomike, por edhe ato të tjera, nuk kishin kontakte të drejtpërdrejta me ato ndërkombëtare, pasi që, këto kontakte, në emër të Kosovës, i mbante Serbia. Pra,

ekonomia e Kosovës ishte furnizuese e ekonomisë së Serbisë dhe e republikave të tjera jugosllave me lëndë të para. Ky furnizim ishte i madh, posaçërisht me xehje, më së shumti me ato të metalurgjisë me ngjyra, krom, magnezit etj.

Mirëpo, me themelimin e EXIMKOS-it, kurse pak më vonë edhe TREPÇA-COMERC-it, AGRO-KOSOVA comercit etj., situata dukshëm ndryshoi në të mirë të Kosovës. Viteve të fundit, para shpërbërjes së Jugosllavisë, afro 2/3 e eksportit dhe importit kosovar, realizohej nëpërmjet organizatave kosovare, kurse 1/3 ende shkonte nëpërmjet organizatave, me seli jashtë Kosovës.

Pavarësimi i republikave dhe i Kosovës në sistemin e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar, vazhdoi edhe më tutje. Ky pavarësim u shpreh sidomos pas miratimit të Ligjit devizor të vitit 1977. Në bazë të këtij Ligji u themeluan BVI-të e republikave dhe të krahinave autonome për marrëdhënie ekonomike ndërkombëtare, kështu që, Kosova, si edhe republikat e tjera, u bë subjekt i pavarur dhe aktivisht merrie pjesë në hartimin e sistemit të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar.

Si rezultat i kësaj pavarësie të republikave dhe të krahinave autonome, asnjë ligj, akt apo dokument në Jugosllavi nuk mund të nxirrej pa konsensus, gjë që do të thotë, se mjaftonte që vetëm një republikë apo krahinë autonome të ishte kundër dhe ligjet, aktet apo dokumentet e tjera, nuk mund të miratoheshin. Shpesh ndodhte që rezolutat vjetore për zhvillimin shoqëror-ekonomik të Jugosllavisë, pastaj buxhetet vjetore, politikat kreditomonetare vjetore, bilanci e pagesa vjetore etj., të bllokoheshin dhe nuk mund të nxirreshin për shak të mospajtitimit të ndonjë republike apo krahine autonome. Pastaj ndërhynte Partia dhe i rregullonte këto mosmarrëveshje.

Pra, përkisist këto ishin shenjat e para të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pritej vetëm momenti i përshtatshëm. ai moment, siç dihet, erdhi pas vitit 1989, kur Serbia okupoj Kosovën dhe njëkohësisht u kërcënuua se këtë do ta bënte edhe ndaj republikave të tjera. Dhe në fund, me shpalljen e luftës nga ana e Serbisë, së pari kundër Sllovenisë e pastaj kundër Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, u arrit shpallja e pavarësisë së republikave dhe, në këtë mënyrë, Jugosllavia mbeu e cunguar (Serbia dhe Mali i Zi).

Papunësia në këtë periudhë ishte mjaft e madhe dhe sillej prej 50-60% prej kontigjentit të aftë për punë. Prandaj, prej vitit 1969, kur filloi shkuarja e organizuar për punësim në botën e jashtme, kryesisht në Evropën Perëndimore, deri në vitin 1989 nga Kosova emigruan afro 60.000 punëtorë. Ata ishin punëtorë të veshëm, të disiplinuar dhe kursimtarë të mëdhenj. Falë

dërgesave të tyre, standardi individual në Kosovë dukshëm u përmirësua dhe ishte shumë më i lartë, se që tregonin parametrat zyrtare. Për shembull, në atë periudhë vlerësohej se bruto prodhimi kombëtar për banor në Kosovë ishte 900 dollarë, mirëpo standardi ishte më i lartë për shkak të dërgesave të punëtorëve tanë në botën e jashtme.

Me shpalljen e Kushtetutës së Serbisë, në mars të vitit 1989 e sidomos prej vitit 1990, kur suprimohen Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, filloi shkatërimi i çdo veprimtarie në Kosovë, pra filloi edhe rrënimin e ekonomisë së Kosovës.

Nga korriku i vitit 1990 dhe më vonë Kuvendi i Serbisë vendosi masat e dhunshme në 336 ndërmarrje dhe institucione të Kosovës me pretekst të mbrojtjes së pasurisë shoqërore, por në fakt me qëllim të plaçkitjes së saj. Veprimet genë tepër të vrazhda dhe militante, duke mos përfillur ligjshmërinë, madje as atë që e miratonte Kuvendi i Serbisë. Ato manifestoheshin me forma të ndryshme, si për shembull, integrimi me dhunë dhe pa dokumentacion përkatës në ndërmarrjet serbe, shifja e ndërmarrjeve me gjinime shumë të ulëta (në shumicën e rasteve edhe simbolike), privatizimin i tyre sipas përkatësisë kombëtare, politike, familjare, pastaj bëhej vjedhja e pajimeve, teknologjisë, mallrave, mjeteve financiare etj.

Me qëllim të krijimit të prezencës sa më të madhe të serbëve dhe të malazezëve, punëtorët shqiptarë me dhunë u larguan nga puna (130.000 nga gjithsej 165.000 shqiptarë të punësuar), pastaj me dhunë nxerën nga banesat e tyre etj. Sipas të dhënave të Kontabilitetit Shoqëror të Jugosllavisë, rënja e punësimit në sektorin shoqëror gjatë periudhës 1989-1994 dukej kështu:

1989	178.000
1990	140.000 (-39.0000)
1991	123.000 (-17.0000)
1992	82.000 (-40.000)
1993	68.000 (-14.000)
1994	58.000 (-10.000)

Pra, gjatë kësaj periudhe, numri i punëtorëve në sektorin shoqëror u zvogëluua për afro 120.000, të cilët në tërësi ishin punëtorë shqiptarë.

Si pasojë e këtyre veprimeve, dukshëm bie vëllimi fizik i prodhimit industrial (që merrie pjesë me mbi gjysmën e prodhimit shoqëror të ekonomisë së Kosovës). Sipas të dhënave të Entit Federativ të Statistikës, gjatë periudhës 1989-1994 rrënja e vëllimit fizik të prodhimit industrial dukej kështu:

1989 – 5% në krahësim me vitin paraprak
1990 – 28% në krahësim me vitin paraprak

1991 – 20% në krahësim me vitin paraprak
1192 – 15% në krahësim me vitin paraprak
1993 – 29% në krahësim me vitin paraprak
1994 – 4% në krahësim me vitin paraprak

Shfrytëzimi i kapaciteteve industriale në vitin 1988 ishte 65%, kurse në vitin 1994 ky shfrytëzim ra në vetëm 20%, më vonë në 10%.

Rënie drasitike u shënua edhe në veprimtari të tjera ekonomike si në eksport dhe import, në tregti me pakicë, në ndërtimtar, në grumbullimin dhe shfajten e produkteve bujqësore, në shfrytëzimin e pyjeve, në komuni-kacion etj.

Pjesëmarrja e ekonomisë së Kosovës në bruto prodhimin e ekonomisë jugosllave bie prej 2,10% (sa ishte në vitin 1980) në vetëm 1,37% në vitin 1990.

Krahësimi rrënim i të ndërmarrjeve ekonomike, u rrënuua edhe sistemi bankar. Gjyate vitit 1990, varësist nga faktorët e jashtëm, u ndërmorën katër veprime të ndryshme: në fillim të vitit për sanim dhe konsolidim, në qershor për transformim në shoqëri aksionare në gusht për zbatim të masave të dhunshme dhe në shtator për fillim të procedurës për likuidim. Të gjitha këto veprime u bënë në kohën kur Banka e Kosovës dispononte një pasuri prej 750 milionë dollarë dhe me obligime prej 660 milionë, pra me një pasuri mbi obligime prej 90 milionë dollarë.

Çdo gjë ka mundur të merrrej nga Banka e Kosovës duke llogaritur edhe afro 100 milionë dollarë të kursimtarëve të Kosovës. Këto kurse me i ka marrë Jugobanka e Beogradit, e cila, përkundër dispozitave dhe kontratave, ka refuzuar t'i kthejë, si edhe t'i kryej obligimet ndaj partnerëve të jashtëm.

Obligimet ndaj botës që duhej kthyer deri në vitin 2004, pa llogaritur kamatat ndëshkuese, arrijnë në afro 1 miliard dollarë. Këto obligime Banka e Kosovës dhe ekonomia e shkaktoar e saj nuk mund t'i kthejnë, por këtë duhet bërë Serbia si shkaktoar e vetme për këtë rrënim. Natyrisht, ajo duhet ta mbulojë edhe dëmin tjetër.

Norma e inflacionit gjatë kësaj periudhe ishte aq e lartë, sa që i tejkaloi të gjitha normat e njohura në botë të të gjitha kohërave. Kishte peri-udha kur ajo sillej mbi 1.000 miliardë për qind në vit. Normat kaq të larta të inflacionit ishin pasojë, në radhë të parë të luftës, por edhe korrupsionit.

Dhuna dhjetëvjeçare e pushtesit serbo-sllav pati pasojë katastrofike për ekonominë dhe popullatën kosovare. Vetëm gjatë fazës së rrënim të ekonomisë kosovare, me gëllitjen e ndërmarrjeve vitale të ekonomisë së Kosovës nga ato të

Serbisë si dhe me plaçkitjen e mjeteve themelore dhe garikulhese të sektori shoqëtor, u shkaktoan dëme të mëdha, që vlerësohen në disa miliardë dollarë. Kur kësaj i shtojmë edhe shndërrimin e Kosovës në tokë të djegur nga forca ushtarako-police dhe paramilitare serbo-sllave, vlera e resurseve të shkaktoaruar materiale kaq shumën prej afro 12-13 miliardë dollarë.

Sipas disa vlerësimeve, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, fondi mekanizimit bujqësor u zvogëluua për 70%, fondi i kafshëve për afro 60% pastaj shumë fusha pjellore dhe male u minuan, shumë objekte industriale u shkaktoaruan dhe u plaçkitën, kështu që ekonomia e Kosovës ra në zero.

Sot – periudha prej vitit 1999

Prej qershorit të vitit 1999, me hyrjen e forcave të NATO-s dhe me dëbimin e forcave ushtarako-police dhe paramilitare serbe, Kosova u çli-ruua dhe filloi një fazë e re, jo vetëm në zhvillimin ekonomik, por edhe në të gjitha fushat e tjera për jetë normale dhe të qetë, për demokracizim, për res-pektrimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, posaçërisht të pakicave, për plu-ralizëm politik dhe në përgjithësi për ndërtimin e një shoqërie civile sipas standardeve të botës së zhvilluar dhe të civilizuar. Për realizimin e këtyre synimeve, në Kosovë u vendos Administrata e Përkohshme Ndërkombëtare – UNMIK, tupa e KFOR-it, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evro-pian – OSBE dhe mbi 100 organizata të tjera joqeveritare dhe humanitare.

Administrata e UNMIK-u, ekonominë kosovare e gjeti në një kolaps të plotë dhe praktikisht duhej filluar nga zeroja. Me qëllim të rindërtimit të ekonomisë kosovare dhe krijimit të një ekonomie të hapur, të bazuar në tregun e lirë, UNMIK-u, brenda sistemit të vet, formoi shyllën e IV-të me këto departamente:

1. Departamenti i Rindërtimit;
2. Autoriteti Qendror Fiskal;
3. Departamenti i shërbimeve Publike dhe
4. Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë.

1. Departamenti i Rindërtimit mbikqyr dhe koordinon programin e rindërtimit. Ky Departament, në bashkëpunim me administratën vendore, synon që ekonominë e Kosovës sa më shpejt ta rindërtojë dhe pastaj të kalo-het në zhvillimin ekonomik. Duhet theksuar se dy vjet e para, qëllimi kryesor i këtij Departamenti ishte rindërtimi i shërbive dhe strehimi i nje-rëzve, shërbijtë e të cilëve janë djegur dhe dëmtuar nga lufta.

2. Autoriteti Qendror Fiskal funksionon si Bankë Qendrore (pa drejtën e emetimit të parasë), si edhe kryen rolin e ministrit së financave. Në kompetencat e tij janë buxheti i konsoliduar i Kosovës, administrata tatimore, shërbimi doganor dhe shërbimet e tjera fiskale, duke përfshirë edhe thesarin. Duhet theksuar se në vitin 2000 pjesëmarrja e donatoreve të jashtëm në buxhetin e Kosovës ishte 75%, në vitin 2001 50%, kurse në vitin 2002 7%.

3. Departamenti i Shërbimeve Publike kujdeset për funksionimin e suksesshëm të shërbimeve publike, siç janë: administrata, gjyqësia, policia e sidomos infrastruktura (energjia elektrike, uji, rrugët, ambientet e tjerë).

4. Departamenti i Tregut dhe Industrisë ka për qëllim që të krijojë kushte për fillimin e procesit të zhvillimit ekonomik përmes stimulimit të iniciativës private, në radhë të parë të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla në industri, tregti, bujqësi etj. Sa u përket ndërmarrjeve të mëdha (atyre shogrore apo shtetërore), në fillim ky Departament u përkaktua për komercializimin e tyre, kurse para disa muajve filloi privatizimin dhe transformimin e tyre përmes metodave të njohura në botë. Për mbikëqyrjen dhe realizimin e këtij procesi u themelua Agjencia e Kosovës për Mirëbesim (AKM).

Për realizimin e synimeve të këtyre departamenteve dhe për menaxhimin e ndihmave kryesore që jepen nga Unioni Evropian – UE, u themelua Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER). Kjo Agjenci është si institucion i pavarur, por për punën e vet i përgjigjet Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Ajo udhëhiqet nga Bordi i Agjencisë, i cili përbëhet nga një përfaqësues nga çdo shtet anëtar dhe dy përfaqësues të Komisionit Evropian, pra gjithsej 17 anëtarë.

Kontributin e donatorëve të jashtëm dhënë Kosovës dhe të menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, gjatë periudhës 1999-2002, do ta prezentojmë në një pasqyrë tabelare:

- në miliona Euro -	1999	2000	2001	2002	Totali
Sektorët	1999	2000	2001	2002	Totali
Energjia dhe shërbimet publike	25	136	155	60	376
Rindërtimi i shërbimeve	14	60	38	16	128
Administrata civile	41	10	39	17	107
Infrastruktura (transporti etj.)	14	15	18	6	53
Bujqësia	1	12	27	9	49
Ndërmarrjet	5	15	22	10	52
Shëndetësia	1	10	14	5	30
Shërbimet organizative	5	4	14	3	26
Të tjerat	21	-	3	9	33
Gjithsej:	127	262	330	135	854

Pra, nga kjo tabelë shihet se donatorët e jashtëm nëpërmjet të Agjencisë Evropiane për Rindërtim, për rindërtimin e ekonomisë së Kosovës dhe shërbimet vitale, kanë angazhuar afro 854 milionë euro. Nga këto mjete, më së shumti janë dhënë për energji dhe shërbimet publike 376 milionë euro, për rindërtimin e shërbimeve 128 milionë, për administratë civile 107 milionë etj.

Falë këtyre ndihmave, ekonomia kosovare shënon tendencë të rëndësishme pozitive. Këto tendencë pozitive më së miri vërehen në ndërtimin e infrastrukturës (energjia elektrike, ujësjellsin, meremetimin dhe ndërtimin e rrugëve, ferrovinë, aeroportin etj.). Përveç kësaj, tendencë pozitive vërehen edhe në ekonominë private (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), në zejtarin, tregtinë, hotelierin, në rindërtimin e shërbimeve të dëgjura dhe të dëmtuara nga lufta, por edhe në ndërtimin e objekteve të reja në arsim, shëndetësi, në re-habilitimin e agrarit, veçmas të fermave të vogla në fshat, duke siguruar farëra, gjedhe, plehëra dhe një pjesë të mekanizimit bujqësor.

Gjatë kësaj periudhe, nga faktori i brendshëm dhe ai ndërkombëtar, janë bërë avansime edhe në krijimin e infrastrukturës ligjore, përkatësisht janë nxjerrë disa rregullore me të cilat tentohet të krijohet rrethi normativ dhe juridik i funksionimit të biznesit në Kosovë. Në fushën ekonomike janë nxjerrë këto rregullore më të rëndësishme:

1. Rregullorja për doganat, akcizën dhe tatimin në qarkullim
2. Rregullorja për autoritetin e bankave dhe të pagesave të Kosovës
3. Rregullorja për licencimin, kontrollimin dhe rregullimin e bankave
4. Rregullorja për regjistrimin e biznesit
5. Rregullorja për taksat në ushqim dhe në pije
6. Rregullorja për tatimin e parajgykuar
7. Rregullorja për investimet e jashtme
8. Rregullorja për tatim në paga
9. Rregullorja për sigurimin pensional etj.

Edhe përkundër arritjes së këtyre rezultateve pozitive, mund të themi se ekonomia e Kosovës është një ekonomi konsumuese.

Në mungesë të prodhimit vendor, nëpër shtete tona afro 90% të produkteve janë nga jashtë, pra të importuara, në radhët e parë ato ushqimore, teknika e bardhë, mobile, produktet e veshmbathjes etj. Kjo do të thotë se afro 90% të parasë kosovare shkon jashtë dhe nuk është në funksion të qarkullimit të brendshëm.

Eksporti i Kosovës është simbolik, të mos them zero. Edhe pse prej qershorit të vitit 2000 Komisioni i Unionit Evropian Kosovës i lejoi leh-

tësira tregtare, që do të thotë se për mallrat e Kosovës në tregun e Unionit Evropian nuk zbatohen doganat, këto lehtësira tregtare nuk shfrytëzohen për shkak të mungesës së produkteve kosovare. Këto lehtësira aktualisht i shfrytëzojnë prodhuesit e verës dhe eventualisht edhe ndonjë prodhues tjetër, por ato janë simbolike.

Për mënjanimin e këtyre proceseve negative në ekonominë kosovare, duhet një angazhim shumë i madh i organeve tona qeveritare në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar. Këtu, në radhë të parë, mendohet në krijimin e kushteve për fillimin e procesit të prodhimit në Kosovë. Aktualisht, kushtet për fillimin e procesit të prodhimit janë shumë të vështira. Për shembull, për t'u ndërtuar ndonjë objekt prodhues, prodhuesit i nevojitet kredia nga ndonjë bankë komerciale kamata e të cilës është shumë e lartë dhe ajo sillet prej 15-18%, pastaj dogana 10%, tati në garkullim 15%, pra që në start prodhuesi vendor, pa filluar procesin e prodhimit, ngarkohet me mbi 40% të shpenzimeve, të cilat vështirë se mund të kompensohen. Prandaj, në Kosovë nuk ka prodhues dhe as që mund të ketë në këto kushte.

Politika doganore në Kosovë aktualisht nuk është në funksion të zhvillimit ekonomik. Rregulloretja për dogana ka disa mangësi të cilat dukshëm ndikojnë në prodhimin vendor dhe në buxhejin e konsoliduar të Kosovës. Nga të metat kryesore mund të veçohen këto:

Së pari, mallrat që importohen nga Serbia dhe Mali i Zi nuk doganohen, kurse nga Magedonia zbatohet dogana prej vetëm 1% për shkak të Marrëveshjes së nënshkruar midis Jugosllavisë (Serbisë dhe Malit të Zi) dhe Magedonisë në vitin 1966, që rregullon statusin profesional tregtar midis tyre. Pra, sipas kësaj Rregullore, nga vendet fqinje dogana prej 10% zbatohet vetëm në mallra që importohen nga Shqipëria. Kjo mangësi u tejkalua me nënshkrimin e Marrëveshjes të mirëkuptimit midis UNMIK-ut dhe Qeverisë së Shqipërisë më 15 korrik të vitit 2002, në bazë të të cilës tregtia midis Kosovës dhe Shqipërisë do të jetë e lirë, pa zbatuar dogana; dhe:

Së dyti, duke i doganuar pajimet, pjesët rezervë dhe materialin tiprodhues, humb motivi i prodhuesve vendorë për ndonjë ndërmarrje në këtë drejtim. Prandaj, këto produkte duhen të lirohen nga pagaesa e doganës.

Nesër – prej sot e tutje

Pasi që faza e rindërtimit është në përfundim e sipër, tani e tutje Kosova, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, duhet të përqëndrohet në

krijimin e kushteve për fillimin e procesit të prodhimit, sepse pa prodhir nuk ka zhvillim ekonomik.

Për realizimin e këtij synimi duhet nisur nga koncepti i ekonomisë s pavarur, si një proces i pashmangshëm dhe e vetmja alternativë e arrijtes rezultateve zhvillimore në ekonominë e Kosovës. Për realizimin e këtij koncepti, duhet sa më shpejt të zgjidhet statusi politik i Kosovës dhe atë si shtet i pavarur dhe ndërkombëtarisht i pranuar.

Njëkohësisht, për arrijen e rezultateve zhvillimore në ekonominë Kosovës, angazhimi ynë duhet të përqëndrohet në këto tri fusha kryesore;

1. Krijimin e kushteve për tërheqjen e investimeve të jashtme;
2. Krijimin e një regjimi doganor e tregtar liberal; dhe
3. Transformimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore (shtetërore).

1. Angazhimi i investimeve të jashtme është vendimtar për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës, sidomos kur merren parasysh pasuritë e Kosovës, siç u tha, me resurse natyrore dhe njerëzore.

Pra, çështja e financimit të zhvillimit ekonomik të Kosovës është prioritet mbi prioritete. Në mungesë të kapitalit të brendshëm i vetmi burim për financimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës janë investimet e jashtme Mirëpo, për angazhimin e investimeve të jashtme në ekonominë e Kosovës duhen krijuar kushtet e nevojshme.

Prej kushteve kryesore që duhen krijuar për angazhimin e investimeve të jashtme, posaçërisht dallohen: siguria, stabiliteti politik dhe ekonomik funksionimi i mirëfillt i ligjeve, pastaj një sistem i zhvilluar krediti-moneta dhe bankar. Në këtë drejtim, duhet përshëndetur vendimin e Qeverisë amerikane për garantimin e investimeve amerikane në ekonominë e Kosovës.

Si kusht i rëndësishëm për angazhimin e investimeve të jashtme, është edhe antarsësimi i Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare (Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore) dhe rajonale (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim etj.). Me antarsësimin e Kosovës në këto institucione, investitorët e jashtëm fitojnë një besim dhe siguri më të madhe me rastin e angazhimit të investimeve të tyre në ekonominë e Kosovës. Natyrisht, ky antarsësim ndërlihet me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, sepse antarë të këtyre institucioneve mund të jenë vetëm shtetet e pranuarat ndërkombëtarisht.

Si burim tjetër i rëndësishëm i investimeve të jashtme, për ekonominë e Kosovës, mund të konsiderohet edhe kursimi i mërgatës (diasporës) nëpër bankat e ndryshme ku ajo mërgat jeton dhe punon. Edhe pse, një pjesë e këtyre investimeve është angazhuar dhe është duke u angazhuar në ndërti-

min e shëpiëve, lokaleve afariste, restoranteve dhe objekteve hoteliere, një pjesë edhe në vepirimiari prodhuese, mirëpo ky angazhim bëhet në mënyrë individuale, e jo kolektive dhe sistimore. Të gjitha bankat e jashtme, ku është depozuar kursimi i mëngatës, u përkasin sistemeve të bankave të mëdha, të cilat, me rrjetin e vet të rrjetëve afariste, mbulojnë tërë territorin e vendit të caktuar. Për mobilizimin e kursimit në formë të shfrytëzimit të kredive për ekonominë e Kosovës në këto banka, të gjitha aktivitetet dhe operacione bankare mund të ndërmerren dhe të zbatohen vetëm në nivel të këtyre sistemeve të bankave të mëdha.

Si shfrytëzues të këtyre kredive mund të paraqiten: ekonomia kosovare në tërësi, si subjekt që do ta përfaqësonë Qeveria dhe Banka Qendrore, subjektet e caktuara ekonomike veç e veç, të cilat me pëlqimin e qeverisë autorizohen për një ndërmarrje të tillë. Të tërë aktivitetin rreth shfrytëzimit të kredive të tilla do ta përcillet Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës.

Një burim tjetër i rëndësishëm për financimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës është edhe "*Pakti i Stabilitetit*", që u themelua më 10 korrik të vitit 1999, me inisiativën e Unionit Evropian dhe mbështetjen e plotë të SHBA-së. Filozofia e këtij Pakti, e cila që nga Samiti i parë në Sarajevë dhe në vazhdim ka ardhur duke u konsoliduar, është që të ndihmohen vendet e Ballkanit (Shqipëria, Kroacia, Bosnja Hercegovina, Maqedonia, Kosova, Serbia dhe Mali i Zi), përmes reformave në fushat e zhvillimit ekonomik, të demokracisë dhe të sigurisë. Në atë Samit, më shumë se 45 vende donatore dhe 36 institucione ndërkombëtare kanë premtuar 2,4 miliardë euro për realizimin e projekteve për zhvillimin ekonomik.

Si çdo proces i ri e i panjohur edhe Pakti iu nënshtua dhe vazhdon të jetë nën trysinë e interpretimeve të dy ekstremeve: si optimiste, ashtu edhe pesimiste. Sipas optimistëve, Pakti konsiderohet si një "Plan Marshal", si "thes me para" që do të jetë e ardhmja e Ballkanit, kurse sipas pesimistëve Pakti konsiderohet si "proces i dështuar". Zakonisht, e vërteta qëndron midis këtyre dy ekstremeve, prandaj duhet bërë çmos për rritjen e transparencës në lidhje me këtë inisiativë të rëndësishme rajonale.

Pakti i Stabilitetit përbën gjithashtu një instrument pararendës në funksion të objektivit strategjik që kanë të gjitha vendet e rajonit tonë – integrimin në familjen e madhe të Unionit Evropian. Pakti është një proces integrimi të një rajoni, të cilit historia i ka ofruar në masë të madhe përçarjen dhe konfliktet etnike. Pakti është një maratonë e gjatë në finishin e së cilës do të dëshironin të mbërijnë njëkohësisht të gjithë garuesit dhe ku medalja e fituesit do të jetë pagja dhe prosperiteti i rajonit.

Vendet e rajonit kanë kultura relativisht të ndryshme. Por, sot ne jemi të gjithë pasqirë të njëjtit teren, që edhe pse përballëmi me probleme dhe nevoja të ndryshme, zgjidhjet i kemi të përbashkëta: destinacionin, rrugën e parimet dhe instrumentet që të çojnë atje.

Pakti i Stabilitetit dhe integrimi rajonal janë një apel për vendet e rajonit për hyrjen e tyre në Unionin Evropian. Vetëm bashkëpunimi dhe përpjekjet e përbashkëta mund ta bëjnë këtë objektiv një realitet.

2. Krijimi i një regjimi doganor dhe tregtar liberal, sot është kusht shumë i rëndësishëm për hapjen e tregjeve dhe globalizimin.

Për globalizimin, intensivisht flitet prej viteve '90 të shekullit XX. Globalizimi është një integrim i kapitalit, i teknologjisë dhe i informatave përtej kufijve shtetërorë, me qëllim që të krijohet një treg i vetëm në botë. Pra, ky fenomen përmban në vete procese, të cilat çojnë drejt zvogëlimit të rolit të kufijve shtetërorë dhe bashkimit të tregjeve kombëtare në një treg të vetëm global.

Globalizimi si pikënisje dhe si bazë ka konkurrencën, si një kategori progresive të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore në botë dhe mbështetjet në shoqërinë demokratike pluraliste, ekonominë e tregut dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në lidhje me globalizimin, në botë ka disa debate të ndezura, që do të thotë se globalizimi ka përkrahësit dhe kundërshtarët e tij.

Përkrahësit e globalizimit janë kryesisht nga vendet e zhvilluara, me në krye SHBA, Gjermaninë, Japoninë, etj., të cilët, globalizimin e konsiderojnë si lokomotivë e zhvillimit të ardhshëm ekonomik në botë. Këtë e argumentojnë me të arriturat e mëdha që u realizuan gjatë dekadave të fundit në shumë fusha ekonomike, siç janë prodhimi botëror, GDP per capita, tregtia ndërkombëtare, financimi ndërkombëtar etj. Të gjitha këto, kanë ndikuar në rritjen e dukshme të standardit dhe të mirëqenies njerëzore.

Përkrahësit, globalizimin e konsiderojnë si një proces i paevitueshëm dhe që do t'i përfshijë të gjitha vendet dhe të tëra fushat e jetës në botë.

Kundërshtarët e globalizimit janë kryesisht nga vendet në zhvillim, idhtarë të proteksionizmit dhe të intervencionizmit. Brënda tyre vëgohen disa kategori njerëzish, si për shembull, neo-komunistë, anarkistë, ekologjistë, të gjeibërimit etj. Kundërshtarët, globalizimin e shikojnë me skepticism dhe dyshojnë në zhvillimin e ardhshëm ekonomik në botë. Madje, ata globalizimin e konsiderojnë si shkakun kryesor të pabarazisë dhe të thellimit të hendekut midis vendeve të zhvilluara dhe të atyre në zhvillim,

pastaj të shfaqjes së varfërisë, të papunësisë, të sëmundjeve epidemike dhe të ndodhjes së ambientit.

Kundërshtarët po e shprehin mllëfin e vet ndaj globalizimit me reagime, protesta, demonstrata dhe mingje, që po organizohen me rastin e tubimeve të ndryshme ndërkombëtare, siç janë ato të Organizatës Botërore të Tregutisë (VTO), të institucioneve financiare botërore (Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore), të G-7 (Grupi shtatë vendeve më të zhvilluara në botë), etj. Reagimet dhe protestat e fundit, janë mbajtur në Sijetëll (SHBA), në Pragë, në Uashington, në Kvebek (Kanada), në Napoli etj. Organizatorët dhe pjesëmarrësit e këtyre protestave tubohen nga të gjitha anët e botës (kanë organizim të mirë falë internetit), i bllokojnë rrugët, avenytë e sheshet, duke kërkuar ndërprijen e tubimeve ndërkombëtare, pasi ato shkojnë në dëm të njëzëzimit në botë.

Prandaj, shumë politikanë në botë, kur flasin për globalizimin, shpesh potencojnë se globalizimi është një proces human me perspektivë, por, si çdo fenomen i madh, edhe ai i ka dobësitë e veta.

Sipas mendimit tonë, eksperiencia e dekadës së fundit ka treguar se globalizimi, në thelb nënkupton tendencën në rritje të këmbimeve të bizneseve nga një vend në një tjetër, duke gjenëruar këmbime mallrash, shërbimesh, lëvizje kapitali dhe të jetëzve. Gjithashtu, një rëndësi të madhe merr progresi potencial në këmbimin e informatave dhe ideve. Lëvizja e lirë e kapitaleve, në shumicën e rasteve shoqërohet edhe me transferime të teknologjive të avancuara.

Eksperiencia, po ashtu, dëshmon se hapa është një kërkesë e domosdoshme për zhvillimin dhe prosperitetin e një vendi. Historia botërore nuk dëshmon për vende të mbyllura dhe të zhvilluara njëkohësisht. Përkundrazi, vendet fillimisht të varfura kanë qenë më të suksesshmet në ritmet e zhvillimit vënie të fundit, siç janë "Tigrat e vegjël ekonomik": Singapori (me 30.170 dollarë GDP per capita), Hong Kongu (23.660), Korea Jugore (8.600), Malezia (3.670), Tajvani etj. Këto vende arritën nivelin që gëzojnë sot, kryesisht në saj të hapjes ndaj tregut botëror dhe politikave që mbështesin sektorët që tërheqin investimet e jashtme dhe që prodhojnë për eksport. Modeli i zhvillimit ekonomik i këtyre vendeve mund dhe duhet të zbatohet në rastin e zhvillimit të ardhshëm ekonomik të Kosovës.

Mesatarisht, të gjitha shtesat e popullsisë përfitojnë nga hapa e tregjeve. Por, përdërisa në planin afatgjatë përfitojnë të gjithë, në periudhën afatshkurter hapa mund të ketë efekte të ndryshme ndaj grupeve të veçanta të popullsisë. Hapa e tregjeve ka rezultat pozitiv vetëm nëse ajo vendoset

në një kontekst më të gjerë politikash zhvillimore. Është detyra e shtetit të hartojë dhe të zbatojë politika zhvillimore që e zbusin këtë efekt në segmente të caktuara të ekonomisë apo shoqërisë, duke siguruar në këtë mënyrë një shpërndaje sa më reale të kësaj kostoje.

Natyrisht, zhvillimi nëpërmjet hapjes së tregjeve shoqërohet edhe me implikime dhe sfida të ndryshme, siç janë korrupsioni, kontrabanda etj., por, shteti me politikën e vet të shëndoshë, do të jetë ai që do t'i përballojë këto.

3. Transformimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore (shtetërore) në Kosovë është vonuar, si duket për shkakë politike. Ndërkombëtarët ishin për komercializim, kurse vendorët për privatizim, kurse aty ku privatizimi nuk mund të realizohet, duhet të bëhet komercializimi.

Duke u bazuar në përvojat e deritanishme të privatizimit në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore, mendojmë se privatizimi në Kosovë do të jetë më i suksesshëm dhe më i shpejtë. Këtë optimizëm e mbështes edhe në prezencën e faktorit ndërkombëtar, i cili do të kontribuojë në evimin e elementeve negative që kanë ndodhur në vendet e përmendura.

Por, njëkohësisht dua të theksoj se nuk duhet pritur rezultate spektakulare në këtë privatizim, sidomos në fushën e punësimit dhe të pagave.

ballkanas ka filluar me disa shënje premtuese. Këtu e kemi fjalën të **Fanula Papazoglu** e cila, në monografinë e saj e njohur *Srednjobalkanski plemen u predrimskom doba-* monografi e botuar më vonë edhe anglisht në një formë të zgjeruar – i ka vënë re ndryshimet karakteristike fonetike midis emrave të përveçëm dardanas, nga njëra anë, dhe emra të epërveçëm ilirë dhe trakas nga ana tjetër. Mirë po në kohën e botimit të kësaj monografie hulumtuesit e vendeve të ndryshme nuk i dhanë ndonjë rëndësi të madhe zbulimit të Fanula Papazoglut (përveç vërejtjes së disa shkencëtarëve që pjesa përëndimore e Dardanisë ishte nën ndikimin e ilirishes, kurse pjesa e saj lindore nën atë të trakishes). Por as më vonë, në asnjë monografi, në asnjë studim nuk e kemi gjetur as jehonën më të vogël të këtij zbulimi. Gjurmimi i thellë, me metoda kistorike, të historisë së Dardanisë së lashtë është merita e shkencëtarit tuaj të njohur, e profesorit **Zef Mirdita**, i cili me *Studimet dardane*, pastaj me monografinë e tij *Religjioni dhe kulturet e dardanëve dhe Dardanisë në antikë* është afirmuar si një udhëgjës i aftë dhe i zellshëm për të sqartuar të kaluarën e Dardanisë, e Kosovës së Antikës. Ai i ka zbuluar i pari gjurmët e dy *civitates peregrinorum*, dmth gjurmët e dy fiseve dardanase të cilat administrata romake s'i ka përfshirë në riorganizimin e vendit sipas kallëpit romak, po i ka lënë të paprekura që të udhëqeshin nga krerët e tyre si para pushtimit romak. Mirë po ky zbulim i rëndësishëm, i cili na paska vërtetuar që sëpaku një pjesë prej dardanasve nuk është romanizuar kurrë, me sa duket nuk njihet në vendet e tjera. Shkencëtarët e huaj vazhdojnë të flasin edhe sot për “romanizimin e plotë të Dardanisë”. Për shkak të minierave të saj të pasura edhe Roma edhe Bizanti i kanë kushtuar Dardanisë një vëmendje të posaçme, por përveç ndërtimeve të mëdha të **Justinianit** nuk kemi shumë njohuri nga fusha e historisë së dardanëve. (Le të shënojmë këtu ndër klapa që edhe gjurmimi filologjik i toponimisë së përdorur në veprën e njohur e **Prokopit nga Cesarea De aedificiis** mund të na përgëzojë me disa zbulime premtuese, sidomos për sa u përket ndërtimeve të reja ose rindërtimeve në trevat e Dardanisë). Një gjë është e padiskutueshme: historiografia ndërkombëtare nënvizon karakterin e tyre e pamposhtëm i cili nuk u ka lejuar kurrë romakëve kolonizues t'i vinin nën zgjedhën e tyre. Edhe burime të ndryshme të huaja i përmendin kalorësit isaurinë, bijtë e kësaj popullsie së paepur malësore të provincës romake Syri, kalorësit e frikshëm e së cilës romakët i kanë vendosur në Dardani si një “komando të posaçme policore-ushtrake” të ditëve tona për t'i shypur këta bij të patrembur të popullit dardanas. Me dhjetra mbishkrime latine dëshmojnë humbjet e mëdha e pushtetit kolonizues, me dhjetra romakë “të varë të luftë kundër hajdutëve dardanas” (*occisi in lucta contra latronum dardanorum*). Po ç'u bë më vonë me këta “latrones”, me këta heronj të pamposhtur të Dardanisë? Jam i bindur që përgjigjia përkatëse duhet kërkuar dhe

gjindet në kronikat bizantine, sepse është e pamundur që banorët e krahinës më së pasur në miniera të Perandorisë Bizantine, banorët dardanas e lindur për ushtarë, e lindur – mund të themi – në shalë – të mos kishin lojtur një rol të rëndësishëm në ushtrinë e një perandorie e cila vendoste disa herë, bile e ka edhe filluar dy herë, që të rikrijonte Perandorinë e vjetër madheshtore romake. *Dardanasit nuk janë romanizuar, dmth ata as nuk janë çlukur nga Dardania*. Ç'u bënë ata, ku i kanë lënë gjurmët e tyre e dukshme, përveç gjurmëve të tyre materiale të cilat i ka zbuluar gjer më sot arkeologjia. Jam i bindur që nuk ju habit aspak në goftëse e theksoj që vazhdimësia e dardanasve ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, që mbijetesa e toponimisë së lashtë dardanase mund të na shërbejë si një duhërrëfyese në errësinë e së kaluarës. Sa më tepër zhyem në historinë dhe jetën e dardanasve të lashtë aq më tepër rritet bindja ime se edhe nga ky trull ka mbirë një bisk i fortë dhe i qëndrueshëm i shqiptarisë, ose i dardano-ilirëve, stërgjyshër të shqiptarëve të sotëm. Përveç kronikave bizantine, toponimia dardanase, emrat e përveçëm dardanas dhe disa dukuni të rregullta në ndikimin e ligjeve të vjetra fonetike të lashta të shqipes mund të na ndezin disa qirinj të vegjël për të na ndriçuar pak errësinë e Antikës dhe për të na orientuar me një siguri më të madhe. Këtë punë e presim kotë që të bëjnë të tjerët, hulumtues të huaj. Kjo punë mund të krahasohet me mundimin e atij i cili gjurmon tejprtej një mullar kashte për të gjetur një gjilpërë të humbur. Mirë po për sa i përket këtij mundimi të madh mund të themi se e vlen barra qiranë, sepse kjo gjilpërë është prej floriri dhe mund të na çojë të gjilpëra të mëtejshme... Mirë, po për sa i përket antikës kuptohet vetvetiu mungesa e interesimit nga ana e hulumtuesve të huaj, të cilët janë të mendimit që lidhja midis dardanasve dhe shqiptarëve është vetëm një ëndërr nostalgjike e kosovarëve. Pas gjejes së gjilpërës së parë le ta shihni interesimin e botës, le ta shihni zellin e kolegëve të huaj! Dhe nga ana tjetër jam i bindur që gjilpëra të tilla, bile të shumta, mund të gjinden edhe duke vënë nën mikroskopin e gjubëtarit fjalët e posaçme e së folmes shqipe kosovare. Jam plotësisht i bindur që duhet t'i kushtojmë një vëmendje të posaçme veprës së njohur të **Prokopit nga Cesarea De aedificiis**, sidomos toponimeve të përmendura nga trevat e Dardanisë. Dhe këtë mund ta bëjmë me shpresën që edhe këto toponime do të pasqyrojnë po atë ndryshime fonetike si emrat e përveçëm dardanas e njohur nga monografia e Fanula Papazoglut. Ja, të nderuar kolegë dhe të dashur miq, kaq desha të ju them në lidhje me historinë e Dardanisë së lashtë dhe të popullit dardanas. Po le të vazhdojmë mbikqyrjen e historiografisë në shekujt a mesjetës. Në këtë periudhë zhgënjimi ynë i patë është vërejtja që **Shqiptarët paskan lindur shumë vonë!**

SHKENCA DHE KOSOVA

Gjatë këtyre vjetëve të fundit, me qëllim që t'u hartoja një tekst universitar studentëve hungarezë të cilët dëshirojnë të pasurohen edhe me njohuri nga fusha e albanologjisë dhe të ballkanistikës, m'u desh që të shfletoja dhe të lexoja me dhjetra monografi dhe me qindra studime dhe artikuj të autorëve të ndryshëm. Dhe me kalimin e kohës sa vinte po rritej habija ime duke vënë re se shumica e dijetarëve të vendeve të ndryshme e kanë lënë në heshtje shqipen dhe etnosin shqiptar, dhe kanë kapërcyer periudha të ndryshme të historisë pa i quajtur me emër shqiptarët ose pa përmendur anën përkatëse e një ngjarjeje e cila kishte lidhje të drejtpërdrejta me shqipen, me shqiptarët. Kam filluar të bëja shënime rreth këtyre "heshtjeve" të përsëritura dhe të pakuptueshme, duke vënë re njëkohësisht që kjo heshtje është edhe më e madhe rreth Kosovës, rreth shqiptarëve banorë të Dardanisë së lashtë. Teksti universitar, hartimin e të cilit e kam mbaruar nga fillimi i gushtit, shumicën e faqeve ua kushton ndërrimeve të shpeshta dhe të mëdha në paunjen etnike të Ballkanit që nga neoliiti deri te mbërritja e turqve osmanllit, dmth deri në gjysmën e dytë e shekullit 14. Kjo pjesë historiko-etnike zë gati gjysmën e dorëshkrimit. Pjesën e parë e librit e zënë përkimet gjuhësore, etnografike, mitologjike dhe zakone midis gjuhëve ballkanase, në vend të parë midis shqipes dhe rumanishtes, kurse pjesa e tretë merret me historinë e hipotezave rreth etnogjenezës së shqipes, të rumanishtes dhe të magdonishtes. Prandaj heshtjet e përmendura, këto jashtëlënje të padashura, por sidomos të dashura të shqiptarëve dhe të shqipes e karakterizojnë letërsinë e cila ka të bëjë me pjesën historike. Në shumicën dërmuese e rasteve të gjetura fajtori është autori i këtyre shkrimeve, ndonjë shkencëtar i huaj ballkanas ose nënshtetas i ndonjë vendi tjetër evropian ose edhe përtej oqeanit. Por për fat të keq ka edhe disa raste të rralla, në të cilat përgjegjësia i takon ndonjë hulumtuesi shqiptar.

Në përputhje me titullin e konferencës sonë do t'i përmendim në vend të parë ato raste në të cilat pala e cënuar është Kosova, a ose janë shqiptarët kosovarë. Le të fillojmë me antikën. Shoshitja arkeologjike e truallit

Po, të dashur miq, sipas dëshmisë së historiografisë moderne, populli shqiptar, shqiptarët as nuk janë lindur para themelimit të Principatës së Arbanonit!... Në një monografi të trashë, në dy vëllime, të historianit amerikan **John V. A. Fine junior**, të botuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (*The Early Medieval Balkans*, Michigan 1995 dhe *The Late Medieval Balkans*, Michigan 1999), monografi e ribotuar disa herë gjatë këtyre vjetëve të fundit, dmth në faqet e kësaj monografie lexojmë midis të tjerave që në shekullin 11, në qytetin e Dyrrachiumit paska pasur midis arhondëve të qytetit edhe *një vendas*, mirëpo me sa duket, - së paku në sytë e historianit amerikan John V. a. Fine Jr. - ai ishte një arhond pa emër dhe pa kombësi!... Po ky historian i përmend shqiptarët vetëm nga fundi i shekullit 12! Për sa i përket Dardanisë së lashtë në mesjetë, dmth Kosovës, edhe heshja e hualluesit amerikan është e plotë. Duke mbërritur te përfundimet e para negataive, kam filhar të kërkoja apostafat - në vepra të autorëve të ndryshëm - disa të dhëna konkrete nga toponimia mesjetare e Kosovës. Kot! Kështu bie fjala emri i qytetit të Pejës në mesjetë - **Ipek** - nuk njihet në asnjë burim i huaj, me gjithë që sipas mendimit tonë është një provë e vjetër e shkëlqyeshme e rritit romak të të krishterëve shqiptarë të kësaj treve. **Ipek** lidhet me formën e vjetër e huazimit nga latinishtja **episcopius > ipeshkv**, emër i cili është përdorur edhe nga mesi i shekullit të 18. (*Ioannikos, parikani i Ipekut, Atanasije, parikani i Ipekut*), emër i përmendur në studimin e sllavisit të njohur hungarez **László Hadrovics** (Lasio Hadrovic) mbi historinë e kishës autoqefale serbe, mbi gërshetimin e saj me shtetin serb dhe mbi rolin e saj kombëtar gjatë pushtimit turk, me titullin *Allam, egyház, nemzetudat* ('Fe, kishë, ndërgjegje kombëtare'), botuar në Budapest, në vitin 1991. Ky emër i vjetër i qytetit të Pejës ka një rëndësi të madhe në sqarimin e historisë së Kosovës në mesjetë. Ai provon, së pari, që qyteti i Ipekut ishte një qendër e kishës së krishterë të rritit perëndimor, përpara depërtimit të fesë ortodokse në këto treva pas skizmës tragjike e cila e ka ndarë fenë e krishterë në besimtarë të Romës nga njëra anë, dhe besimtarë të Konstantinopojës, nga ana tjetër. Po kjo te ortodokse ishte krishterizmi i Bizantit, *me liturgjinë greke (dhe aspak me liturgjinë sllave!)*, si na dëshmon një emër tjetër nga toponimia kosovare, **Metohija**. Emër me mbaresë karakteristike sllave, po prejardhja e tij është e te dukshme: ajo është një fjalë e greqishtes së mesme, bizantine me origjinë "prona e një manastiri me gjithë tokat, pemishtet dhe vreshtat e tij", nga greqishtja e vjetër me origjinë me kupimin 'Gemeinschaft, Teilnahme, Anteil, Mitbesitz'. Dmth përpara pushtimit serb të Kosovës veriperëndimore në këto treva ka pasur një manastir bizantin (grek!) nga prona et ë cilit gjithë krahina e ka marrë emrin e saj (para se krahina përkarëse u bë pronë e Dukagjinasve). Për sa i përket vendosjes së patrikanatit në qytetin e Ipekut kam gjetur një të

dhënë të papërmendur në asnjë monografi tjetër. Patrikani serb është vendosur në këtë qytet nga fundi i shekullit 13 dhe aspak në vitin 1253, vit i cili po përdoret si "datë tradicionale" e mbartjes së patrikanatit. Dhe këtë të dhënë të vlefshme dhe të rëndësishme na paraqit historiani gazetar i angliz Noel Malcolm në monografinë e tij **KOSOVO a Short Story**, London 1998. Disa qarqe hualluesish dhe gazetarësh së huaj e kanë paditur me një herë - natyrisht! - që autori gjoja do t'isht *filoshqiptari*! Nga po kjo monografi vëmë re se para transferimit të selisë së tij në territorin e Kosovës, selia ishte parashikuar që të vendosej në qendrën fetare të **Žičës**, ku **Stefan Prvovenčani** (Stefan, i Kurorëzuarit i Parë) ka themeluar një manastir, të cilën e ka zgjedhur i ardhmi Shën Sava vetë për qendër të patrikanatit të parashikuar. Mirëpo gjatë vjetëve 90 të po këtij shekulli - disa burime të huaja e caktojnë datën e këtij sulmi në vitin 1292! - tatarrët dhe kumanët e kanë djegur këtë manastir, prandaj mbreti **Miluin** ka zgjedhur një vend më të mbrojtur për patrikananin serb në qytetin e Ipekut. Kështu data tradicionale e transferimit të qendrës fetare (ku më para është mbledhur edhe një sinod i kishës serbe) është e rremë, sepse ai nuk ka ndodhur në vitin 1253, por nga fundi i po këtij shekulli (si e pranon edhe **S. Ćirković** në veprën e tij *Kosovo i Metohija u srednjem veku*). Mirëpo në lidhje me këtë duhet theksuar që pas rindërtimit të manastirit të Žičës, njihen dy patrikane të cilët e kanë kthyer selinë e patrikanatit në këtë qendër të mëparshme nga fundi i shekullit të ardhëm: patrikani **Spiridon** dhe pasardhësi i tij, patrikani **Danilo** (shih **D. S. Radović**) në studimin e tij *Izbor patrijarha Danila III i kanonizacija kneza Lazara*, in: *Glasnik skopskog nau-nog društva*). Dhe në lidhje me këtë lejohet një vërejtje miqësore. Në vitin 1999 është botuar në Tiranë, me kujdesjen e Institutit të Gjuhës dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave një vëllim interesant me titullin *Kosova në vështirë enciklopedik*. Unë e di dhe e kuptoj rëndësinë e këtij vëllimi, dhe sidomos arsyet e shpejtësisë së hartimit dhe redaktimit të tij. Me gjithë këtë është për të ardhur keq se në faqen 78 e këtij libri ku fliet për patrikananin serb e Pejës, nuk janë përmendur këto trehana historike të cilat kanë shkaktuar transferimin e qendrës fetare në qytetin kosovar, dhe nuk shënohet as emri i vjetër Ipek i qytetit.

Në lidhje me këtë monografi të Noel Malcolmit duhet nënvizuar që - me sa di unë - ai është i vetmi autor perëndimor i cili pranon që vetëm pas shekullit 13 dhe deri te shpërbëja e Serbisë së madhe të Dushanit të Madh, ndofta vetëm në këtë periudhë dhe kurë më parë, mund të fliet në Kosovë për një shumicë etnike serbe. Duke folur për Kosovën e mesjetës, për pushtimin kalimtar serb e këtyre trevave, lejohet, të ndëruar kolegë dhe të dashur miq, që të ju tregoj edhe një anekdotë. Një anekdotë për të geshur, mirë

po me një bazë historike, me gjithë që e heshur në historiografinë e disa vendeve. **Nemanjiđët**, pas pushtimit të zonës së minierave kosovare kanë punësuar minatorë gjermanë, me qindra saksonë nga Transilvania, për të rritur rendimentin e minierave, sidomos prodhimin e argjendit në minierat e Novobërdës. Duke parë sasinë gjithnjë më të madhe të argjendit, mbreti **Stefan Uroš Milutin** (1282-1321) paska vendosur të priste para, po për shkak se nuk ka pasur një njeshtër të posaçëm për ta gdhëndur kallëpin e domosdoshëm, ai e ka zgjedhur *grosson* e Venedikut, një monedhë të njohur dhe të pranuar të mesjetës, për ta imituar. Sipërmartja e mbretit monedhëpretes do të kishte dalë mirë po të mos kishte qenë ai një koprac i madh. Aia deshi të kursente sa më tepër argjend dhe kështu grossoja e tij kishte vetëm të shtatë të tetat të peshës së monedhës venedigase. Senati i Venedikut, pas protestimesh së përsëritura, e ka mallkuar zyrtarisht mbretin Milutin, i cili – përveç këtij mallkimi – është përjetësuar edhe në veprën e pavdekshme të poetit të madh italian, **Alighieri Dante** i cili e paska edhe ndëshkuar duke e vënë një heë e për gjithmonë në skëterrën e *Divina Comedias*, në katin e kallpazanëve të parastë...

Dhe tani, pas kësaj anekdote historike le të kthehemi te realiteti historik i cili nuk na jep asnjë arsye për të qeshur. Le të vazhdojmë përciptas mbikqyrjen e historisë mesjetare së këtyre trevave.

Ju e njihni mirë në historinë e shqiptarëve rolin e madh dhe të rëndësishëm të cilin e ka lojtur dinastia e **Balshajve**, pinjollët e së cilës kanë zgjeruar principatën e Shkodrës nga Budua në veri e deri në Himarë në jug. Këtu nuk ka asnjë rëndësi që këtë principatë disa historianë e quajnë Zetë. Ne duam që të ju tërheqim vëmendjen mbi faktin që historiografia serbe e ka paraqitur këtë dinasti sikur se do t'ishite me prejardhje serbe duke e quajtur Balshiq, dhe me sa duket jo vetëm me qëllim që "të lehtësohej lakimi i emrit të familjes" në kronikat serbe. Dhe kështu mund të lexojmë te ata Gjorgje Balshiq në vend të **Gjergj Balshës**. Është e vërtetë që një pinjol i familjes ka pasur emrin Strazimir, po Balshajt qenkan mbetur katolikë. Njihet edhe një sqarim tejër i emrit **Balscia** (sipas ortografisë italiane!), sipas të cilit familja do t'ishite pasardhëse e një libri të **Bertrand de Baux-it**, i cili e kishte shoqëruar mbretin **Charles d'Anjou** (1226-1285) në fushatën e këtij të fundit për të pushtuar Mbretërinë e Napolit. Po sipas hulumtuesit austriak **Gustav Weigand** ka gjetur në Raguzë një dokument, përkthimin e një origjinali nga qytei i Ballshit nga viti 1379, i cili dëshmon prejardhjen rumune e familjars, një familje e ikur nga trualli shqiptar duke marrë si emër të familjes emrin e qytetit të **Ballshit**. Këtë sqarim e vërteton edhe

hulumtuesi rumun **Teodor Filipescu** në monografinë e tij të hartuar fare, *Colonille române din Bosnia* (dmth. Kolonitë rumune në Bosnjë), Bukuresht 1906, i cili na provon që familja ishte me prejardhje shqiptaro-rumune. Ky autor rumun është një prej hulumtuesve të rrallë të huaj i cili e përdor në mënyrë konsekvante emrin Ipek e qytetit të Pejës duke folur për shpërnguljet e mëdha e vllëhëve të Shqipërisë, sidomos gjatë Luftës së Skënderbeut kundër Brankoviqit, duke nënvizuar që mjaft shqiptaro-rumunë janë bërë ndërtues të famshëm të mesjetës jo vetëm në Serbi dhe në Bulgari, por edhe në Konstantinopojë. Sipas mendimit tonë të dy qjentë e themeluesit të dinastisë së Balshajve, Gjergji dhe Balsha i II, si kujtim dhe mirënjohje ndaj qytetit shqiptar (i cili mund të ketë qenë djepi i familjes së tyre), kanë bërë një dhuratë të çmueshme manastirit të këtij qyteti, një epitaf të madh të qendësuar me mëndafsh dhe të stolisur me pllaka prej ari dhe argjendi, i cili njihet sot me emrin e *epitafit të Gllavinicës*. Kjo vepër e mrekullueshme e qëndistarisë shqiptare mesjetare e bërë në vitin 1373 është një provë e lidhjes së ngushtë të Balshajve me truallin e stërgjyshëve të tyre.

Për sa i përket mesjetës, ka edhe disa ngjarje të tjera në të cilat ende nuk është sqaruar pjesëmartja e kosovarëve. E kemi fjalën te luftërat e fundit e popujve të krishterë ballkanas për t'i bërë ballë pushtimit turk të vendeve të tyre. Kënga e luftës së Kosovës në vitin 1389, e cila është mbledhur në Vushitër, është një këngë epike popullore, ja e krijuar më vonë, ja e islamizuar më vonë me përhapjen e fesë myslimane ndër shqiptarë. Po ne na interesojnë të dhënat historike, sepse një gjë është dhe do të mbetet e padikutueshme: pasardhësit e dardanëve të pamposhtur nuk ua kanë dhënë falas atdheun e tyre të lashtë pushtuese osmanë. Epika popullore shqiptare në përgjithësi na tregon që pushtimi turk nuk i ka gjujgëzuar kurrë matësorët shqiptarë, as në anën e këndejmë, as matanë Bjeshkëve të nemuna. Mirë po duhen kërkuar edhe të dhënat dhe provat konkrete. Po ashtu duhen kërkuar të dhënat konkrete e pjesmarjes së shqiptarëve, e fiseve kosovare në kuvendet e ndryshme ndërballkanase, në këto përplekje historike të pandërprera kundër pushtimit turk dhe për të fituar lirinë e humbur. Një formë e gjere e protestës dhe të rezistencës kundër pushtimit turk e përfaqësonin të ashtuquajturit *laramanë*, shqiptarët kosovarë të cilët – për t'u shpëtuar nga ispenxha sa vinte më e rëndë – e kanë pranuar sa për sy e faqe fenë myslimane, por në të fshehtë ushtronin më tuije fenë e tyre e krishterë. Kjo formë e qëndresës së shqiptarëve kosovarë, laramanizmi i tyre masiv, ka marrë për-pjestime aq të gjera (sidomos kur ispenxha ka rritur deri 26 groshtë në një vit – dmth afërsisht deri giminin e një dashi!), që administratës ushtarake turke iu desh që të ndërhynte me dhunë, me mjete brutale kundër tyre. Ju them haplas që nuk kam gjetur shumë të dhëna për këtë formë të protestës, me

përfashim të acarimit të marrëdhënieve të pushtesit me Këlmendasit. Të dy fjalorët e akademisë së Shkencave – ai i vitit 1980 dhe ai ai vitit 1984 – nuk përmendin këtë kupim historik të fjalës *laraman*, bile përsa i përket fjalës *laramanizëm*, kjo mungon nga të dy fjalorët. Cilat janë shkaqet dhe fazat e ndryshme e qëndresës së shqiptarëve të Prizrenit, të Gjilanit (pa harruar as shqiptarët katolikë e Shkupit!), bie fjala, të cilët e paskan ruajtur fenë e tyre e lashtë katolike. As Stefan Dushani s'i ka gjetur mjetet për t'ua imponuar fenë ortodokse, as turqit për të përhapur në radhët e tyre fenë myslimane. Të mos harrojmë që përveç gjuhës së përbashkët edhe feja e krishterë, konkretisht feja e krishterë e rrit latin është dëshmia e dytë e rëndësishme e unitetit të etnosit shqiptar i cili e ka marrë bashkarisht fenë e re qysh në shekujt e parë pas lindjes së Krishtit edhe në Shqipërinë e sotme Veriore, edhe në Kosovën e ditëve tona. Ndajia më dysh e Perandorisë Romake, pastaj më vonë rivalizimi sa vinte më i hapur midis Romës dhe Konstantinopojës i kanë ndarë edhe masat e shqiptarëve, por me gjithë këtë feja e vjetër katolike nuk është zhdukur kurrë nga trevat e përmendura të Kosovës.

Të nderuar kolegë! Të dashur miq! Kam prekur këtu shkurtimisht vetëm disa çështje, disa prej problemeve më të rëndësishme, sqarimi dhe zgjidhja e të cilave e pret dhe e kërkon punën e shumë hulumtuesve, bile pret dhe kërkon një bashkpunim ndërkombëtar. Le të mendojmë pak: ç'farë njohurish ka bota përmbi Kosovën, përmbi ju, shqiptarë kosovarë? Nga fundi i shekullit 19 intelektualët e botës perëndimore e kanë pranuar deklaratën e re me dhe revoluese e Bismarkut që Shqipëria gjoja do t'ishite "vetëm një nocion gjeografik". E kanë pranuar sepe nuk dinin asgjë mbi historinë mijëvjeçare dhe mbi luftërat e pandërprera e shqiptarëve për liri dhe pavarësi. Dhe diplomatët ndërkombëtarë e kanë copëtuar pa mëshirë këtë "nacion", trupin e gjallë e një kombi, e kombit më të vjetër ballkanas. Ju lutem, mos më keqkuptoni, e kam hedhur poshtë gjithmonë idenë e fuqjes së politikës në shkencë. Por përhapja e të dhënave historike të së kaluarës të një kombi nuk është politike. Është hapja e syve të atyre të cilët duan të mësojnë të vërtetën, të vërtetën mbi popullin shqiptar, dhe në këtë rast konkret të vërtetën mbi popullin shqiptar e Kosovës. Dhe çdo përpjekje e bërë në këtë drejtim është e frytshme. Në lidhje me këtë mund të ju tregojë edhe një përvojë personale. Para disa vjetëve kam botuar në vjetarin e Bibliotekës qendrore universitare të Budapesit një studim më të gjatë me titullin *Kosova e panjohur*. Studimi ka pasur një jehonë të papritur. Intelektualë, të diplomuar, të njohur dhe miq, por edhe të panjohur më kanë telefonuar ose më kanë kërkuar në fakultet për të më përgëzuar dhe për të bërë pyetje të mëtejshme. Studimi, në sytë e tyre e verbuar më parë nga

propaganda e Millosheviqit, u duk si një revelacion, si zbulimi i papritur i disa të dhënave të pamohueshme. Kjo përvojë më ka bindur që të vij në këtë Seminar, midis jush, me një nisme të jashtëzakonshme. Ju ftoj, ju të gjithë, le të jeni shqiptarë ose nënshietas të vendeve të tjera, të fillojmë qysh sot një bashkpunim të gjërë për zbulimin e hollësishëm e së vërtetës historike mbi Kosovën. Le të zgjidhë secili prej nesh nga një temë hulumtimi për t'u kthyer sot një vit në Prishtinë me nga një kumtesë ose studim të mbaruar, për t'i mbledhur në një vëllim të posaçëm, duke dhënë kështu ndihmesën tonë modeste për zbulimin dhe përhapjen e së vërtetës mbi të kaluarën dhe mbi popullin e Kosovës. Redaktorët e vëllimit le të kenë edhe mundësinë që të mbledhin në vëllimin e ardhshëm edhe studimet dhe artikujt, edhe konferencat më të mira të botuara ose të mbajtura gjer më sot, sepe këtu në Prishtinë hulumtuesit tuaj kanë bërë një punë të frytshme, duke shkruar një artikul dhe studime, por të shpërndara në botimet më të ndryshme. Ndofia do të kemi edhe bashkpunimin e një dëshmori të hulumtimeve albanologjike, kontributin e **Milan Šufflayit**, vëllimi i tretë i dorëshkrimit të historisë së të cilit është zbuluar në kohët e fundit në Tiranë. Jam i bindur se Drejtoria e Seminarit është në nivelin e duhur shkencor për të marrë përsipër planifikimin dhe redaktimin e domosdoshëm, kurse ne, me fuqi dhe me zell djaloshtar, t'i përvishemi punës. Ju falënderoj! Dhe punë të mbarë, të nderuar kolegë dhe të dashur miq!

SHQIPJA STANDARDE PAS TRI DEKADASH

Këtu sot dua të merrem me disa çështje që lidhen me temën themelore: Shqipja standarde pas tri dekadash.

1. Në fillim dua të flas për çështjen: si u krijua shqipja standarde?
2. Pastaj: cilat ishin implikimet e standardit të tillë?
3. Elementet strukturore që e bëjnë dinamik standartin e shqipes: në fonetikë, në gramatikë dhe në leksik.
4. Rrugët dhe shkalla e përvetësimit të shqipes standarde në mëdise të ndryshme.
5. Hapësirat e përdorimit të shqipes standarde sot.
6. Problemet.
7. Kontestimet.
8. Perspektivat.

Koncepti i instrumentalit për gjuhën dhe planifikimin e saj ka qenë i njohur dhe ka vepruar në traditën e politikës gjuhësore shqiptare gjithashtu. Sipas tij, gjuhët janë në radhë të parë mjete komunikimi. Dhe kjo është një prej të vërtetave gjerësisht të pranura. Aspektet e tjera, ndërkaq, edhe nëse njihen, shpesh ndodh të neglizhohen dhe këtu nisin problemet. Në gjendjen e tyre të natyrshme, pandehet më tej, gjuhët janë të panjafueshme dhe të papërsosura. Prandaj, planifikimi gjuhësor synon përmirësimin drejt një ideali të karakterizuar nga hamendësimet e ngritura në rrëshkonceptesh me vlerë të pretenduar precize, si *efikasiteti*, *njësia* dhe *bukuria*, si shyllat kryesore të shprehjes. Është e qartë se konceptet e tilla nuk kanë saktësi të vetvetishme, prandaj, nëse nuk saktësohen, mund të shërbejnë për mbulesa dhe mistifikime nga më të ndryshmet, mund të bëhen ideologema.

Konceptimet e tilla, gjithë duke u mbështetur vetë në elemente relative dhe me vlerë vëshirë të përcaktueshme simbolike, shpesh shpërngojn vlera të tjera të mundshme dhe të rëndësishme simbolike të një gjuhe apo të një idioime, të cilat mund të lidhen me çështje si solidariteti i grupit, identiteti, etj. Paralelisht me konceptimet e tilla, shpesh besohet se mendimet e

kundërta lidhur me mënyrën konkrete të përmirësimit dhe të rirregullimit të statusit të gjuhës mund të ndryshohen përmes propagandës dhe autoritetit politik.

Këtu dua t'i drejtohem më parë konceptimit sociolingvistik, i cili, në diskutimet për çështje të planifikimit dhe të ndryshimit gjuhësor, e thekson kontekstin shoqëror dhe simbolik të përdorimit të gjuhëve. Kjo më bën që qysh në fillim të pyes: **ç'është shqipja sot dhe si të jipet një përgjigje shkencore për këtë çështje?** Shqipja sot, me siguri do të pajtohen shumë prej jush, është një realitet kompleks, shumështrësor, më hapësira të ndryshme të përdorimit të kodeve dhe të sistemeve të ndryshme ekzistuese brenda saj, me vlera dhe role të ndryshme shoqërore, me lidhje të shumanshme me gjuhët përreth, sociolingvistike dhe të tjera. Përtej përgjithësirave të këtuja, mbetet që përgjigja të jipet mbi bazë të hulumtimeve empirike, goftë për çështjet e mësipërme, goftë për raportet midis dialekteve dhe gjuhës standarde.

Mbase e vlen të rikujtohen elementet e situatave në dy vende me traditë të gjatë, sa për krahasime sugjeruese.

Në Angli, 'dialektet', të cilat ndryshojnë nga standardi në fonologji, në gramatikë dhe në leksik, janë në zhdukje e sipër. Nuk ka dyshim se edhe anglishtja standarde flitet me theks të ndryshëm, varësisht nga rajoni. Por ekziston RP si model, kështuqë theksimet e ndryshme lidhen dhe me statusin shoqëror të folësve, ato nuk janë më dialekte.

Në Itali, ndërkaq, puna qëndron ndryshe. Aty dialektet ndryshojnë midis tyre aq shumë, ashtu si dhe nga gjuhja standarde, sa shpesh folësit e dialekteve të ndryshme nuk merren vesh midis tyre, thotë G. Lepschy. Dallimet midis dy dialekteve mund të jenë si midis spanjishtes e frëngjishtes, portugjishtes e rumanishtes apo italishtes e anglishtes, pohon ai. Por të gjitha burojnë nga latinishtja dhe kanë lidhje me gjuhën letrare. Aty gjithkush flet me një theks regional. Të flasësh pa theks, mendon Lepschy, nuk është indikator shoqëror, po thjesht një kufizim deklamaror. Kjo do të thotë se italishtja lidhet disi me shtrëat e larta të shoqërisë, më shumë, ndërsa dialekti me shtrëat e ulëta. Megjithatë, mbetet hapësirë për shpjegimin e mëtejshëm të koncepteve 'italishte' dhe 'dialekt'. Gjithçkani tjetër i rëndësishëm italian G. B. Pellegrini, në pjesët më të mëdha të Italisë, dallon 4 shtresa gjuhësore:

- a. italishte Standarde
- b. dialekt lokal
- c. formë vendore centripetale e italishtes – italishte regionale
- d. formë centrifugale, e përhapur, e dialektit – dialekti regional.

Dhe dallimet nuk janë gjithëherë të prera, ka shkallëzim. Në fshat dialekti dallon nga forma regionale, ndërsa në qytet, në Veri, dialekti dhe forma regionale shkrihen. Familjarja, e afërta shpesh shprehen në dialekt, ndërsa precizia, formalja – në standard. Pra kemi kontinuum. Italishtja nuk ka pandan të RP të anglishtes. Shqipërimi i të mësuarve nuk është i njësishtëm, ndryshon sipas vendit: në çdo regjion ai është më i afër me shqipërimin e të pamësuarve se me shqipërimin e të mësuarve të regjioneve të tjera. Ruajtja e theksit lokal në italishten konsiderohet normale dhe kjo nuk e bën italishten njëjtë me të keq të komunikimit. Po të pyetesh Lepschy cili varietet i italishtes të mësohet, do të thoshte: ka më shumë përgjigje.

Këtë kompleksitet e shtojnë dhe më tepër specifika e gjuhës së letërsisë, të burokracisë, të politikës, të gazetarisë, të reklamës, të shkencës, të kishës, etj. Shtypi, tv synojnë një publik më të gjerë. Kështu ka huazime në gjuhën e përbashkët nga përdorime të shpeshta në sport, reklama. Ndodh që folës të dialekteve vetëm për sport të përdorin terma të italishtes.

Si është gjendja në shqipen?

*

Të gjithë e dinë se proceset e planifikimit gjuhësor të shqipes janë të hershme dhe komplekse (shih kronologjinë). Megjithatë, hapat më vendimtarë drejt standardizimit janë bërë pas Luftës II Botërore, kohë kur çështja në tërësi mori përshpejtim. Ishte kjo koha kur hapësirat e gjuhës shqipe dominoheshin nga tipi dirigjist i organizimit shoqëror, prandaj dhe nga një politikë dirigjiste e gjuhës. Ndër detyrat me rëndësi që lidheshin me gjuhën letrare ishte dhe alfabetizimi i popullatës: ky proces kompleks shoqëror, duke krijuar legjitimitetin e veprimeve në shkallë gjithëshoqërore, e lehtësonte, në njëfarë dore, ndërmarrjen e madhe të ngulitjes së normave të projektuar.

Qysh prej sh. 16 shqipja është shkruar dhe vazhdimisht elaboruar në formën e dy varianteve të përgjithshme – gegë dhe toskë, të mbështetura në dialektet përkatëse. Nga viti 1923 deri më 1945 varianti gegë ishte gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar. Pastaj ka pasur zhvillime të ndryshme. Mirëpo kjo nuk kishte implikime serioze në fushat e gjera të përdorimit të shqipes me synim standardizimi as brenda shtetit, jo më në diasporë. Aspektet e përdorimit të gjuhës letrare, si letërsia, publicistika, etj., thuaja se nuk prekeshin fare, kështuqë zhvillimi paralel i varianteve mbi dy baza ishte krejtësisht i lirë. Sundimi i Zogut nuk shoqërohej me dirigjizmin si orientim themelor në shoqëri, sidomos jo në gjuhë. Atë e solli periudha komuniste.

*

Këtu do të flas më shumë për situatën në ish-Jugosllavi.

Përvoja e para të përdorimit të shqipes në një hapësirë ku zakonisht kërkohet një gjuhë "e kultivuar" dhe "e elaboruar", nëse lëmë anash traditën e largët të Pjetër Buditi e të Pjetër Bogdanit, ashtu si dhe manifestimet në shkrim të Ndue Bytycit, të Shijefën Gjegovit e të tjerëve, nis me shkollat private krejtësisht të pakta nga fundi i sh. 19 dhe pak më të shtuara në pak vitet e dekadave II-III të sh. XX. Shuarja e tyre nga shteti serb/jugosllav nuk la hapësirë të tillë deri në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, kur një pjesë e madhe e Kosovës u bashkua me Shqipërinë nën Itali. Në këto vite u hapën shkollat fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe dhe, natyrisht, me gëgëritshen zyrtare të Shqipërisë si gjuhë e shkruar dhe e folur. Karakteri jo deri në fund i elaboruar i normave të kësaj gjuhë letrare, që për bazë kishte elbasanishten, por që në vete përmbante elemente shumë më të gjera gëge, bënte të mundshme mbindërtime jo të vogla nga tradita e shkruar shkodrane e tjetër, interferenca nga toskëritshja, inkuadrimet pa pengesa të "kosovarizimeve", etj.

Në periudhën pas Luftës II Botërore, përkatësisht nga viti 1952, në Kosovë u punua në të dy drejtëmet e planifikimit të gjuhës: në drejtim të zgjedhjes së korpusit dhe në drejtim të planifikimit të statusit të shqipes. Si pika më rëndësi duan veçuar tri Mbledhjet e mbajtura në Prishtinë më 1952, më 1957 dhe më 1963.

Në Mbledhjen e vitit 1952, të mbajtur me organizim të pushtetit krahinor arsimor, u morën vendime në rrafshin e zgjedhjes së kodit në kuadër të asaj që quhej 'variant gëgë' i shqipes letrare, pra një gëgëritshe e përgjithshme, gjithë duke refuzuar variantet që quheshin 'shkodranisht' apo 'elbasanisht' dhe duke mos përfillur çfarëdo ideje për krijimin e një 'varianti kosovar'. Sa u përket resurseve leksikore, u afirmua parimi i barazisë së të gjitha fjalëve, pa marrë parasysh prejardhjen dialektore. U kërkuua hartimi i gramatikave dhe i fjalorëve dhe botimi i një organi të veçantë për gjuhën dhe kulturën e saj. Në rrafshin e statusit gjithashtu u theksuan dy gjëra: paralelizmi me riafirmimin e gëgëritshes si gjuhë letrare për shqiptarët e Jugosllavisë, kërkohet një poziti më e avancuar në kuadër të ofcialitetit dhe të përdorimeve publike të shqipes. Shkurt, në vitet '50 në Kosovë dhe në Jugosllavi bëhej një politikë vendore e gjuhës në dy rrafshet: të zgjedhjes së korpusit dhe të planifikimit të statusit. E gjithë kjo nudohte në një situatë komplekse politike dhe statusore të shqiptarëve në kuadër të shtetit multietnik, por të centralizuar, të Jugosllavisë.

Më 1957, pas një rënjeje të intensitetit që karakterizoi vitet 1952-53 (trysnitë ishin manifestuar në formë shtrëngimesh për shpërngulje në Turqi, për mbyllje të Institutit Albanologjik dhe të institucioneve kulturore, të përzënies së

intelektualëve të shquar, të përndjekjeve dhe represaljeve ekstreme), sipas mendimit tim, ka pasur reflekshe për të shkuar prapa drejt një varianti të mundshëm, por të refuzuar qysh më 1952, të kosovarishes. Në favor të legjimitimit të një varianti kosovar përdorej gjërësisht argumenti i parqitjes besnike të gjuhës së folur, çka në të gjitha variantet mund të jete fare mirë një mtl. Mbulësia kryesore për një rikthim të tillë ishte kërkesa për heqjen nga përdorimi i shumë ë-ve "të pa-nevojshme". E qartë, kjo krijonte nevoja të tjera në korpus: përdorimin e theksave dhe lente pasoja në dukjen e fjalës. Ndryshimet mund të shpinin larg, po të radikalizoheshin.

Nga ana tjetër, tani sikur po nxirrte krye ajo që quaj "sindrom magedonas", pra, tendencat e qarqeve serbe që synonin diferencimin e *gjuhës shipe* (šiptarski) për kosovarët dhe shqiptarët e ish-Jugosllavisë nga *gjuha shqipe* (Albanski) për shqiptarët e Shqipërisë, gjë që ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e ndjenjës së kërcënimit të identitetit. Reagimi i pritur ishte forcimi i aktiviteteve në rrafshin e luftës për gjuhën, për statusin e saj. Tendencat e tilla në Serbi nuk kanë pushuar kurrë, siç mund të shihet në *Memorandumin* e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve të vitit 1986, ku shprehej keqardhje që iu lejua shqiptarëve ta njehsonin gjuhën e tyre. Duke bërë fjalë për padrejtësitë të cilat autorët e *Memorandumit* kujtojnë se i janë bërë popullit serb, posaçërisht në Kosovë, nga politika e përgjithshme dhe nga shqiptarët, ata kanë vënë dhe këtë vlerësim:

"Marrëdhëniet e barabarta nacionale, për të cilat edhe në Kosovë e Metohi më së shumti kanë luftuar pikërisht luftëtarët serbë – me një politikë krejtësisht të përcaktuar, të zbatuar 'në zhvillim', me vepërime të planifikuara dhe me qëllim të qartë – nacionalistët shqiptarë në udhëheqjen politike të Kosovës filluan t'i kthenin në të kundërtën e tyre. Regjioni autonom (Autonoma oblast) në një moment të përshatshëm mori rangun e Krahinës autonome (Autonoma pokrajina)¹, pastaj edhe statusin e 'njësisë konstitutive të federatës' – me prerogativa më të mëdha se pjesa tjetër e Republikës, së cilës i përket vetëm formalisht. Hapi tjetër drejt 'përkallëzimit', që u shtaq ashtu si dhe albanizimi i Kosovës e Metohisë, është përgatitur, pra, në mënyrën më legale. Po ashtu edhe unifikimi i gjuhës letrare, i emrit komëtar, i flamurit, i teksteve – sipas instruksioneve nga Tirana – u

¹ Në Kushtetutat pas Luftës II Botërore, ndryshe nga Vojvodina që përcaktohej si *Autonoma Pokrajina* (Krahinë autonome), Kosova përcaktohej si *Autonoma oblast*. Kjo atëherë përkthehej si *Krahinë*, por dallimi midis *oblast* dhe *pokrajina* kishte vlerë konkrete juridike kushtetuese: *oblast* ishte e një niveli më të ulët se *pokrajina*. Kosova u bë *Pokrajina* me Kushtetutën e vitit 1963.

bë krijësisht hapur, ashtu siç ishte i hapur kufiri midis dy territoreve shtetërore, ndër të tjera”.²

Natyrisht, formulimi i kësaj në rrethanat e atëhershme synonte motivimin dhe prodhimin e ndëshkimit ndaj një trupi shoqëror, e, si kërcënim kolektiv, mbyllje hapësirës e veprimi të individëve. Shumica e pohimeve të tilla shprehin një prapavijë të theksuar ksenofobike: nga elementet që janë theksuar si e vërtetë qëndron vetëm unifilimi i gjuhës; emri kombëtar pushuese serbe; flamuri i njëjtë dhe diferencimi shpreh vetëm ambicet pushuese serbe; flamuri nuk është unifiluar në këtë kohë, ai gjithmonë ka qenë flamuri i kombit, ndërsa ylli si shtesë, pavarësisht nga vendi ku vihej, është pasojë e përvetësimeve të së njëjtës natyrë ideologjike të kombit në të dy anët e kufirit.

*

Në fillim të viteve '60 në Prishtinë u ndërmor një nismë e gjerë e standardizimit që rezultoi me krijimin e drejtshkrimit të fundit, më të plotit të gëgjësishtes. Në rrethanat kur kontaktet me gjysmën tjetër shqiptare ishin përfashuar, ky drejtshkrim u përfatua gjerësisht.³

Ndëryshimet e vitit 1966 bënë të mundur çlirimin e energjive të mëdha ndër shqiptarë të Jugosllavisë. Intelktualët e kësaj kohe ngulnin këmbë që një pjesë të mirë të këtyre energjive ta përdornin drejt triqes së ndjeshë së identitetit, gjithë duke kërkuar komunikimin deri atëherë të mohuar fare me Shqipërinë.⁴ Kjo solli nevojën për afrime gjuhësore dhe kështu lindi edhe slogan: “një popull – një gjuhë letrare”. Afimet në fushën gjuhësore shpeshin si thelbësore në këtë drejtim. Kështu më 1968 në Konsullën Gjithësore të Prishtinës u braktis praktika e standardizimit që ndiqej më parë në rrafshin e zgjedhjes së korpusit e kuro-rëzuar me *Ortografinë* e vitit 1964. Përmes gjuhës po theksohej identiteti, pra edhe dallimi nga të tjerët në Jugosllavi (që domethënë Sllavi e Jugut). Ishte e qartë se po mbsundonin aspektet e luftës për vlera simbolike, sepse po dillej, ndo-shita, nga një fazë serioze e kërcënimit të identitetit. Këtu, pra, bëhej “luftë për gjuhën”, ndërsa në Shqipëri më parë “luftë në gjuhë”.⁵

Në këtë luftë vetëm për statusin e gjuhës në raport me identitetin kombëtar, që për një moment bëri të neglizhohej çështja e korpusit, ose të

² *Memorandum SANU*, 1989, 33(1-2), 128-163, këtu 154.

³ *Ortografia e gjuhës shqipe*, (1964), 66. Cf. Ismajli (1998).

⁴ Kjo gjë nuk ka mbetur pa u hetuar. Shtih letrën që i drejtonte F. Agani Komitetit Krahinor dhe Kuvendit Krahinor të Kosovës më 24. 10 1969. Agani (2002), 377. Aty thuhet edhe: „Nuk mund të ketë zhvillim krijësisht normal kulturor të kombësisë shqiptare në Jugosllavi pa marrëdhënie relativisht të mira kulturore me Shqipërinë”.

⁵ Ismajli (1998). Teorikisht koncepti është elaboruar te Williams (1992), 123-147.

libej si e dorës së dytë, si gjuhë e vetme letrare u pranua ajo që ishte paraqitur si Projekt i rregullave të drejtshkrimit më 1967 në Tiranë, pavarësisht nga fakti se bazohet në variantin tosk. Planifikimi i statusit ishte avancuar në rrafshin e theksimit të njësisë kombëtare njësoj si në relacion me gjuhët e tjera të ish-Jugosllavisë në rrafsh të standardizimit si etalon. Në rrafshin e zgjedhjes së kodit, përtej traditës dhe rrethanave komplekse, u favorizua importimi i standardit. Aspektet e luftës për vlerat simbolike, për identitetin e kërcënuar kombëtar, peshonin më shumë. E gjithë kjo ndodhte në rrethanat kur breza të tërë kishin bërë shkollë serbisht, me etalon serbokroat të standardit, me orientime të ndryshme vlerore, me shkallë të ndryshme abstraksioni në të shprehur, me distanca të ndryshme të standardit ndaj idiomit natyror dhe me ndikime ekseseive të serbishtes mbi shqipen, të cilat ndikime mbështeteshin në statusin e serbishtes si *gjuhë e shtetit* në fillim dhe *lingua franca* e Jugosllavisë më vonë: gjuhë e federatës, e punëve të zgjedhura, e elitave, e armatës, e policisë, e pushtetit dhe e medimeve të fuqishme. A ka nevojë të shohet se kthesat e këtyra kanë mundur të ndodhnin vetëm pas ankthëve të mëdha të shkaktuara nga represioni i përsëritur i dy dekadave të fundit pas atij që kishin përjetuar brezat e pjesës së parë të shekullit?

Në Shqipëri gjendja ishte e ndryshme dhe përkundrazi e ndërlikuar për zhvillime normale në këtë fushë. Ishin bërë ndryshime largvajtëse në situatën e shtrësimit shoqëror dhe ekonomik të mëparmë të popullatës, dhe të gjitha këto po bëheshin mbi bazë të trysnive ideologjike dhe shtetërore. Pabluueshëm po krijoheshin shtrësime të reja me mbështetje nga më të ndryshmet, përfshirë dhe krahinoret. Kishte filluar faza e zbatimit të ideve të Revolucionit kulturor. Ishte ndaluar veprimtaria e institucioneve religjioze, shipyi ishte gjerësisht i dirigjuar, kontrollimi i qarkullimit dhe i vetë gjenerimit të ideve synonte një shkallë shumë të lartë.

*

Pasi kishte mbaruar gjimnazin, brezi im, që deri atëherë kishte nxënë një gëgjërishte letrare, nuk them të standardizuar, por të kultivuar dhe të elaboruar, filloi të nxinte një gjuhë të re me synime standardi, madje në rrethanat të mungësës së kontakteve me versionin e folur, pos në radio, pra, në distancë. Megjithatë entuziazmin që të flitej gjuha e Shqipërisë, pra gjuha që do të na bashkonte, situatat e përdorimit të gjuhës së njëzuar letrare shenjtësoheshin si specifikë. Dhe për ndonjërin që e fliste, ose përpigjej ta fliste në situata të bisedës së zakonshme, për shkak të shkallës së lartë të dallimit nga e kultivuarja e mëparme dhe, për pasojë, të artificialitetit dhe të pashtatësisë, për shkak të zotërimit të mangët, si me shaka thuhet se i tilli/e tilla po fliste “gjuhën e asfaltuar”. Kjo gjuhë “e asfaltuar” pushonte hapësira, sidomos në shkrim, por

edhe në të folur në situatat formale, ato që Ch. Ferguson i quante *High*. Për situatat e tjera rezervohet ajo që quhej “gëgnishte letrare”, e ndryshme nga gëgjërishtja dialektore për dimensionin e kultivimit, të normimit dhe të shtrijës shumë më të gjerë se ‘kosovarishtja’, e cila kishte gjithashtu shumë hapësirë në strukturat e atëhershme sociale, pra në popullatën mbisunduese tshatare. Natyrisht, kalimi nga gëgjërishtja thjesht dialektore në gëgjërishten letrare ishte shumë më i lehtë, jo vetëm për shkak të shkollimit të deriatëhershëm, po edhe për shkak të distancës më të vogël midis dy varieteteve, sesa në raport me gëgjërishten dhe toskërishten (letrare ose jo).

*

Megjithatë shumë probleme të standardizimit në rrafshin e zgjedhjes së kodit dalin në fushën e paraqitjes së strukturës fonematike të gjuhës në rrafshin drejtshkrimor – ndërsa drejtshkrimi i shqipes paraqitet i mbështetur fonetikisht, këtu e tutje dua të merrem me këtë çështje pak më shumë. Në sistemin bashkëtingëllor të shqipes standarde kemi një bërthamë ndërlidhore me katër radhë:

mbylltore	të shpurchëta	p	t	ts	Tš	c	k
të zëshme	b	d	dz	dž	f	g	
fërkimore	të shurchëta	f	θ	s	š	-	h
të zëshme	v	ð	z	ž	j		
Hundore	m	n	-	-	η	-	
anësore		l	L				
dridhëse		r					
	R						

Anësoret dhe dridhëset, por edhe **j** dhe **h**, në këtë sistem ndërldhish nuk janë plotësisht të integruara, kështuqë krijojnë një sistem joqendror.

Kështu sistemi aktual i shqipes standarde ka vendosur maksimumin e njësisë bashkëtingëllore.

- **uj** fundore reduktohet në **j** në shumicën e idiomave gëgje dhe, po të ishte zgjedhur si tipar, do të shkaktohte probleme lidhur me formimin e shumësit dhe të formave të foljeve.

- Kundërvënja **r/R** nuk ekziston më në shumë të folme toske, por as në disa të folme gëgje; megjithatë, dallimi përmes këtij tipari i një grupi fjalësh të përdorura shpesh ishte baza për zgjedhjen e tij si tipar të shqipes standarde.

- Në bazë të tipareve fonetike “e vazhdueshme/ e ndërprerë”, kundërvënja **L/** në shumë të folme gëgje veriperëndimore neutralizohet;
- **h**, **L** dhe **j** kanë pësuar zhvillime të mëtejme drejt **j**, **h**, **hj**, **gl** sidomos tek arbëreshët.

Neutralizimi i kundërvënies *e zëshme/ e shurchët* në fund të fjalës nu është vetëm tipar i toskërishtes, siç është menduar shpesh, por del edhe në ndonjë të folme gëgje. Në shqipen standarde ky neutralizim është injoruar.

Sistemi, prandaj, është në lëvizje të përhershme në pikat vijuese:

- Në shumicën e të folmeve të gëgjërishtes verilindore nuk bëhet dallim midis qiejllzoreve dhe paraqiejllzoreve **q**, **gj/gj**, **xh**;
- Në disa të folme gëgje grupet bashkëtingëllore **nd**, **mb**, **ng** funksionojnë si një fonemë e vetme [n, m, ŋ]; normimi i kësaj vegorie do të kishin krijuar ndryshime largvajtëse në tërë sistemin, sepse fjala është për një çështje distribucionale, kështuqë do të krijohejshin komplikime të reja për morfologjinë dhe fjalëformimin;

Së treti, si pikë e lëvizjeve dalin anësoret dhe dridhëset e paintegruara r sistemin ndërldhish.

Ndryshimet e sipërpërmendura do të kishin krijuar një sistem me 2 radhë bashkëtingëlloresh hundore dhe një radhë të vetme paraqiejllzoresh. Kjo do të kishte qenë e mundur, por do të shkaktohte komplikime të mëdha për bartësit sistemeve të tjera, gëgje e toskë.

Këto lëvizje, ky dinamizëm i sistemit, ndër të tjera, lidhet edhe r ngarkesën e madhe të hapësirës së shpirtit me njëjtë me njëjtë të ndryshim përveç majejllzoreve **c**, **x**, **s**, **z**, kemi alveolaret paraqiejllzore **ç**, **xh**, qiejllzor **q**, **gj**, velaret **k**, **g**, pasvelaren **h**. Kështu fusha e dispersionit të fonemave të këtyre zvogëlohet ndjeshëm, ndërsa rendimenti funksional i dallimeve mid fonerave konkrete jo gjithëherë i rëndësishëm.

*

Shqipja e njëzuar letrare, pra, shqipja e solme standarde, në sistemin zanoreve ka zgjedhur minimumin e tipareve dhe të fonemave të mundshme, duh i dhënë zanores *e* funksione të ndryshme dhe të shumta, për të përmblusht kështu një pjesë të funksioneve të gjatësisë së zanoreve dhe elemente të tjera. Në sistemin e zanoreve gëgjërishtja, me gjatësitë e saj funksionale të zanoreve di me numrin e madh të zanoreve hundore, paraqet një nga varietetet më begatshme në këtë fushë në Evropë.

Në një formë të përmblendhur gjendja në sistemin e zanoreve të shqipe së folur sot në dy dialektet mund të paraqitet si vijon.

toskërisht:
i y u
e ë o
a

gegërisht:

Gojore gjata	Gojore shkurtëra	të gjata	H hundore të shkurtëra
i: y:	ĩ ŷ	ũ	ĩ ŷ
e: (ë): o:	ẽ (ë) õ	ê: ô:	ê õ
a:	ã	â:	â

ose:

gojore

hundore:

i: y: u: ĩ: ŷ:
ĩ ŷ ũ ĩ ŷ
e: (ë): (ë) o: ê: ô
ẽ õ ê õ
ã â:

Është e qartë se zanoret e gjata realizohen si më të mbylltura dhe më të prapme se të shkurtërat, ndërsa tek hundoret ka dhe dallime të tjera në timbër.

Me shkrim, ndërkaj, qysh me zgjedhjen që është bërë në kodin alfabetik, kemi:

i y u
e õ

kështuqë për të shprehur çfarëdo nuancash të tjera duhen shenja të posaçme diakritike, të cilat kodi i parnë nuk i ka.

Toskërishtja nuk ka zanore hundore, më të shprehshme nuk bën dallime kuantitative midis zanoreve dhe, për pasojë, as dallime përkatëse cilësore (të shkallës së hapjes, të intensitetit, etj.);

Në të folme të veçanta, para së gjithash në toskërishten dhe tek arbëreshët, por edhe në të folme të caktuara gëge, kundërvënja *iy* neutralizohet. Tipari i buzorësisë e karakterizon vetëm kundërvënien *iy*, sepse te zanoret e prapme ai zgjidhet automatikisht;

Në toskërishten zanorja *ë* ka funksione me rëndësi; ekzistenca dhe përdorimi i saj e ul pesën e kuantitetit: *plakë/ pla:k/*, *lir/ lirin(ë)*, dhe të strukturës së mëtejme të mbareasave;

- Hundoreve gëge *â* dhe *ê* u përgjigjet toskërishtja *ë* dhe kështu në shqipen standarde ajo është stabilizuar si zanore qendrore në të gjitha pozituar;

- Te zanoret hundore kemi dhe një pikë lëvizjeje: *â*, për shkak se është më e prapme dhe më e ngritur dhe për shkak se në shqipen nuk ka *ô* hundore, pos fare marginalisht, është bërë e ngritjes së mesme dhe, pas çhoundorëzimit, ka kaluar thjesht në *o*, kështuqë rimon me *o* të zakonshme gojore: *me bo* (me ba), *kurxho* (kurrgja)/ *vo, dro*, disa të folme gëge kanë vetëm 2 fonema zanore hundore: *â, ê*, nazalizimi fonetik i zanoreve në rrokje të mbyllur me grup bashkëtingëlloz nasal+konsonant është i përgjithshëm;

- Grupet e zanoreve *ue/ua*, që dallojnë toskërishten nga gegërishtja, me denduri posaqërisht të madhe në sistemin foljor, në shqipen standarde është marrë vetëm pjesërisht: dallimi i mbiemrave të mundësisë përmes ndërtimit me prapshesën – *ueshëm*, nuk ekziston në toskërishten. Edhe këtu standardi ka marrë një formë të re në raport me toskërishten;

- Dallimi midis toskërishtes dhe gegërishtes te grupet *va/ vo* vlen vetëm për një numër të vogël fjalësh: *varr/ vorr, vaj/ voj, varfër/ vorfen, vajal/ vojta, vater/ voter, vaktë/ vokitë*, prandaj nuk ka ndonjë vlerë të madhe sa i përket standardit;

- Bashkë me hundorësinë shkon ndërtdhja e ndryshimeve të rëndësishme në strukturën morfologjike të dy dialekteve. Në toskërishten *-n-* ndërzanore ka dhënë *-r-: bërë/ bâ* (dikur **banë*), *punuar/ punue* (nga **punonë*); *larë/la* (nga **lanë*) dhe *lënë/lâ* (nga **lannë*). Kjo rregull duhet të ketë përfunduar qysh në sh. 8, por ka lënë gjurmë në tërë morfologjinë; huazimet e mëvona nuk e kanë pësuar këtë ndryshim. Rotacizmi është bërë tipar i shqipes standarde dhe përmes tij përtashohen disa forma të pjesores, kjo do të thotë gjithashtu edhe mundësia e përdorimit të infinitivit gëgë në këtë mënyrë është kufizuar, por janë pranuar dhe forma të veçanta gëge pa rotacizëm: toskërisht dhe standard *rërë* (geg *rânë*), por standard *ranishte*, në bazë të formës gëge dhe pa hundorësi;

- Edhe në gegërishten vërehen tendenca drejt reduktimit të hundorësisë. Në *Orthogrefinë* e fundit dhe më të mirën të gegërishtes të bërë në Prishtinë më 1964 shënim i hundorësisë ishte reduktuar skajshmërisht. Megjithatë edhe në vetë gegërishten është tipar në lëvizje, ndërsa në disa të folme nuk ekziston më fare, mungesa e hundorësisë së zanoreve në shqipen standarde nuk duket me pasojë të paparueshme, përveç në shqiptimin substandard automatik. Vërehen sidomos variante kontekstuale hundore të zanores *e*;

- E njëjta gjë vlen edhe për kuantitetin e zanoreve;

- Në përgjithësi ekziston një tendencë drejt reduktimit në minimumin e tipareve të përbashkëta të dy dialekteve në sistemin zanor dhe në parim ky reduktim shtihet në *rrudhje të hundorësise* dhe të *kuaniteteit të zanoreve*; kjo do të thotë njëherësh *zgjerrim i funksioneve të zanores ë*. Kjo ka krijuar shumë probleme për folësit e gegërishtes, në radhë të parë sa i përket kuaniteteit të zanoreve. Pasojë direkte e mohimit të kuaniteteit, i cili i diferencon zanoret edhe në timbër, është tendenca e rrafshimit të timbrit: bartësit gegë këtu ndeshin shumë vështirësi. Polifunksionaliteti i ë-së nuk i zgjidh në të gjitha rastet dallimet kuantitative, sidomos jo në rastet me rrokje të hapur. Në përdorimet e shqipes standarde nga folësit e gegërishtes dallimet e kualiteteit të zanoreve, që aje shkojnë bashkë me dallimet kuantitative, të shumtën herë.

Reduktimi i zanoreve hundore, mënjanimi i kuaniteteit dhe përdorimi i gjërë i ë-së kanë krijuar një distancë më të madhe midis shqipes standarde dhe gegërishtes së kultivuar e të elaboruar, që tash është shtyrë në substandard.

Në thelb, standardi i ri në sistemin zanor e ka marrë vetëm minimumin e përbashkët. Dhe kjo nuk ka qenë vetëm çështje përzgjedhjeje. Lëvizjet brenda sistemit zanor të gegërishtes, tendencat e fuqishme drejt reduktimit të zanoreve hundore, jo gjithkund gjendja stabile me kuanitetein e zanoreve, të gjitha këto kanë ndikuar në bazën e përzgjedhjes: një kompensim i pjesërishtëm u arrit përmes përdorimeve të gjera polifunksionale të ë-së. Megjithatë burimisht tipar i toskenishtes, kjo ë u bë e domosdoshme. Vështirësitë dalin qëkur ta konsiderojmë këtë thjesht toskenisht dhe ta asimilojmë toskenishten me standardin. Sepse, qysh në start ishte lejuar kompromisi.

Ky tipar i natyrshëm në toskenishten, ku kryesisht mungonte gjatësia funksionale e zanoreve, kishte pasoja dhe në ritmin e fjalisë dhe të të folurit në përgjithësi dhe favorizoi më tej asimilimin e thjeshtë me shprehjet e toskenishtes.

*

Në fakt përzgjedhja e kodit për shumë gjëra duhet të lidhet qysh me zgjedhjet që janë bërë për alfabetin në Kongresin e Manastirit. Në të dy variantet e lejuara ka vetëm 36 njësi themelore, domethënë 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore, që është analiza që kishte bërë Sami Frashëri dhe ndryshe nga Kristo-fondu. Kjo përzgjedhje në fakt e ka eliminuar në atë të glatë dhe përfundimisht analizën tjetër të mundshme për gegërishten të bashkëtingëlloret hundore, apo sa i përket hundorësisë së zanoreve a kuaniteteit. Le të shohim cili ishte vendimi i Kongresit.

Vendimi i Komisionit mbi geshijen e Abece.

"Pas qe u-kenduan verbalet e diëve t'jera e pas qe e pane se puna qe kicin bere, iote njiqft e maðe, po jo aqe sa te na kenaqte te çfibeve e t'i serbente si perparimit te çhues si te perhapurit te diutise ndër ne, te otyre eðe nga disa okake te perjaqtme, u kðyem prapa e me pelqim te te çfibeve u-vendos qe te mirret Abeja e Stanbofi e me te baake eðe ne Abece fjeet latine qe te mesohen e te perdoren baakariet ne mest te aqypetarevet. Mesimi nde okofe do te jete i ottenguar e i deqyroem per te dýja. Abete jane keto:

1) a, b, c, ç, d, ð, E, e, ç, f, g, ç, h, i, j, k, l, f, m, n, ñ, o, P, p, q, r, rr, s, o, t, ç, u, v, x, y, z, ç, x.

2) a, b, c, ç, d, dh, E, e, Ë, ë, f, g, ç, h, i, j, k, l, ll, m, n, ný, o, P, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, y, z, zh, xh.

U-dëftua eðe deotiri, e Komisioni e pelqeu aume, qe pas dy vjetea te mbahet ne kongres t'jatte, ku e kure t'a vendosne Kongresi i sotem per orthografi e letratur te çhues oqype".⁶

Megjithatë në tekstin shpjegues përdoret një theks i mprehtë për të shënuar e të theksuar në lidhësen edhe në fund, mbase e të hapur të shkurtë shenja të tjera diakritike për tinguj të ndryshëm nuk kishte. Kjo domethënë s'analiza ishte e atillë që supozonte vetëm kaq njësi themelore, pavarësisht nga diskutimet e ndryshme që do të jenë bërë në Kongres dhe pastaj.

*

Ajo që shkaktoi një tjetër dallim me rëndësi dhe që u reflektua dhe në qëndrimet sociolingvistike lidhur me valorizimet sociale ishte përjashtimi zanoreve hundore të gegërishtes nga shqipja letrare dhe standarde. Ç'është e vërteta, nga aspekti standardologjik dhe në frymën e tendencave zhvillimore të shqipes në përgjithësi, pra edhe të gegërishtes, kjo më duket zgjedhje krejt i natyrshme, mirëpo nga aspekti i gjykimëve të vlerësise, nga aspekti komponentes psiko-sociale të identitetit, nga aspekti i vlerës simbolike që shites të caktuara i japin këtij elementi, pikërisht si dallues dhe i hetueshëm lehtë a ngarkohet me një peshë që i kapërcen realitetet gjuhësore.

Pasi që shqipja e njësuar letrare kishte depërtuar në një hapësirë komunikimi, pasi ishte përgjithësuar si i vetmi variant në përdorim në situatat *High*, pra pasi ishte bërë në një shkallë gjuhë standarde, gazetaret për të karakterizuar idiomën e atyre që flisnin dialektin që sipas tyre

⁶ Sipas faksimilit të riprodhuar nga Osmani (1999), 479. Në ndonjë detaj leximi ynë ndryshon.

identifikohet tani si shenjë e 'të pakultivuarës', e 'rurale', e 'etnografikes', etj., patën krijuar një tjetër shprehje: "ata që flasin me shumë nazale".

Në të vërtetë, u krijuar një dinamizëm i hapësirave komunikative me së paku tri trafshe: shqipe standarde / gegërishte (sub)standarde / gegërishte dialektore, që u përgjigjeshin situatave të skajshme formale, apo "e asfaltuar", në njërin anë, dhe "rurale, etnografike, a me shumë nazale", në anën tjetër. Midis të dyjave mbetej një hapësirë asnjënjë:

shqipja e njësuar letrare (standarde)	gegërishtja letrare (substandarde)	gegërishtja dialektore
High	jo Low	Low, rurale, etj.
e asfaltuar	asnjënjë	me shumë nazale
e kultivuar	e kultivuar	e pakultivuar

Zhvillimet e tilla, ndërkaq, krijuan pasoja largvajtëse jo vetëm për gjuhën, por me këtë edhe për valorizimin e thesareve kulturore. U krijuar kështu një mbivlerë arkaizuese në atë shkallë që në vitet '90, pas ndryshimit të shtetësgesave ideologjike komuniste, kjo lojë në trafshin e simboleve vazhdoi të prodhonte refuzime, sepse ndryshimet dhe zhvillimet në mendësi en-de, mbase, nuk kishin ndodhur. Për një pjesë ruga e tillë shpie detyrimisht këtu: arkaizimi i gjuhës nuk mund të mos lidhet me vlerat estetike të vepra-ve të shkruara në atë gjuhë.

Në Kosovë, në gëshnje të gjuhës, ashtu si në shumë të tjera, gjithë çka nuk ngjante me atë që krijohej në Shqipëri perceptohej si e ardhur nga Jugosllavia/ Serbia, pra nga okupuesi. Ky perceptim theksohej dhe në Shqipëri, ndoshta për motive të tjera.

Pas ndërprejës së komunikimeve me Serbinë dhe luftës së hapur, pas intensifikimit të kontakteve me botën shqiptare dhe përditimin evropian, realiteti shumëësor gjuhësor, dekalazhi midis varieteteve të ndryshme (sub)standarde, dialektore, sociolektore, në raport me gjuhën standarde, nuk mund të mbulohej më me lojën e simboleve të mëparme. Shpërthimi i sistemit dirigjist krijoi një zbrazëturë në fushën e planifikimit gjuhësor gjithashtu. Disa nga mietet e mëparme si "karakteri popullor i gjuhës letrare", nuk mund të funksiononin më. Nga ana tjetër, në mediumet e Tiranës hetohet një rikthim nga toskërishtja në realizimin e standardit, sikur nisi të bëhej e zakonshme të identifikohet toskërishtja me standarden.

Fakti se të folurit gjuhën e njësuar letrare i atribuohet një vlerë simbolike, pra një pushtet simbolik, nxiste reagime, të cilat, në rrethanat e mungës së një politike gjuhësore, po rriteshin. Pasojat e ndryshme të gjatë dhe të mungës së komunikimit theksoheshin poashtu për shkak të manifestimit të

njëfarë posesivizmi në raport me kulturën kombëtare nga ana e shtetit shqiptar. Gjithëçka bëhej edhe më komplekse: pas rënies së komunizmit ndodhi refuzimi parimor i realizmit socialist. Megjithatë, veprat kryesore të asaj periudhe vazhduan dhe vazhdojnë të vlerësohen gjerësisht. Mafje ka dhe tendenca që ky lloj i veçantë restaurimi vleror dhe parimor të mbulohet me emërtime të ndryshme, apo me rethime të vogla. Refuzimi i vlerave të tjera, nga ana tjetër, shpesh mbulohet me një pretext gjuhësor.

*

Manifestimet e tilla mund të evitohen përmes rritjes së komunikimeve, të aftësisë komunikative të shqiptarëve kudo që janë për të gjitha kodet e gjuhës. Dhe të vetëdijes se, si çdo gjuhë, shqipja ka shumë kode, nga të cilët secili i ka dimensionet e vlerave të veta, të identitetit, të simbolikës, etj., prandaj edhe hapësirat e domosdoshme shoqërore të funksionimit.

Ndryshimet shoqërore dhe demografike të 10 vjetëve të fundit do të sjellin zhvillime të tjera: Tirana e Prishtina papritur e kanë dyfishuar popullsinë e tyre dhe, për pasojë, përveç "asfaltit gjuhësor" të elitave të mëparme, aty ndeshen gjithnjë e më shumë gropa të "nundoreve" të të ardhurave, edhe në jetën publike. Ato kanë ndikuar mafje të bëhen të dukshme edhe realitetet dialektore, substandarde apo sociolektore që ishin gjithnjë aty. Ardhja në Tiranë dhe në rrethet e popullsisë nga malësitë e Veriut, e cila më të shpeshtën flet dialektin e vet gegë, ka prodhuar një efekt që për ne si kalimtarë të rasisi nuk mund të mos bjerë në sy: tash nëpër rrugët e Tiranës gjithnjë e më shumë dëgjohet vetë dialekti i Tiranës, i cili më parë nga pozita e vrogjuesit të rasisi as që hetohet.

Nga ana tjetër, shoqëritë shqiptare nuk bëjnë kurrfarë përyashitimi në raport me të tjerët në botë: nevojat identitare të shtresave, të grupeve apo të brezave krijojnë dhe ndryshime shprehjore. Mjafton të hulumtojmë pak si flasin, ta zëmë, gjumazistët e Prishtinës. Gjatësia e zanoreve, e cila në gegërishten, në gegërishten e Kosovës sidomos, realizohet me një pritje drejt një shkalle më të lartë të ngutjes, çka bie në sy sidomos te zanorja a, e cila në rastet e tilla tejshkruhet si [a] ose [a^o], tash te këta folës realizohet si me tendencë diftongimi të kundërt: nga lart në fillim, e që mund të tejshkruahet, ta zëmë, si: [ʔa]. Dhe elementet e tilla kanë nisur të përjetojnë si element i solidaritetit dhe identitetit grupor, ose, siç më thoshin disa bashkëmoshatarë të tyre që nuk duan të flasin ashtu, "si lazdrit". Sido që të jetë, nuk mund të mos hetohet se ndeshja e nënsistemeve të ndryshme po krijon lëvizje në realitetet.

Në këtë dinamizim të ri social dhe hapësiror, apo edhe vetëm legjislizim të dinamizmit paraekzistues, standardi empirik do të ndryshojë

paletër. Empiria nuk mund të mos ketë veprime mbi preskripcionin, aq më tepër që standardi i folur le hapësitë për lëvizje të ndryshme.

Gjithë duke i hapur sytë para dëshmiave sociolingvistike për faktin se planifikimet gjuhësore janë pjesë e planifikimeve më të gjera, të modernizimit, të integrimi kombëtar e politike, eij, ashtu si dhe para faktit se janë eliat ato që drejtojnë planifikimin gjuhësor, është e nevojshme të hetohen dhe reaguesimet ndaj procesit të standardizimit dhe situatës së trashëguar.

Gjatë periudhës dirigjiste ka pasur refuzim të standardizimit të mbështetur në toskërishten sidomos në diasporë, ndërsa në Shqipëri dhe në Kosovë nuk ka pasur hapësirë për manifestimin e tyre. Mendoj se për një pjesë ato kanë qenë të nxitura nga fakti se ekzistonte një tendencë e monopolit mbi vlerat simbolike të standardit nga ana e një qende ndërkohë që bashkësia shqipfolëse është policentrike. Ka pasur dhe ende ka të atillë që shqipen e njësuar letrare e shohin prodhim të diktaturës dhe të sistemit diktatorial e politikisht monist.

Çlirimi nga rreziku serb, ulja e përgjithshme e nivelit të jetesës dhe të standardit gjuhësor e të kulturës së shprehjes për shkak të gjendjes shumë të njohur në shkollë, rritja enorme e komunikimeve publike dhe aportet e atyre "me shumë nazale", nevojat simbolike dhe identitare në një situatë gjithnjë pezull sa i përket statusit të Kosovës, të gjitha këto e kanë intensifikuar reagimin e disa shtesave në Kosovë. Kësaj i shtohet dhe gjendja anonimike dhe kaotike, në të cilën mund të përdorësh dhe në situata formale çfarëdo gjuhe të çfarëdo cilësie, mjaft që të merresh vesh, sepse edhe anglishten e folur nga të ardhurit apo nga vendësi e kemi përkështu të reduktuar skajshmërisht. Nëse mund të veprosh kështu me anglishten, përse të bëhemi cikritimtarë me shqipen, sikur duan të thonë të tillët. Ndërkaj, pas çrregullimeve që pati në këto dy dekada, me nënçmimin evident shoqëror aktual, shkollë, është e qartë, nuk është e zonja ta kapërcejë këtë vëshitësi.

Në Kosovën që është nisur rrugës së pavarësisht shtetëror me të gjitha implikimet identitare që mund të ketë ky pavarësim, jo vetëm shtetërgesat e normativizimit si frymë, po edhe nevoja si ajo për të pasur një dardan përballë dinarit apo lekut, për të stisur një flamur të Kosovës, eij, ndikojnë poshtu në gjendjen gjuhësore.

Rrethanat e reja kërkojnë përgjigje të vendosur dhe të shpejtë përmes krijimit të një politike liberale të gjuhës, e cila do të synonte zgjerimin maksimal të aftësive komunikative të folësve të të gjitha shtesave, rritjen e fleksibilitetit të normave të standardit në përmasa të realiteteve të kombit policentrik, gjithë duke përpunuar më tej të artiturat e tri dekadave të fundit.

Sa di unë, në Kosovë deri tash ka pasur tri lloje reagimesh ndaj këtyre fenomeneve.

1. disa kërkojnë revitim e disa rregullojnë ekzistues dhe zgjerimin e normës nte elemente të reja, dhe, gjithsesi një integrim më të çirshëm të resurseve gegë, që pretendohet të jenë lënë pas dore;
2. nga ana tjetër është reagimi i atyre që janë të bindur se standardi i atillë si është nuk paraqet zgjidhje dhe shkakton shumë vëshitësi për t'u nxënë nga gegët, se nuk ua bën të mundur gegëve ta realizojnë tërë begatinë e krijimit leksikor e gramatikor, sidomos me lënie anash të infinitivit, dhe se prandaj duhet të lejohet përdorimi paralel i gegërishtes si gjuhë standarde në pajtim me realitetet empirike; ndonjëherë këtu është lënë të kuptohet, nëse jo nyjetuar, ideja pas së cilës Kosova, si shtet i pavarur që syzon të jetë, duhet të ketë dhe simbolet dhe vegantitë e veta;
3. reagimi i shumëve, ndër ta kryesisht gjuhëtarë, ka qenë kryesisht defensiv në raport me normën ekzistuese.

Nuk do harruar reagimi i grupit të shkodranëve.

Nuk më duket se jemi në një situatë kur duhet të mendojmë për alternativë të skajshme. Gjermanët, austriakët dhe zviceranët gjermanishtfolës kanë arritur që, përtej kufijve dhe dallimeve të tjera politike, ekonomike dhe sociale dhe shpesh shumë të mëdha dialektore, të ushqejnë më tej njëjetin e tyre të përbashkët dhe unik të komunikimit standard, natyrisht, duke shfrytëzuar maksimalisht të gjitha hapësirat e të përbashkëtës dhe duke respektuar, toleruar e mbi të gjitha miëkuptuar ndryshimin dhe të ndryshmen, nevojën për elemente të ndryshme në hapësira të ndryshme të përdorimit të gjuhës së tyre. Asnjë lloj determinizmi nuk i pengon shqiptarët në këtë drejtim.

Përveç rritjes së nivelit të edukimit, që më duket thelbësor, hapja e plotë e komunikimeve dhe miëkuptimi apo së paku toleranca ndaj të folurit tjetër dhe ndryshe duhet të jenë përgjigja e vërtetë që duhet të ndikojë në zhvillimet e kësaj magme të re. Thelbësor është konceptimi dhe përpunimi e zbatimi i një politike liberale për gjuhën, e cila do ta merre parasysh gjerësinë e hapësirave komunikative, shumësinë e kodeve, përshtatjen e përdorimit të tyre për hapësirat përkatëse, rritjen e nevojave të komunikimit, prandaj edhe rritjen e nivelit të kulturës së shprehjes, elementet thelbësore me vlerë simbolike të identitetit shtetëror, kulturor, të bashkësisë shoqërore, integrimet brendashqiptare, po edhe ndërkombëtare, prandaj edhe kontaktet me gjuhët e tjera, eij. Mbi të gjitha dhe në të gjitha hapësirat ajo që quhet 'kulturë e gjuhës' kërkon vëmendjen e plotë të të gjithëve. Dhe, siç është thënë mija herë, të gjitha këto kanë një kosto: në atë çmim hyn energjia e nevojshme për ta nxënë standardin nga një numër optimalist i madh i

folësve, po edhe trysia e ligjit të shpenzimit sa më të vogël në rrethanat e reja shoqërore. Kokëfortësia e linjës së drejtë mund të sjellë pasojë të paparashkueshme.

Shpjegimin e një pjese të ecuarive, të kushtëzimeve dhe të motiveve shoqërore, në rrafshin e standardizimit të shqipes në Kosovë ka mundësi ta shohim në suazat që krijohen midis fushave konceptuale të përsënuara nga "infinitivi", në një anë, dhe nga "statusi minoritar", nga ana tjetër, duke veçuar kështu dy skaje që kanë qenë kufizuese me dekada. Me "infinitivin" kuptohet kompleksi i gëshijëve që lidhen me gëgërishten si gjuhë letrare (standarde), ndërsa me "statusin minoritar" kuptohet pozita që iu imponua shqiptarëve në Jugosllavi gjatë shekullit XX.

Në gëgërishten e shkruar, sidomos në letërsinë artistike, rreth infinitivit janë zhvilluar mundësi të mëdha përdorimesh stilistike, një sintaksë e veçantë me tendencë të theksuara abstraksioni. Kështu, njështria e përdorimit të infinitivit është bërë në njëfarë dore simbol i elaborimit dhe i plotësisë së gëgërishtes letrare, diku me mbështetje reale, shpesh jo pa mistifikim. Prandaj del e kuptueshme që përpjekjet e shumëve që mendojnë se shqipja standarde duhet të ketë një bazë, nëse jo ekskluzivisht, më të gjerë po se po, në gëgërishten, në njëfarë mënyre, janë zhvilluar në shenjë të mbrojtjes së infinitivit.⁷

Në linjën e tillë të reflektimit nuk duket krejtësisht e përfashueshme të shtrohet nevoja për një rishqyrtim të përdorimeve që kanë shkaktuar kaq shumë nryje – të infinitivit. Në të vërtetë, nuk është aspak i kontestueshëm përdorimi i lidhore në shqipen, magje edhe në të dy variantet e mëparme. Pos kësaj, shqipja në tërësi, pra edhe varieteti standard, e ka përdorimin e ashtuquajtur privativ të një forme paralele me infinitivin e tipit gëgë:

me punue: *pa punue*
- : *pa punuar*

Fjala është për një kombinim të pjesës me prejardhje parafjalore me pjesoren për të dy rastet e gëgërishtes, ndërsa toskenishtja nuk e lejon kombinimin me *me*. Për ta zgjidhur këtë një, që përbën pikën më kontestuese, mund të merren më mend rrugë të ndryshme.

Mund të shtrihet më tej parimi i kompromisit, tashmë ekzistues: në gjuhën standarde, sadoqë me përmasa të reduktuara, konsistencë sistemore, të cilëve mbronte S. Malëshova qysh më 1952 derisa e kundërshtonte inkudimin e infinitivit me *me* në shqipen letrare kombëtare, ajo konsistencë është shkelur në

⁷ Shih: Riza (1944); Riza (1996); Ismajli (1972); Ismajli (1974); Ismajli (1998); Sulejmani (1983); Pipa (1989); Veselaj (2000), etj.

më shumë raste si parim (ue, mosshurdhimi, rërë/ranishte, shumë fjalë e shprehje të gëgërishtes, etj.). Në të vërtetë as parimisht nuk ka si të konceptohet një gjuhë e standardizuar, që domethënë një nivel kulturor, pra për një pjesë vetëdijshëm i elaboruar dhe i kultivuar, gjithë duke mbetur në suaza të konsistencës strukturore të një idiom natyror, dialektor. Edhe vetë e kam pasë kritikuar A. Kostallarin për teprimet lidhur me theksimin e karakterit prej koineje dhe të elementeve të përbashkëta të 'shqipes së njëzuar letrare'. Megjithatë teprimet dhe demagogjinë që mund të ketë qenë motivi i tyre, afirmimi i parimit nuk mund të mohohet. Po ndodhi një herë transgresioni i tillë parimor, ku duhet të jetë kufiri i pakapërcyeshëm? Dhe, nëse motivi për lejinin e një kombinimi apo të një forme a shprehjeje është gjeja e zgjidhjes për ta kapërcyer burimin e frustimeve dhe të ankësve për 'papërshtatshmërinë' apo për çninin e lartë të njëjtit ekzistues standard, pse u dashka të mos reflektojmë?

Nuk më duket e pamundshme të zgjerohet standardi në atë mënyrë që në tipa të caktuar ndërtimesh sintaksore të lejohet kombinimi infinitival i tipit gëgë me *me*, goftë duke e ruajtur të plotë formën e pjesores gëgë vetëm në ato funksione, goftë duke kërkuar rrugë të tjera përmes formave të ndërmjeme të pjesores së shkurtë, apo edhe duke e ruajtur trajtën me prejardhje toskë të pjesores, ashtu siç ngjet me privativin. Sadoqë tashmë kemi krijuar një shprehje dhe një imazh për normat e shqipes standarde pa infinitiv me *me*, pra vetëm me privativ *pa*, nuk është e pamundshme të kërkojmë kombinime dhe zgjidhje të dobishme, goftë edhe vetëm për t'i mbyllur burimet e pakënaqësive dhe të frustimeve. Parimi i kompromisit dhe i kombinimit të elementeve të ndryshme strukturore me burim nga dy variantet e mëparme letrare në shqipen standarde, sig' u tha, tashmë ekziston dhe kombinimet e tilla jo vetëm që nuk kanë shkaktuar vështirësi, po përkundrazi, e kanë begatuar standardin. Inercia e përdorimit nuk është arsye e rendit parimor që lidhet me konsistencën tashmë të shkelur të strukturës.

Për një kohë të gjatë dhe vetë kam qenë i bindur se kompromiset strukturore dhe rrethimi i konsistencës së tillë të standardit duan marrë me rezervë. Më vonë kam filluar të shoh se në të dy rastet, si në rasin e absolutizimit të përdorimeve infinitivale, ashtu dhe në rasin e kërkesës së 'naujes me çdo kusht të konsistencës strukturore' të standardit në raport me bazën e tij toskë, mund të kemi të bëjmë fare mirë dhe me një mit. Ndërkq, po të arrijmë të gjejmë zgjidhje të pranueshme për këtë gëshije ne do ta nisnim thelbësisht shkallën e pranueshmërisë së standardit.

Shqipja standarde tash po e kalon dekadën e tretë. Është e nevojshme të mendojmë seriozisht për të aritur aje ku synohet sipas konceptimeve shoqërore të sociologut Emile Durkheim, i cili veprimi në çerëkun e fundit të sh. 19 dhe në të parin të sh. 20, ashtu si dhe të sociologjivistit të pjesës së dytë të shekullit 20 Charles Fergusson, pra të sugjerimi pas të cilit gjuha e

transcendon individin dhe shoqërinë historike drejt unifikimit të kulturës duke vendosur komunikime. Hapësirat e veganta të komunikimit, shoqërore apo gjeografike, në raport me universalitetin e standardit, duhet të jenë në pozitë të ngjashme me të individit, pra të transcendueshme, gjithë duke qenë të identifikueshme. Nëse një gjuhë standarde arin të jetë e pranuar si gjuhë e familjes, ajo mund të bëhet varieteti universal i asaj shoqërie. Nuk më duket se ka pak për të bërë.

Prill 2001

MOMENTE TË RËNDËSISHME PËR HISTORINË E GJUHËS SË SHKRUAR

- XIV-XVI (?) Sh. Fragmenti i përkthyer nga një anonim i një cope Ungjilli pas Pateut. Toskërisht.
- 1462 Fjalë e parë e shkruar shqip, nga Mati.
- 1555 Buzuku, Gjon Bdek: "Meshari". Me gjasë nga rrethinat e Tivarit nga skaji veriperëndimor.
- 1592 Matrënga. Lekë: E mbsuame e krishterë. Përkthim i një teksti katekistik; vlerësia e parë shqip – 8 vargje. Toskërisht.
- 1618-1622 Budi, Pjetër: *Doktrina e krishtenë. Pasëqyra e t'rrëfymit, Ritual roman*. Nga Mati, i vendosur në Kosovë. Gegërisht, prozë dhe poezi..
- 1635 Bardi, Franç: *Dictionarium latino-epiroticum*, në jug të Shkodrës; tekstet e para folklorike – fjalë të urta, gegërisht.
- 1685 Bogdani, Pjetër: *Cuneus prophetarum*, nga rrethi i Prizrenit, tekste filozofiko-fetare, por edhe poezi.
- 1716 Da Lecce, Francesco Maria: *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, nga Italia e Jugut, gegërisht.
- 1814 Martin-Leake, William: *Researches in Greece, Sketch of the Grammar*, London, me një gramatikë të mbështetur në të da Lecce.
- 1854 Hahn, Johan Georg von: *Albanesische Studien, Beiträge zu einer Grammatik des Toskischen Dialektes*, Jena.
- 1866 Rossi, Francesco: *Regole grammaticali della lingua albanese*, Roma, gegërisht.
- 1879 Dzon, August: *Manuel de la langue chikpe ou albanaise*, Paris, toskërisht.
- 1882 Kristoforidhi, Konstandin: *Grammatiki tis albanikis glossis*, Athena. Gegërisht dhe me vërejtje për të dy dialektet.
- 1866 Frashëri, Sami: *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Bukuresht. Toskërisht, me vërejtje për të dy dialektet.
- 1908 Kongresi i Manastirit, Kongresi i alfabetit.
- 1908 Pekmezi, dr. Gjergj: *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien.
- 1916-1917 Komisija Letrare e Shkodrës, i jep përparësi të folmes së Elbasanit si bazë për gjuhën e përbashkët të shkruarit.
- 1920 Kongresi Arsimor i Lushnjës, i rimerr vendimet e Komissisë Letrare.
- 1923 Qeveria e Shqipërisë vendos që dialekti i Elbasanit të jetë baza e gjuhës zyrtare të shkruarit.
- 1927 Ortografia e Adon Aldeghierit e orientuar në traditën shkodrane.
- 1928 Themelimi i një Akademie letrare, e cila do të merrej me themelimin e një gjuhë të përbashkët letrare.
- 1935-1944 Diskutime të ndryshme mbi bazën e përbashkët të gjuhës letrare.
- 1941-1945 Shkollat e para fillore, gjimnazet dhe shkollat teknike me mësim në gjuhën shqipe, joprivatë, në Kosovë.
- 1944 Riza, Selman: *Tri monografia albanologjike*, Tiranë, traktat mbui themelimin e një gjuhë të përbashkët letrare pangege.
- 1945 Regjimet komuniste në Shqipëri dhe në Jugosllavi.
- 1946 Ministria e Informatave dhe e Propagandës në Tiranë (ministër S. Matëshova) parapëlqen gjuhën letrare të mbështetur në toskërishten.
- 1946 Ministria e Arsimit në Tiranë (ministër S. Matëshova) parapëlqen gjuhën letrare të mbështetur në toskërishten.
- 1947 Ortografia, në të dy variantet (Xhuvani, Cipo, Çabej).

1952 Diskutime të gjera mbi gjuhën e përbashkët letrare kombëtare në 2 Konferenca për gjuhën në Tiranë, pa përfundime konkrete.
Mbledhja gjuhësore në Prishtinë.
1953 Themelohet Instituti Albanologjik në Prishtinë.
1955 Mbyllet Instituti Albanologjik në Prishtinë.
1956 Ortografia në Tiranë, version i ri; autorë Xhuvani, Çabej, Domi dhe Kostallari. Format geqe jepen vetëm në fushat.
1957 Mbledhje gjuhësore në Prishtinë.
1960 Në Prishtinë u themelua Fakulteti Filozofik. Gjuha e mësimi serbishtja. U themelua një degë studimi për gjuhë dhe letërsi shqipe.
1964 Ortografia e gjuhës shqipe, Beograd-Prishtinë, për gëgjërshten.
1966 Rënia e ministrit të brendshëm jugosllav Ranković, fajzë e liberalizimit.
1967 Rihemeloher Instituti Albanologjik në Prishtinë. Në Tiranë jepet në diskutim publik një version i ri i drejshkrimit.
1968 Konsulta Gjuhësore e Prishtinës.
1972 Kongresi i Drejshkrimit në Tiranë: marrin pjesë edhe përfaqësues të shqiptarëve të Jugosllavisë dhe arbëreshë.

SHËNIME BIBLIOGRAFIKE

AGANI (2002), Fehmi: *Vepra 8*, Dukagjini, Pejë, 2002.
AJETI (1957), I.: *Për ndritshimin e gjuhës gjuhësore të shqipes*, Përpërimi, Prishtinë, 1-2, 15-20.
AJETI (1972), I.: *Rruga e mësimi të shqipes letrare*, Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejshkrimit të saj (Studime dhe artikuj), Vëll. I, Tiranë.
ALDEGHERI (1927), Adon: *Ortografia shqipe*, Shkodër, 64.
Alibeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1972.
BEÇI (1995), Bahri: *Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore*, Seminat XVII ndër-kombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë.
BOKSHI (1998), Besim: *Pjesorja e shqipes*, ASHAK, Prishtinë, f. 218.
Buletin i Institutit të Shkencave, SSHSh. (1952) Janar-mars, Tiranë.
Buletin për shkencat shqiptare (1954), Tiranë IV.
BYRON (1976), Janet: *Selection among Alternates in Language Standardization: the Case of Albanian*, The Hague.
BYRON (1979), Janet: *Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia*, Word vol. 30, nr. 1-2, April-August.
ÇABEJ (1973), Prof. Egrem: *Mbi disa gjuhë të traditës së shkrimi dhe të drejshkrimit të shqipes*, Kongresi i Drejshkrimit të gjuhës shqipe, 20-25 nëntor 1972, Tiranë.
ÇIKULI (1970), Nikolea: *Zhvillimi i drejshkrimit të shqipes pas Çlirimit*, Studime filologjike 4, Tiranë.
DEMIRAJ (1970), Shaban: *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Prishtinë.
DOMI (1980), M.: *Aleksander Xhuvani lëvres dhe studues i shquar i gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 1, Tiranë, 29-42.
DOMI (1989), M.: *Prof. Selman Rizat - studues i shquar i gjuhës shqipe*, Gjuha jonë, 2, Tiranë, 99-102.
DRINI (1957a), S.: *Disa gjuhë të ortografisë së gjuhës shqipe*, Jeta e re, Prishtinë, 3, 323-342.
Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984, (1988), Tiranë.
GRUPA AKADEMIKA SANU (1989): *"Memorandum SANU"* (1989), Naše teme, Zagreb, 33 (1-2), 128-164.
HADRI (1968), Ali: *Një komb - një gjuhë letrare*, Përpërimi 34, Prishtinë.
ISMALI (1972), Rexhep: *Tingulli, fjala e lidhur, ligjërimi...*, Dituria, revistë shkencore e studentëve të Kosovës, Prishtinë, 4, f. 9-19.
ISMALI (1974), R.: *Tingulli, fjala e lidhur, ligjërimi...*, Shënje e ide, Rilindja, prishtinë, 1974, f. 97-115.
ISMALI (1988), R.: *Mbi statusin e shqipes standarde në RFS të Jugosllavisë*, Thema 10, Prishtinë, 93-122.
ISMALI (1989), R.: *Albaniani jezik u Jugosllaviji*, Gaber, S-Kuzmanic T. (1989): *Kosovo-Srbija Jugosllavija*, Ljubljana, 81-109.
ISMALI (1991), R.: *Gjuhë dhe etni*, Rilindja, Prishtinë, 450.
ISMALI (1994b), R.: *Etni e modernitet*, Dukagjini, Pejë, 217.
ISMALI (1998), R.: *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"* (Rjedhat e planifikimit të shqipes në Kosovë 1945-1968), Pejë, 330.
KASTRATI (1988), J.: *Probleme të normës gramatikore në gramatikën e pasçlirimit*, Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë.
KASTRATI (1996), J.: *Përpyqet për një gjuhë të përbashkët letrare kombëtare shqipe në shekujt XIX-XX*, Studime, ASHAK, 3, Prishtinë, 187-215.
Konferenca I e studimeve albanologjike (1965), Tiranë.

- Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972, I (1973), Tiranë.
- Konkluzat e Konsultës gjuhësore të 22-23 prillit 1968* (1968), mbajtur në Prishtinë, Përpunimi 3-4, Prishtinë.
- KOSTALLARI (1970), A.: *Mbi disa vegorë strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, Studime filologjike 2, Tiranë.
- KOSTALLARI (1971), A.: *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, Shkencaat shoqërore në shkollë, 2, Tiranë.
- KOSTALLARI (1972), A.: *Mbi disa vegorë strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj, v. I, Tiranë.
- KOSTALLARI (1973), A.: *Gjuha letrare e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë.
- LIOSHI (1997), Xn.: *Mbështetje për gjuhën letrare*, Tiranë, 157.
- NESIMI (1973), Rrenzi: *Procesi i njësitit të drejtshkrimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Studime filologjike 1, Tiranë.
- Ortografia e gjuhës shqipe, (1964), (Komisioni: dr. I. AJETI, kryetar, dr. P. JANURA, S. DRINI, H. VOKSHI, M. BARDHI, L. MULLAKU, M. ISAKU, XH. GEGA dhe L. LUCAJ), Beograd, 66.
- Ortografia e gjuhës shqipe* (1956), Buletin për shkencat shoqërore 4, Tiranë, 38-65.
- Ortografia e gjuhës shqipe* (1951): Instituti i Shkencave, (Punuar prej A. Xhuvanit, K. Cipos dhe E. Çabejt), Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 27.
- Ortografia e gjuhës shqipe* (1948), Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1, 3-50.
- OSMANI (1987), Tomor: *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 295.
- OSMANI (1999), Tomor: *Udhë e shkronjave shqipe*, Shkodër.
- PIPA (1989), Arshi: *The Politics of Language in Socialist Albania*, East European Monographs, Boulder, New York, 283.
- Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj (1972): (Studime dhe artikuj), Vell. I, Tiranë.
- RAKA (1988), Fadil: *Rëndësia e Konsultës gjuhësore të Prishtinës*, Gjuha shqipe, Prishtinë, 3, 85-91.
- RAKA (1989), F.: *Ortografia e 1964-ës dhe normëzimi i shqipes letrare në Jugosllavi*, Gjuha shqipe, Prishtinë, 2, 95-103.
- RAKA (1995), F.: *Zhvillimi i gjuhës së shqiptare në Kosovë*, Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë.
- RAKA (1997), F.: *Historia e shqipes letrare*, Universiteti i Tetovës, Tetovë.
- REXHEPAGIQ, J-VOKRRI, A.-VESELI, A. (1997): *Shkolla Normale "Samë Frashëri", Prishtinë 1941-1944*, Eni i Tekstive dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë.
- RIZA (1944), S.: *Tri monografia albanologjike*, Mesagjeritë shqiptare, Tiranë.
- RIZA (1951), S.: *Problemi gjuhësor dhe zgjidhja e tij*, Jeta e re, Prishtinë, 5, 273-276.
- RIZA (1952), S.: *Filimet e gjuhës së shqiptare*, Mustafa Bakija, Prishtinë.
- RIZA (1979), S.: *Studime albanistike*, Rilindja Prishtinë, 478.
- RIZA (1996), S.: *Vepra 1*, ASHAK, Prishtinë.
- RIZA (1997), S.: *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë.
- Regulla mbi ortografin e gjuhës shqipe të shkruara të vendosura prej Komitës letrare* (1917): *Shkodër, 1917*, Filologji (1977): 3, Prishtinë, 1-6.
- RROTA (1968), Justin: *Për historinë e alfabetit shqip*, Rilindja, Prishtinë.
- SULEMANI (1983), Fadil: *Çështje të normës letrare*, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës, Prishtinë, f. 95.
- SHUTERIQI (1952), Dh. S.: *Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe*, Buletin i Shkencave Shoqërore, IV, Tiranë, 3-55.

- VEHBIU (1992), Ardi: *Albanese standard: peccato originale e riduzione*, Katundi ynë, 81,3, dhe Albanica, 3-4, 1992.
- VESELI (2000), dr. Nuh: *Paskajtorja çështje e shqipes standarde*, Dardania sacra, Shmuf, Prishtinë, ff. 168.
- WILLIAMS (1992), Glyn: *Sociolinguistics. A sociological Critique*, Routledge, London and New York.
- XHUVANI (1961), Aleksander: *Për themelimin të një gjuhe letrare*, Jeta e re, Prishtinë, 6, 744-749.
- ZAJMI (1971b), G.: *Pozita e gjuhëve në Kratinën Autonome të Kosovës në periudhën 1945-1970*, Përpunimi 17, Prishtinë, 551-569 dhe 639-653.

KURSE, REFERIMIE

A KA RASË GJINORE SHQIPJA?¹

Synimi ynë nuk është thjesht t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, por të rishtrijmë pyetjen: "Sa rasa ka gjuha shqipe?", pyetje që është shtruar disa herë kohët e fundit². Ky shkrim, pra, synon të parashtojë dhe të diskutojë disa çështje që ndeh rasa gjinore. Për rasat e tjera është diskutuar më shumë.

Tradicionalisht, gjuhës shqipe i janë njohur pesë rasa: emëtorja, gjinorja, dhanorja, kallëzoria dhe rrjedhorja³. Ky është sistemi rasor që ka zënë vend edhe në Gramatikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë⁴.

¹ Kjo ndihmesë e profesor R. Përnaskës ka mbetur pa përfshirë në vëllimin e vitit të kaluar për shkak të një gabimi teknik. Duke e sjellë në këtë vëllim, kërkojmë ndjesë nga profesor Përnaska dhe nga lexuesit. Redaksia.

² Shih ndër të tjerë: S. Prifti, *Mendime për disa çështje të rasave në gjuhën shqipe*, *Studime filologjike*, 1975, 3, ff. 125-126; H. Agani, *Persitje mbi një sinkretizim në shqipe (Rasat gjinore, dhanore e rrjedhore në gjuhën shqipe)*, *Fjala*, Prishtinë, 1976, 20, f. 7; 22, f. 7; 1977, 1, ff. 6-7. O. Buchholz, *Mbi gërsheimin e aspekteve morfologjike e sintaksore tek rasat në gjuhën shqipe*, *Gjurmime albanologjike*, seria e Studime filologjike, 1980, 3, ff. 154-170 (tribotuar në *Çështje të mortologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, ff. 114-127); Ch. Gut, *Combien l'albanais comporte-t-il de cas?*, *Cahiers balkaniques*, 19, Paris, 1993, ff. 207-216.

³ Au. Dozon, *Manuel de la langue chtipe ou albanaise*, Paris, 1879, f. 188; L. Benleuw, *Analyse de la langue chtipe ou albanaise*, Paris, 1879, f. 53; V. Librandi, *Grammatica albanese*, Milano, 1928, f. 14; S. E. Mann, *A short Albanian Grammar*, London, 1932, f. 45; K. Kamsi, *Manuale pratica della lingua albanese*, Shkodër, 1942, f. 15; O. Myderrizi, *Grammatika e Re e shqipes*, Tiranë, 1944, f. 37; A. Heizer, *Lehrbuch der vereinigten albanischen Schriftsprache*, Hambourg, 1978, f. 144; Th. Kacoti, *A Handbook of Albanian*, Sofia, 1979, f. 36; G. I. Ejntrej, *Albanskij jazyk*, Leningrad, 1982, ff. 16-17, 22-24; M. Camaj, *Albanian Grammar*, Wiesbaden, 1984, ff. 32-35; O. Buchholz, W. Fiedler, *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 212.

⁴ Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*,

Autorë të ndryshëm i kanë njohur shqipes nga shtatë rasa në tri. Vetëm A. Buzeti pranon tetë rasa: emëroja, gjinoja, dhanorja, kallëzoria, vendorja, thirroja, rrjedhja dhe instrumental⁵. Kështu, në gramatikat e Lambercit, Pekmezit, Leoit, Kordinjanos, Feizit dhe Drizarit gjenden shtatë rasa: emëroja, gjinoja, dhanorja, kallëzoria, vendorja, thirroja dhe rrjedhja⁶, kurse në ato të S. Frashërit dhe G. Majerit gjenden gjashtë rasa: emëroja, gjinoja, dhanorja, kallëzoria, vendorja, dhe rrjedhja⁷. Gramatikat më të hershme të shqipes, si edhe ato të Pashko Vasesë, Jakov-Mëturit, Sheperit, Cipos, Rizës, Dodbiës, Spases, Lambercit, Demirajt, Elezit, Ferrarit, Resulti, Gurakuqit, kanë vërtet gjashtë rasa: emëroja, gjinoja, dhanorja, kallëzoria, thirroja dhe rrjedhja, pra nuk kanë vendoren⁸.

⁵ II, Tiranë, 1976, ff. 84-89; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Institut i Gjuhësise dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe, I, Morfologjia, Tiranë, 1995, 452 f.

⁶ A. Buzeti, Pratica e gramatica della lingua albanese, Shkodër, 1914, f. 170.

⁷ M. Lamberz, G. Pekmezi, Lehr- und Lesebuch des Albanischen, Wien-Leipzig, 1913, f. 6; A. Leoit, Grammatica elementare della lingua albanese, Heidelberg, 1912, f. 22; A. Feizi, Grammatica albanese, Napoli, 1929, f. 32; F. Cor-dignano, Lingua albanese, Milano, 1931, f. 11; N. Drizari, Spoken and written Albanian, New-York, 1959, f. 39.

⁸ S. Frashëri, Shkronjëtorë e gjuhës shqipe, Bukuresht, 1886, ribotuar në: S. Frashëri, Vepra, 2, Tiranë, 1988, f. 105; G. Meyer, Kurzgefasste albanesische Grammatik mit Lesestücken und Glossar, Leipzig, 1888, ff. 12-13.

⁹ R. Ismajli, Gramatika e parë e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1982, ff. 16, 78; F. M. Da Lecce, Osservazioni grammaticali nella lingua albanese, Roma, 1716, f. 3; P. Vassa, Grammaire albanaise, London, 1887, ff. 12-16; G. Jakova-Mëturit, Grammatica della lingua albanese, Frascati, 1904, f. 67; I. D. Sheperit, Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f. 38; K. Cipo, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1949, f. 58; K. Cipo, Sintaksa, Tiranë, 1952, f. 16; S. Riza, Entrat në shqipe: sistemi i rasave dhe tipet e lakimit, Tiranë, 1965, f. 43; L. Dodbiha, S. Spasse, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1957, f. 106; K. Gurakuqi, Grammatica albanese, Palermo, 1958, f. 34; M. Lamberz, Leingang des albanischen Sprache, III, Grammatik..., Halle, 1959, f. 65; Sh. Demiraj, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, I, Tiranë, 1961, f. 42; Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 1964, f. 52; P. Elezi, L. Dodbiha, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1965, f. 108; G. Ferrari, Grammatica albanese, ..., Mezzina-Molfetta, 1971, f. 45; N. Ressuli, Grammatica albanese, Bologna, 1985, f. 63; R. d'Angely, Grammaire albanaise comparée, Paris, 1998, f. 116 ku pranon se shqipja ka këto gjashtë rasa, por në faqen 118 flet edhe për rasë vërtetore, vëndëtoje dhe mehanëtoje (instrumental).

Vetëm Julius Pisko pranon katër rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren dhe kallëzoren⁹.

Ani Buzeni dhe Leonard Njumaraku, gjithë duke pranuar në thelb pesë rasa, bëjnë një ndarje disi të ndryshme, më morfologjike, në tri rasa: emëroja, kallëzoria, rasa të zhdrejta që i nëndajnë në gjinore, dhanore, rrjedhore¹⁰.

Si del nga ky parashkrim i thukët, vetëm pesë rasa janë thuajse në të gjitha gramatikat e shqipes dhe në artikuj të ndryshëm kushtuar rasave në gjuhën shqipe : emëroja, gjinoja, dhanorja, kallëzoria dhe rrjedhja¹¹. Por edhe për disa syresh ka pasur diskutime. Kështu, Ogyt Dozoni pat theksuar se në njëjës rrjedhja është zëvendësuar nga gjinoja. Për të, në njëjës shqipja ka katër rasa: emëroren, gjinore-rrjedhoren, dhanoren dhe kallëzoren, kurse në shumës ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren¹².

Kohët e fundit janë bërë përpjekje për të provuar se gjinoja dhe dhanorja janë një rasë e vetme¹³. Ndryshe mendojnë Sh. Demiraj që mundohet

⁹ J. Pisko, Kurzgefasstes Handbuch der nordalbanesischen Sprache, Wien 1896, f. 2.

¹⁰ L. Newmark, Structural Grammar of Albanian, Bloomington, 1957, f. 16; L. Newmark, An Albanian Case System, Lingua, 11, 1962, ff. 313-321; H. Boissin, Grammaire de l'albanais moderne, Paris, 1975, ff. 81-82.

¹¹ Le të shihen ndër të tjerë: M. Durante, Sulla declinazione albanese, Rendiconti della classe di scienze morali..., ser. VIII, vol. XVII, fasciculi 3/4, Accademia nazionale dei Lincei, 1962, ff. 146-157; M. Çeliku, Kontribut për dy probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Studime filologjike, 1971, 3, ff. 137-164; Sh. Demiraj, Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe, Tiranë, 1972, ff. 36-38; O. Shirokov, Novo-greçeskie i albaniske podvezhi, Simpozium po grammatikës tipologji sovremennyh balkanskikh jazikov, Moskva, 1973, ff. 29-30; Sh. Demiraj, Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe, Tiranë, 1975, ff. 13-37; H. Agani, Rreth një sintezizmi në shqipe, Gjurmë albanologjike, seria e shkencave filologjike, VII, 1977, ff. 83-114; B. Boksin, Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes, Prishtinë, 1980, ff. 321-326; E. Likaj, Ndryshimi i treguesve grammatikorë dhe njësimet analogjike në sistemin emëror të gjuhës shqipe, Studime filologjike, 1980, 2, ff. 122-134 dhe 1980, 4, ff. 147-161; Sh. Demiraj, Grammatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1986, ff. 249-296. Për rasën gjinore mund të shfrytëzohet me dobi shkronja Genitivno soçetane v albaniskom jazyku, Analiz sintaksisckih edinic, Moskva, 1980.

¹² Au. Dozon, vep. cit. ff. 188-202.

¹³ S. Prifti, art. cit. ff. 125-126; F. Agalliu, art. cit. f. 127.

të provojë se rasa gjinore dhe rjedhore mund të bashkohen në një të vetme, i kthehet kësaj, njëfarësoj e disi me kahje të kundërt, mendimit të Dozonit. Për akademik Demirajn tri elemente njiçtojnë për të përcaktuar numrin e rasave: formë e vegantë në njëjës, shumës, në të pashquarën dhe të shquarën; funksion i vegantë; kundërvënje paralele e pashquar/ e shquar¹⁴, kurse për profesor F. Agalliu duhen katër elemente : përmbajtje, vëllim, shtirje dhe gjallëri. Me përmbajtje ai ka parasysh kuptimin gramatikor themelor të kësaj ose asaj rase. Dhe për qëshfjen që na shqetëson, shon "Siç dihet, rjedhores i janë njohur dy kupime gramatikore themelore, ai rrethanor dhe ai përcaktor që janë aq larg prej njëri-tjetrit, saqë nuk mund të mbahen si variante të një invarianti"¹⁵. Dhe kështu është vërtet. Këtu kemi një nga arsytet që e shtynë të pranojë se gjinorja nuk është rjedhore e mbiemërtuar, por dhanore e mbiemërtuar. Vëllimi lidhet me përmbajtjen e që kështu lind problemi nëse përdorimi me vlerë përcaktore i takon rjedhores a gjinores. Me shtirje ai ka parasysh qënie e kësaj rase vetëm në trajtë të pashquar, ose edhe në të shquarën: gjinorja ka forma të vetat në të dyja trajtat kurse rjedhoret vetëm në të pashquarën. Kemi këtu një argument të dytë që gjinorja nuk është rjedhore e mbiemërtuar, por dhanore e mbiemërtuar. Me gjallëri ai kupton këtë që në rastin e rjedhores kemi të bëjmë me një rasë me vlerë të plotë si gjithë rasat e tjera, ose me një rasë të një përdorjeje të kufizuar si strukturalisht, ashtu edhe funksionalisht, pra me një rasë jo të plotvlershme. Pra, ai mendon se rjedhoret, në fund të fundit, është rasë me vlerë jo të plotë në gjithën shqipe. Këtë e pohon edhe titulli i shkimit të cituar¹⁶. Dhe ka të drejtë. Arsyetimet e tij për mbiemërtimin e dhanores do të shihen më poshtë prej nesh me sy kritik.

¹⁴ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 254; O. G. Revzina, I. I. Revzin, *Proizhenie v balkanskikh jazykakh universalij o svyazi padezha s opredelenosju*, *Simpozium po gramaticheskoi tipologii sovremennyh balkanskikh jazykov*, Moskva, 1973, f. 55.

¹⁵ F. Agalliu, *Rjedhoret si një rasë me vlerë jo të plotë në gjithën shqipe*, *Studime filologjike*, 1989, 3, f. 125.

¹⁶ F. Agalliu, *Rjedhoret si një rasë me vlerë jo të plotë në gjithën shqipe*, *Studime filologjike*, 1989, 3, ff. 125-140.

Si shihet, për konceptimin e kategorisë gramatikore të rasës dhe për numrin e tyre në gjithën shqipe mendimet nuk përputhen. Dhe e gjithë kjo se shqipja ka në sistemin e rasave homoforma me tepri.

Le të vihet re se, për sa i përket kuptimit, gjinorja ka më shumë afëri me rjedhoren¹⁷ prej së cilës dallohet qartë dyfish (rjedhoret ka në shumës të pashquar mbaresë të vetën të ndryshme nga rasat e tjera: -sh; gjinorja ka në ballë të vet shënuesit i, e, të, së), sesa me dhanoren¹⁸ prej së cilës dallohet në nivelin paradigmatic nga forma analitike me shënuesit e vet të vegantë i, e, të, së dhe në nivelin sintagmatic se dhanorja shënjohet te folja me të ashtuquajturat trajta të shkurëtra të përemnit vetor¹⁹.

Për të dyja palët "molla e sherri" mbetet shënuesi analitik i gjinores. Disa e quajnë njëje, të tjerë njëje-lidhëse, disa të tjerë pjesëzë-lidhëse²⁰, madje edhe dëftor²¹, etj. Dozoni që pranonte rasë gjinore, shënuesin para gjinores e mban për përemër atributiv²². I këtij mendimi do të jetë më vonë edhe S. Prifti që i quan ato relikte përemrash dëftorë, pra fjalë më vete, pjesë më vete e ligjëratis që nuk kanë aritur të shndërrohen në formantë të emrit në gjinore, qoftë edhe në kuptimin e një parashese të paaglutinuar²³. Pra, në fund të fundit gjinorja për të është formë sintetike si gjithë rasat e tjera të shqipes. Afërsisht i këtij mendimi do të jetë Fatmir Agalliu që beson se shënuesi analitik s'është veçse element i jashtëm i gjinores, se pranimi i gjinores si rasë me njëje do ta prishte homogjenitetin e paradigmat²⁴. Pra,

¹⁷ Shih edhe I. I. Voronina, *Sootnoshenie genitivnyh i atributivnyh sozhenij v albanском языке*, *Balkanskoe jazykoznanie*, Moskva, 1973, ff. 301-309.

¹⁸ J. I. Qvone, *Die fehlende Unterscheidung ubiquo und der Zusammenfall von Genitiv und Dativ in den Balkansprachen*, *Zeitschrift für Balkanologie*, 1979, 15, ff. 134-153.

¹⁹ O. Buchholz, *art. cit.*, f. 148 : "Shënuesi i dhanores është një mjet i domosdoshëm për të dalluar këtë rasë, at është pjesë përbërëse e pamungueshme e çdo konstrukcioni me rasën dhanore... Si shënuesi i dhanores shërben trajta e shkurëtrë përkatëse e përemnit".

²⁰ R. d'Angely, *Grammaire albanaise comparée*, Paris, 1998, f. 117.

²¹ S. Riza, *vep. cit.*, f. 22, ku pranon se nga gjinorja e vjetër u përfua gjinorja e re me dëftor dhe dhanorja e re pa dëftor.

²² Au. Dozon, *vep. cit.*, f. 202.

²³ S. Prifti, *art. cit.* f. 126.

²⁴ F. Agalliu, *vep. cit.* ff. 117, 120, 121, 127.

për të, gjinorja është pa nje, është formë sintetike si gjithë të tjerat²⁵. Tani ai e ka rrugën të çelur për ta quajtur gjinoren dhanore të paranyjësuar. Dhe ja si e mbështet këtë tezë që nja nuk duhet quajtur pjesë përbërëse e gjinores sepse: midis njes dhe pjesës sintetike mund të ndërshtihet gjera të tjera: *e tre djemve, e tim biri, e të zezës nënë*; sepse elementet homogjene mund të dalin pa nje-nlidhëse: *zhurma e kaznave dhe lopatave*.²⁶

Në mendojmë se keto argumente vlejnë edhe për të hedhur poshtë edhe format e tjera analitike që shqipja i ka më me tepr' sesa simotrat e veta indoevropiane. Megjithatë, shqipes i njihen me të drejtë forma analitike. Po të mos pranohet gjinorja si formë analitike-sintetike, si duhet trajtuar pjesa analitike, nja-lidhëse, tek emrat e tipit *e hënë, të zië, të ngrenët, etj.* dhe përmirat e tipit *i, e tillë, i, e tij, i, e saj, i cili, të gjithë, etj.*? Si nje-lidhëse apo si pjesë më vete e ligjeratës?

Që nja-lidhëse është pjesë përbërëse e formës së gjinores²⁷, përveç argumenteve të natyrës paradigmатike dhe sintagmatike, do të mjaftonte të ndiqej përgjigja e pyetjeve të tipit: - *E kuj është kjo fletore?* - *E Agronit.* Kurse: **Agronit.* Dhe gjithë kjo krejt si te mbiemri: *Si është koha sot?* - *E mirë.* Kurse: **Mirë.*

*

*

*

²⁵ F. Agalliu, *vep. cit.* f. 122.

²⁶ O. Buchholz, *art. cit.* f. 148, shënim 8.

²⁷ S. Riza, *vep. cit.*, f. 22; O. Buchholz, *art. cit.* f. 148: "Nja e përparme është pjesë përbërëse e deynueshme e çdo konstrukcioni me rasën gjinore, ajo është pra një njëti i domosdoshëm i të shënuarit të gjinores... Nja e përparme bën pjesë në grupin nominal dhe së bashku me emrin ndjekës në rasën gjinore formon një fjalë fonologjike".

Si del nga sa u tha më sipër, rasa gjinore i plotëson brenda radhës paradigmатike të gjitha kushtet e vëna si nga Demiraj ashtu edhe nga Agalliu: ka përmabajtje do me thënë kupium gramatikor themelor të vetin, ai përcaktor; vëllim, sepse vlerën përcaktore, gjithë duke e pasur të vetën, e ndan me edhe me rrydhoren e ndonjëherë edhe me dhanoren; shurje të plotë si në të pashquarën ashtu edhe në të shquarën; gjallëri të plotë, si edhe rasat e tjera: nuk bëhet fjalë për "atavizma, mbeturina rasore". Rasa gjinore është rasë si të tjerat jo vetëm në radhën paradigmатike, por edhe në atë sintagmatike: rasa dhanore është e shënuar edhe te folja²⁸, rasa kallëzore me funksion kundëror të tematizuar shënohet te folja²⁹. Në radhën sintagmatike, gjinorja karakterizohet nga bashkëpërshatja në numër, gjini dhe rasë me emrin që përcakton dhe duket kështu sikur sillet si klasa e mbiemrave: gjinorja ka në ballë të vet një shenjës që realizon bashkëpërshatjen. Pra, sipas formës dhe funksionit, gjinorja afrohet me mbiemrin³⁰, ndaj edhe disa gjithëtarë e mbajnë për rasë të mbiemëruar³¹.

Bukur fort, por tani dalin disa probleme të tjera: nëse gjinorja është rasë e mbiemëruar, duhet të mos jesh morfolog që të mos e pranosh këtë,

²⁸ O. Buchholz, *art. cit.* f. 148; R. Pernaska, *A janë përmira 'trigat e shkurtëra të përmirave vetorë' në shqipen e sotme?*, *Studime filologjike*, 1982, 4, ff. 199-210; Mendime interesante ka edhe te Ju. P. Kostjucenko, *Zameganija o 'sinkretizme' i znanenijah dalehogo padecia v indoevropskih jazykah*, *Vop-rosy jazykoznanija*, 1980, 1, ff. 83-95.

²⁹ I. D. Shepeti, *vep. cit.*, f. ; P. Novak, *K zdujovani predmetu v albanstine*, *Sbornik Slavistických prací venovaných mezinárodnímu sjezdu slavistů v Moskvě*, IV, Universita Karlova, Praha, 1958, ff. 27-32; N. Bari, *Albanais: Thème, propos et pronoms atones*, *Bulletin de la Société de Linguistique de Paris*, t. 70, fasc. 1, 1975, ff. 179-202; Sh. Demiraj, J. A. Lopašov, *Mestoimennye povtory dopolnenija v balkanskix jazykax*, Leningrad, 1978, f. ; O. Buchholz, *Art. cit.*, ff. 148-149; M. Toloni, *Gjymtyrët e fjalës (kruefjala, kallëzuesi, përcaktori, përcaktori kallëzuesor)*, Disertacion për gradën "Kandidat i shkencave", Tiranë, 1980; Th. Rushi, *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë tëftore në gjuhën shqipe*, Disertacion për gradën "Kandidat i shkencave", Tiranë, 1983; R. Pernaska, *art. cit.* f. ; C. Vădăscu, *Remarques sur la reprise (et l'anticipation) de l'objet direct et indirect dans les langues roumaine et albanaise*, *Revue roumaine de linguistique*, XXX, Bucureshti, 1985, 5, ff. 497-503.

³⁰ C. Vădăscu, *Disa vërejtje lidhur me nje-n e gjinores dhe nje-n e mbiemrit në rumunisht dhe në shqipe*, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1988, f. 441-448.

³¹ J. Faensen, *Genitiv und Adjektiv im Albanischen*, *Zeitschrift für Balkanologie*, XI, 2, 1975, ff. 40-47; F. Agalliu, *Sa rasta ka në gjuhën shqipe?*, *Studime filologjike*, 1980, 3, ff. 163-168.

duhet pranuar njëherazi se vetë rasa gjinore lakohet ashtu si edhe mbiemri në pjesën analitike (je të kinet parasysh se gjinorja mbetet e pandryshuar në pjesën sintetike edhe kur mbiemri ndryshon pikërisht në këtë pjesë, pra, kemi lakim brenda një lakimi të mëparshëm. Lakim në lakim, kjo është një e papritur për gjuhësinë e përgjithshme, për vetë teorinë e përgjithshme të rasës, një e papritur që kërkon të riveshitrohet vetë kjo teori. Sido që të jetë, tipologjia ndodhet para një të dhëne të re: formë sintetike-analitike që, përveç numrit dhe gjinisë, përshatet edhe në rasë me emrin që përcakton.

Nëse gjinorja nuk duhet mbajtur më si rasë më vete por kalohet te mbiemri, atëherë duhet shpieguar si ndodhi që një formë fjale dhe jo fjala vetë të kalojë nga një pjesë ligjërata në një tjetër, çka është gjithashtu me interes për teoricienët e gjuhës. Ne besojmë se gjinorja, ky hermafrodit morfologjik e semantik, nuk ka kaluar ende në klasën leksiko-gramatikore të mbiemrave si ka ndodhur me përemrat pronorë të vetës së tretë dhe tek ndonjë mbiemër me prejardhje emërore, kur semantika e lejonte një gjë të tillë, si *i*, *e fundi*, *ej*, dhe për këtë po njaftohemi kësaj radhe vetëm me parashkrimin e argumenteve të mëposhme: gjinorja mund të përcaktohet nga një gjinore tjetër (*vajza e doktorit* të fshatit), po të që mbiemërzuar do ta kishte bjerë këtë aftësi, pra si mbiemër ajo nuk do të mund të drejtonte një emër tjetër me funksion përcaktori, çka tregon se kuptimi emëror mbetet që mbetet te gjinorja. Po kështu edhe gjinoret e nënanës (subjektit) dhe të kundranës (objektit) flasin për natyrë emërore³². Edhe lokucionet parafralore të tipit *me anë të...*, *me anën e...*, *ej*, dëshmojnë për natyrën emërore të gjinores. Ka edhe argumente të tjera

Si përfundim, shqipja ka një gjinore origjinale, një hermafrodit morfologjik, sintaksor dhe semantik, që nuk mund të shihet as te rriedhorja, as te dhanorja. Kështu, pra, shqipes duhet t'i njihen pesë rasa: emëroja, gjinorja,

dhanorja, kallëzoria dhe rriedhorja, si e ka provuar edhe një herë kohët e fundit akademiku Kristian Gyr³³.

³² Snih edhe I. I. Revzin, *Transformacionoe issledovanie konstrukcij s subjektivno i ob- jektivno primenimim dopolnenijem (Genitivus subjectivus i Genitivus obektivus)*, *Problemy grammatičeskogo modelirovanija*, Moskva, 1973, ff. 88-96.

³³ Chr. Gut, *Combien l'albanais comporte-t-il de cas?*, *Cahiers balkaniques*, 19, Paris, 1993, ff. 207-216.

GJUHA STANDARDE DHE SHKOLLA

1. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) me anë të Rezolutës së tij i drejtohej së pari shkollës për zbatimin e normave të gjuhës standarde, ku tekstualisht thuhet: "Kongresi i Drejtshkrimit i drejtohet në radhë të parë shkollës shqiptare si vatra themelore e formimit gjuhësor të brezave të rinj... që ajo ta vlerësojë përvetësimin e normave të njësuara të gjuhës letrare e të drejtshkrimit të miratuar nga Kongresi si detyrë themelore dhe të zbatueshme plotësisht rregullat e reja të drejtshkrimit, duke filluar nga viti 1973-74" (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë 1973, f.25). Dhe kjo nuk ishte gjë e rastit, sepse shkolla është institucioni më i rëndësishëm në të cilin normat e gjuhës standarde mësohen sistematikisht për një kohë të gjatë: tetë, dhymbëdhjetë e më shumë vite gjatë shkollimit fillor, të mesëm dhe të lartë.

2. Në shkollë fëmijët vijnë në moshën e tyre më produktive, në periodën kur kanë aftësi të mëdha për akumulimin e njohurive, dhe e mësojnë normën e gjuhës standarde në dy drejtime kryesore: nëpërmjet të mësimdhënies nga lëndët e ndryshme mësimore dhe me anë të lëndës së gjuhës shqipe, në të cilën norma përvetësohet teorikisht dhe praktikisht. Këtu dalin një varg detyrash të rëndësishme, ndër të cilat ligjërimi i mësimdhënësve të lëndëve të tjera në normën standarde zë vend të rëndësishëm. Po kështu, rëndësi të madhe ka edhe zbatimi i plotë i rregullave të normës standarde në tekstet mësimore. Duhet të theksohet se për një kohë relativisht të gjatë pas Kongresit të Drejtshkrimit një numër i konsiderueshëm tekesh mësimore për shkollat fillore dhe të mesme për shumicën e lëndëve kanë qenë të përkthyer nga gjuhët sllave pa një frymë origjinale të strukturës së gjuhës shqipe. Në këto tekste vëreheshin shkeqje të shpeshta të normës, veçanërisht të sintaksës së gjuhës shqipe. Edhe më vonë kur tekstet origjinale për lëndë të ndryshme po rriteshin dita-ditës vëreheshin ndikimet e këtyre gjuhëve, sepse përplulesit e tyre ose i kishin kryer studimet jashtë Kosovës në vende të ish-Jugosllavisë, ose kishin përdorur literaturën kryesore dhe ndihmëse të gjuhëve sllave. Tani vonë, sidomos në vitet e para të shekullit të ri, janë krijuar kushte të reja historiko-

shoqërore, të cilat do të ndihmojnë edhe integrimin arsimor e kulturor gjithëshqiptar. Ndihmesa e Tiranës në përpilimin e teksteve jo vetëm të gjuhësisë, por edhe për lëndë të tjera, do të jetë shumëfish e dobishme, sidomos sa i përket realizimit të normës së gjuhës standarde.

2.1. Tekstet e lëndëve mësimore bashkë me ligjërimin e mësimdhënësve të lëndëve të ndryshme do të jenë dy shtylla të rëndësishme për përvetësimin më të shpejtë të normës së gjuhës standarde në shkollë. Kjo do të ishte gjendja, e cila dëshirohet të arrihet në njëzetet tona. E tani shihet pyetja: Në çfarë niveli ndodhet angazhimi i mësimdhënësve për zbatimin e normës së gjuhës standarde në ligjërimin e tyre dhe në punën e përgjithshme që bëjnë në shkollë? Kësaj pyetjeje vështrë se mund t'i jepet një përgjigje meritore pa bërë studime të hollësishtme në të gjitha shkollat e Kosovës e më gjërë. Mirëpo, nëpërmjet mund të thuhet se gjendja në shkollat tona fillore dhe të mesme nuk është shumë e kënaqshme sa i përket realizimit të normës së gjuhës standarde në shkollë, sepse një numër i konsiderueshëm mësimdhënësish mendojnë gabimisht se vetëm mësimdhënësit e gjuhës shqipe janë të obliguar të interesohen për zbatimin konsequent të normës së gjuhës standarde në shkollë. Një vetëdije e këtillë natyrisht që duhet të ndryshohet, sepse secili mësimdhënës ka detyrë dhe obligim moral e shoqëror që të interesohet për zbatimin adekuat të normës së gjuhës standarde, jo vetëm në lëndët me karakter gjuhësor, por edhe në ato që kanë të bëjnë me shkencat natyrore dhe me lëndët e shkathësisë.

Më në fund duhet të kihet parasysh se në shkollë krijohen të gjitha profilet e knadrove, të cilat në të ardhmen do të veprojnë në shoqëri, dhe gjuhën do ta kenë armën kryesore dhe të vetmen në veprimtarinë e tyre jetësore. Prandaj nëse vërehen ngecje e shmangie nga norma e gjuhës së standardizuar, shpesh për këtë bëhet fajtorë shkolla, madje me të drejtë.

3. Takimi i parë i individit me normën e gjuhës standarde realizohet në institucionet parashkollore: në qerdhjet e fëmijëve dhe në foshnjore. Ç'është e vërteta kontaktet e para të fëmijëve me normën e gjuhës standarde janë më të hershme dhe fillojnë me dëgjimin e radios e të televizionit si dhe të bisedave që bëhen në ligjërimin letrar. Mirëpo, këto janë kontakte pasive, pa pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e normave të gjuhës standarde. Ndërkaj, në qerdhje, në foshnjore dhe në shkollë fëmijët ndeshen me normën në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe kanë një qëndrim më aktiv ndaj saj.

3.1. Në këto institucione ata sjellin variantin e thjeshtligjërimit ose të ligjërimit dialektor, të cilin e kanë pëvetësuar në familje dhe në rrethin më të ngushtë shoqëror. Problemet që do të kenë nxënësit me normën e gjuhës standarde kanë të bëjnë me ndryshimet që ekzistojnë midis së folmes dialektore të tyre, krahasuar me ato që janë normative, të cilat ata duhet t'i

përvetësojnë në shkollë. Ky inventar i ndryshimeve gjuhësore me karakter dialektor mund të dalë ngaft heterogjen, varësisht nga vendi a krahina prej nga është nxënësi. Sigurisht që fëmijët, të cilët jetojnë në pjesët jugore të Shqipërisë dhe komunikojnë në të folmet e dialektit të toskërishtes apo në ish-variantin letrar të tij, do të kenë më pak punë për përvetësimin e normave të gjuhës standarde. Ndërkaj, ata që jetojnë në Shqipërinë Veriore, në Kosovë dhe në Maqedoni duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për përvetësimin e plotë të normës së gjuhës standarde shqipe dhe për eliminimin e të gjitha veçorive dialektore që dalin në të folmet e tyre.

3.1.1. Fëmijët kosovarë, të cilët komunikojnë në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore, duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për t'i eliminuar veçoritë dialektore të së folmes së tyre. Problemi i parë që do t'u dalë këtyre nxënësve është mënjanimi i fonemave zanore hundore të ligjërimit të tyre, pasi që këto nuk janë përfshirë në normën e gjuhës standarde shqipe. Norma e gjuhës standarde, siç dihet mirëfilli, ka një sistem zanorësh të përbërë vetëm nga 7 zanore gojore dhe kjo do të thotë se nxënësit e këtyre anëve, të cilët në sistemin e së folmes së tyre kanë afërsisht 23 fonema zanore, do të duhet të eliminojnë 10 zanore hundore (të shkurtra dhe të gjata) dhe gjashtë zanore të gjata gojore, d.m.th. gjashtëmbëdhjetë sosh. Kjo punë do të bëhet sistematisht gjatë gjithë shkollimit fillor dhe të mesëm, ndërkaj në gjuhën e shkruar përvetësimi i fonemave zanore të gjuhës standarde arrihet shumë më shpejt, sepse këtë e bëjnë të mundshme vetë zgjidhjet e drejta të drejtshkrimit të saj.

3.1.2. Sa i përket zanores a hundore[ǎ] të gjatë dhe të shkurtrë, ajo do të eliminohet më lehtë sesa zanoret hundore të tjera, sepse përballët e kundërvënë me zanoren [ǎ] të theksuar të toskërishtes, e cila është e përfshirë edhe në normën e gjuhës standarde. Ndërkaj, zanoret e tjera hundore, të cilat, edhe pse nuk kanë një shtrirje të gjërë, eliminohet më vështirë nga ligjërimi i nxënësve në shkollën fillore edhe të mesme.

3.1.3. Grupet e zanoreve, të cilat dikur mund të kenë qenë edhe diftongje, në të folmen e fëmijëve kosovarë dalin të reduktuara maksimalisht nga *ue*, *te*, *ye* khs. *shkue*, *punue*, *mësue*, *miell*, *diell*, *lyej*, *ngjyjej*) në zanore të thjeshta [u], [i], [y:] (p.sh. *shku*, *punu*, *msu*, *mi:ll*, *di:ll*, *ly:j*, *ngjy:j* etj.). Shqiptimi i këtyre grupeve të zanoreve si të plota do të realizohet më vështirë sesa shkrimi i tyre, sidomos në ciklin e ulët të shkollës fillore. Këtyre grupeve të zanoreve duhet t'u shohet edhe grupi *ua*, i cili nuk del në asnjë të folme të gegërishtes, por është normëzuar në gjuhën standarde nga të folmet e toskërishtes. Edhe për përvetësimin e shkrimit dhe të shqiptimit të këtij grupi zanorësh fëmijët do të kenë vështirësi të konsiderueshme. Megjithatë, nga disa studime që janë bërë për

harimtet e nxënësve në shkollat kosovare del se përvetësimi i grupit vokalik *ua* është më i shpejtë sesa përvetësimi i shqiptimit dhe i shkrimit të drejtë të grupeve të zanoreve *ie, ye*.

3.1.4. Nxënësit filloristë do të kenë më pak vështirësi për përvetësimin e sistemit bashkëtingjellor të gjuhës standarde shqipe, sepse sistemi bashkëtingjellor në të folmet dialektore të shqipes ka shumë më pak vegori me karakter dialektor. Kështu, bie fjala, nga të 29 bashkëtingjelloret, sa ka gjuha standarde shqipe, vetëm gëflet e palataleve [q]-[ɟ] dhe afrikateve [ç]-[xh] paraqesin problem, pasi që kundërvënja midis tyre është zhdukur në të gjitha të folmet e Kosovës dhe këto kanë përfunduar në bashkëtingjelloret e tipit [ç]-[ɟ], të cilat më shumë anojnë nga afrikatet, sesa nga palatalet. Këtu dalin vështirësitë për nxënësit kosovarë, sepse eliminimi i kësaj vegorie kërkon përpjekje shumë të mëdha.

3.1.5. Edhe asimilimi i grupeve të bashkëtingjellore *mb, nd, ng, ngj* del në shumicën e viseve ku fillet gëgërishtja. Kjo do të thotë se nxënësit e këtyre viseve duhet të bëjnë përpjekje mjaft të mëdha që grupet e këtylla të bashkëtingjellore, të cilat në të folmen e tyre dalin të asimiluara në bashkëtingjellore të thjeshta (khs. *mbret, mushi, mesa, luna, veni, breja, daga* etj.) t'i shqiptojnë të plota, ashtu siç dalin edhe në normën e gjuhës standarde (khs. *mbreti, mbushi, e mbesa, luna, vendi, brenga, danga* etj.). Eliminimi i këtyre defekteve normative bëhet më shpejt në gjuhën e shkruar sesa në ligjërimin libror, d.m.th. në gjuhën e folur letrare të nxësve të shkollës fillore.

3.1.6. Të folmet e gëgërishtes nuk kanë rotacizëm, por mbasi ky fenomen i vjetër fonetik është normëzuar në gjuhën letrare, nxënësit e këtyre anëve duhet ta përvetësojnë atë. Në ciklin e klasëve të ulta përvetësimi i këtij fenomeni mund të dalë me vështirësi mjaft të mëdha, sepse nxënësit e kësaj moshë, duke mos pasur njohuri të mjaftueshme për historinë e gjuhës, do ta përdorin këtë fenomen edhe atëherë kur ky nuk është i përligjur si në fjalët *Asllëri, Bieshtëri e Nemura* etj. Vështirësi më të mëdha do të shkaktojnë fjalët që kanë një rotacizëm sekondar, siç janë: *fëmijëri, amvisëri, pejtueshmëri* etj.

3.2. Edhe në strukturën morfologjike e folmja dialektore e fëmijëve mbart në vete një varg vegorish dialektore, nga të cilat për t'u mënjannuar dalin: shqiptimi i emrave të lakimit të dytë me mbaresën nje-*i* (*miki, zogi, krahni*) dhe zëvendësimi i tyre me mbaresën -u (*mika, shoka, krahni*); shumësi i emrave mashkullorë, i formuar me prapashitesat -j (*mij, shkopi, lune*) dhe -na (*mishina, vojna, plehna*) dhe zëvendësimi i tyre me format e tipit *nini, shkopini, lumeni, mishëri, vajta, plehëri* etj., të cilat si të këtylla janë normëzuar në gjuhën

standarde shqipe. Duhet të eliminohet edhe futuri i formuar nga folja ndihmëse kam dhe paskajorja e gëgërishtes (*kam me mësue*), e cila nuk është normative. Përcjelloja e gëgërishtes e formuar me pjesëzën *ue* do të duhet të zëvendësohet me pjesëzën *duke* (khs. *duke punuar*); paskajorja e gëgërishtes e tipit *me lexue*, e cila është tënë jashtë normës së gjuhës standarde, do të duhet të përgjashohet plotësisht nga përdorimi dhe të zëvendësohet ose me paskajoren e tipit *për të lexuar*, ose me format e ndryshme të mënyrës lidhore (*të lexoj*). Po kështu edhe pjesoret e zhvilluara më tej të gëgërishtes do të zëvendësohen gradualisht me pjesoret e plota që dalin në gjuhën standarde shqipe (*shkuar, lexuar, hapur, mbetur, larë, parë* etj.).

Krahas këtyre vegorive, të cilat janë karakteristike për shumicën dërmuese të të folmeve të dialektit të gëgërishtes, në Kosovë dalin edhe disa vegori të tjera dialektore që janë më specifike, si përdorimi i dëftores për lidhoren (khs. *të shkon për të shkojë*), veta e tretë e së pakryerës e tipit *shkojke, punojke* për format normative *shkonte, punonte*; përdorimi i foljes së ngurosur modale i tipit *s'un shkoj* për *s'mund të shkoj* etj.

3.3. Të gjitha këto vegori dialektore, pas ushtrimeve e përpjekjeve intensive të bëra në orët e mësimi të gjuhës shqipe dhe të lëndëve të tjera, do të mund të eliminoheshin me sukses të plotë që nga cikli i ulët i shkollimit fillor. Por ndikimet që mund të vërehen në sintaksën e gjuhës standarde të nxënësve, të cilat janë shumë të vështira për t'u hetuar, do të mund të eliminohen me vështirësi shumë më të mëdha. Këtu nuk është fjala për ndikimet që mund të vijnë nga tekstet mësimore, sa nga ligjërimi i gjeneratave të vjetra, ku përfshihen prindërit dhe mësimdhënësit me të cilat(ndikime) nxënësit do të ndeshen vazhdimisht, brenda dhe jashtë shkollës. Në këto biseda të thjeshtë ligjërimin ka përlot kalke të gjuhëve sllave, të cilat kanë depërtuar edhe në të folmen dialektore nga gjuha letrare, p.sh. *Për çka je? A je për një kafe?; Posedoj para; Flas mbi Komicën* etj., në vend të trajtave të drejta shqipe: *Çka dëshiron të pijsh? A dëshiron një kafe? Kam para; Flas për Konicën* etj. Vetëm njohja e thelluar e strukturës së gjuhës shqipe dhe historisë së saj, e cila mund të arrihet pas përpjekjeve shumë të mëdha dhe këmbëngulëse mund të sigurojë kushte për eliminimin e efektivitetit të ndikimeve të gjuhëve të huaja nga struktura sintaksore e gjuhës shqipe.

Edhe elementet e huazuara pa nevojë nga struktura leksikore e gjuhëve të huaja nuk mund të eliminohen shpejt, ndërkaj, begatimi i ligjërimin të nxënësve me njësi frazeologjike të gjuhës shqipe shkon akoma më ngadalë dhe kërkon përpjekje shumë më të mëdha, sepse duhet të bëhen studime të thelluara të strukturës leksikore dhe frazeologjike jo vetëm të gjuhës standarde, por edhe të të folmeve të veganta të saj.